

---

## BULETIN INFORMATIV

---

Prill 2024

AKADEMIA E SHKENCAVE  
E SHQIPËRISË

---



---

**Buletin mujor i aktiviteteve të Akademisë së  
Shkencave të Shqipërisë**

Prill, 2024

## Përmbajtje

Këshilli i botimeve miraton listën e titujve të veprave që do të botohen nga Akademia e Shkencave gjatë vitit 2024 .....	6
Rikonstituohet Akademia e të Rinjve pranë ASHSH .....	9
Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave të Turqisë .....	12
Akademikët Arben Merkoçi e Aurela Anastasi, anëtarja e jashtme e ASHSH Mira Mezini dhe prof. dr. Aljula Jubani zgjidhen nga AADF në bordin e ekspertizës shkencore akademike. ....	14
Dijetari që ndërlihdh tre kryeqytete: Prishtinën, Tiranën dhe Shkupin - sot është jubilarinë .....	16
Në Prishtinë konferencë për 90-vjetorin e akad. Ali Aliut, anëtar i jashtëm i ASHSH....	18
"Don Kishoti te shqiptarët", një histori letërsie tjetër .....	23
Në 80-vjetorin e Konferencës së Bujanit .....	27
Redaksia e inxhinierive dhe teknologjive e "Enciklopedisë shqiptare" përfundon përgatitjen e fjalësit paraprak.....	34
Anëtarët e Akademisë së të Rinjve sot.....	36
Takime pune në Kryesinë e ASHSH me drejtorin i Institutit të Arkeologjisë akad. A. Bunguri dhe drejtorin e Institutit të Historisë prof. Hamit Kaba .....	37
Kryesia e Akademisë së Shkencave uron në ditën e lindjes akademik Shaban Sinanin .	40
Akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë priti sot Këshilltarin e Ambasadës së Republikës Franceze për çështjet e kulturës dhe edukimit, Pierre Raynaud.....	43
Javë kushtuar gjuhës dhe kulturës shqiptare në qendrën "Europeum" të Regensburg Universitetit.....	46
Vizitë e delegacionit të "École Française d'Archéologie d'Athènes" në Akademinë e Shkencave.....	48
"Ndikimi kulturor i latinitetit në Shqipëri" / "La latinità e le sue influenze culturali in Albania" .....	50

Në Stamboll mbahet Takimi II i akademive të vendeve të rajonit të Europës Juglindore ("IId Meeting of the South Est Europe Regional Academies") .....	52
Përparësi në bashkëpunimin tonë - fushat që na lidhin për shkak të historisë, territorit e fqinjësisë .....	54
Profile të shkurtra të katër akademikëve të asociuar që fituan sot titullin "akademik" ..	58
Angjelin Preljocaj, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave.....	62
Mira Murati anëtare e jashtme e Akademisë së Shkencave.....	63
Gëzim Alpion anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave.....	65
Lea Ypi anëtare e jashtme e Akademisë së Shkencave .....	66
Lulzim Tafa anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave .....	67
Kalendari i konkurseve për çmimet shkencore që jepen nga Akademia e Shkencave për vitet 2024-2025 .....	69
Nënshkruhet protokoli i bashkëpunimit midis Akademisë së Shkencave dhe dy universiteteve: Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë dhe Universitetit "Luarasi" .....	70
Redaksia e inxhinierive dhe teknologjive në procesin e njësimin të fjalësit të këtyre dy fushave me redaksinë gjegjëse të Kosovës.....	71
<b>Botime të reja .....</b>	<b>73</b>
Botohen dy vëllimet e para të veprës së plotë të poetit, dramaturgut, prozatorit dhe fratit françeskan arbëresh Francesco Antonio Santori (Frangjisk Santori) .....	74
"Kabatë me gërnëtë dhe violinë", promovohet libri i 36-të i akad. Vasil Toles .....	76
Përurohet në panairin e tretë të librit akademik dhe shkencor "Shteti i së drejtës në proceset integruese të Shqipërisë" .....	82
Pas "Doktrinës së krishtenë" Akademia e Shkencave boton librin e dytë të Pjetër Budit, "Pasqyra e t'Rrëfyemit" .....	86
"Qendrat e banuara të Shqipërisë: gjendja dhe e ardhmja", botim i Akademisë së Shkencave, 2024.....	90
"Luan Starova, akademiku, shkrimtari i shumëgjuhësisë", botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë 2024.....	92
" Mbi zhvillimin dhe mirëqenien", përgatitur për botim dhe redaktimi shkencor nga akad. Kosta Barjaba; bot. i Akademisë së Shkencave (Tiranë 2024); opus i studiuesve më të njohur për shoqërinë e mirëqenies; një pentalogji për dy çështje thelbësore për shoqërinë e zhvilluar; shkruar përgjatë një dekade .....	96

"Baladë dritash për Zorbën", me nëntitull "Në poetikën e Zef Zorbës", autor Viola Isufaj, botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë 2024.....	99
<b>Shtojcë .....</b>	<b>102</b>
Libri shkencor është më i vështiri për t'u lexuar por, më i miri për t'u informuar e i vetmi për t'u formuar .....	104
Kemi akoma punë për ta hapur veprimtarinë botuese për autorët dhe lexuesit .....	108
Shpallet vendimi i Kryesisë për çmimet shkencore që jepen nga ASH .....	110
Përrurohet qendra për koordinimin dhe përhapjen e informacionit shkencor.....	113
Paraqitet ecuria e tri projekteve madhore të albanologjisë.....	119
Në kuadër të panairit të tretë mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor përrurohet në sallën "Aleks Buda" libri "Arbëreshët - shqiptarët e Italisë" i Fatmir Toçit, bot. "Toena" .....	123
Paraqitet "Bibliografia e veprimtarisë shkencore të Ali Aliut", anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë .....	125
Panairi Mbarëkombëtar i Librit Akademik dhe Shkencor, si nismë e përbashkët e Shqipërisë dhe Kosovës, nisi në Ditën e Librit edicionin e tretë në Akademinë e Shkencave në Tiranë.....	130
Panairi i 3-të mbarëkombëtar i librit akademik dhe shkencor .....	138
Dita e dytë, 24 prill 2024.....	138
Panairi i 3-të mbarëkombëtar i librit akademik dhe shkencor .....	143
<b>Nekrologji.....</b>	<b>147</b>
Ndahet nga jeta piktori i njohur Ali Oseku .....	148
<b>In memoriam.....</b>	<b>150</b>
20-vjetori i largimit nga jeta, Akademia e Shkencave e Shqipërisë kujton me nderim e mirënjohje akademik Bedri Dedjan .....	151

## Këshilli i botimeve miraton listën e titujve të veprave që do të botohen nga Akademia e Shkencave gjatë vitit 2024

- Përparësi fjalorët dhe studimet gjuhësore, sivjet në Vitin e Gjuhës Shqipe -
- Ndryshime në numër e në strukturë krahasuar me vitet e mëparshme, pas ribashkimit të instituteve të albanologjisë me Akademinë e Shkencave -
- Diskutohet edhe për ndryshimet që diktohen në rregulloren e veprimtarisë botuese, për të njësuar kriteret e standardet me botimet e indeksuara në platforma ndërkombëtare -



Këshilli i botimeve i ASHSH u mbledh sot për të vendosur për listën e veprave që do të botohen prej saj si ent botues gjatë vitit 2024.

Kryetari i këshillit të botimeve akad. Skënder Gjinushi informoi anëtarët e tij për procedurën e ndjekur deri më tani sipas rregullores për veprimtarinë botuese të ASHSH.

Kërkesat për botim i janë paraqitur ASHSH prej autorëve të tyre deri më 31 dhjetor 2023, në gjendje të përfunduar.

Spektori i botimeve bëri evidencimin e tyre, të shoqëruar me një përmbledhje informuese për përmbajtjen dhe rëndësinë e tyre, për secilën nga veprat. Disa tituj qartësisht në mospërputhje me kërkesat dhe prioritetet e ASHSH, pas përzgjedhjes paraprake nga ky sektori, u lanë jashtë listës që iu bë e njohur Asamblesë nga Kryesia në mbledhjen vjetore, ku u mor pëlqimi parimor i saj. Në vijim, veprat e dorëzuara për botim iu dërguan recensuesve, specialistë të fushës, si rregull një nga radhët e akademikëve dhe një i jashtëm. Një pasqyrë analitike, e shoqëruar me vlerësimet e recensuesve, iu dërgua anëtarëve të këshillit të botimeve, i cili mbi këtë bazë diskutoi e vendosi sot për çdo titull një nga një. Numri i veprave të miratuara sot për botim është 23, duke përfshirë disa tituj të miratuar qysh vjet, por të caktuar në kalendarin e botimeve të vitit 2024. Në përqindje fjalorët dhe studimet gjuhësore zënë vendin e parë, jo rastësisht sivjet, në Vitin e Gjuhës Shqipe.

Kryetari Gjinushi njoftoi këshillin e botimeve se 32 tituj të tjerë janë miratuar nga këshillat shkencorë të instituteve të albanologjisë vitin e kaluar, janë kryer të gjitha procedurat e recensionimit dhe diskutimit shkencor, madje edhe prokurimi, por nuk u arrit të bëhej shtypshkrimi i tyre, prandaj janë një detyrim i bartur për shkak të riorganizimit dhe këshilli i botimeve në këtë rast njoftohet për ta gjykuar listën në tërësi lidhur me përputhjen me prioritetet e Akademisë, pa dubluar procedurat.



Në vijim ai theksoi se do të bëhet një diskutim i posaçëm për raportet midis këshillave shkencorë në institute, që deri tani ushtrojnë edhe përgjegjësinë e këshillit të botimeve brenda tyre, me këshillin botues të ASHSH.

Lista e tretë e titujve të përfshirë në programin e veprimtarisë vjetore botuese, që iu njoftua këshillit të botimeve, ishte ajo e veprave me karakter promovues dhe jubilar, 12 tituj, kryesisht akte të konferencave, libra-kushtim, botime në përvjetorë etj. Për këtë kategori vendimet merren nga Kryesia, por, megjithatë, këshilli u ftua të japë mendim.



---

Lista e periodikëve përmban 18 njësi për këtë vit. Ato miratohen nga redaksitë gjegjëse, por këshilli i botimeve merr informacion rreth saj.

Lidhur me disa kërkesa për botime vetjake, pa shpenzime nga buxheti i ASHSH, por me shenjën e saj si ent botues, u vendos të diskutohet në një rast tjetër, pasi të jenë bërë rregullime edhe në aktet e brendshme. Këto akte do të përditësohen jo vetëm për shkak të ribashkimit të njësisë të përhershme të albanologjisë, por edhe për t'iu përgjigjur kërkesave standard të platformave ndërkombëtare për indeksim shkencor. Për të njëjtat arsye ndryshime do të bëhen edhe në përbërjen e këshillit botues.



## Rikonstituohet Akademia e të Rinjve pranë ASHSH

- Mbledhje ceremoniale në sallën "Aleks Buda": 11 kandidatë të sapozgjedhur të Akademisë së ringritur marrin diplomat e anëtarësisë -

- Komisioni i posaçëm, i formuar nga Asambleja, organizoi konkursin në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kriteret e detyrueshme dhe mori vendimin për fituesit, që u zbatua përfundimisht me ceremoninë e sotme -



Ceremonia u hap dhe u drejtua nga akad. asoc. Adrian Civici, i cili i njohu të pranishmit me vendimin e Asamblesë për miratimin e Statutit të Akademisë së të Rinjve (AR) dhe me vendimin për ngritjen e komisionit të pranimeve të kryesuar nga ai vetë. Civici foli për procedurat që u ndoqën në procesin e përzgjedhjes, për interesimin e studiuesve të rinj për t'u bërë pjesë e AR, për cilësitë shkencore të tyre dhe për format e bashkëpunimit me ASHSH. Ai falënderoi anëtarësinë e mëparshme të AR, e cila kontribuoi për afro shtatë vjet për të promovuar një brez të ri në kërkim.

Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi përgëzoi anëtarët e sapopranuar në Akademinë e të Rinjve për zgjedhjen e tyre dhe falënderoi anëtarët e mëparshëm për rolin e tyre si ndërlihdhës midis breznive të studiuesve. Akademia e të Rinjve është një zhvillim i ri në akademizëm, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Europë e në Botë. Tek ne u krijua me një akt të brendshëm, që shprehte një dëshirë të mirë, por

baza ligjore u krijua tamam me Ligjin nr. 53/2019. Mbi këtë bazë u miratua nga Asambleja "Karta themelore e akademive të të rinjve", e hartuar dhe rekomanduar nga ALLEA. Ky dokument tani është statut i AR. Gjatë kësaj kohe pjesa më e madhe e anëtarësisë së mëparshme e kaloi kufirin moshor dhe përtëritja u bë e domosdoshme edhe për këtë arsye, jo vetëm për shkak të detyrimit ligjor.



Akademitë nga vetë karakteri i tyre janë bashkësi studiuesish në moshë të lartë, që kanë nevojë për ura ndërveprimi me më të rinjtë. Ne nuk po krijojmë një akademi tjetër, as ndonjë strukturë që përgatit akademikë (megjithëse nuk përjashtohet që nga radhët e anëtarëve të AR të dalin akademikë të ardhshëm). Tre janë qëllimet kryesore të kësaj nisme: që t'u jepet mundësi të rinjve për t'u vetorganizuar; që ASHSH të ruajë lidhjet me brezat e rinj dhe që problematikat shkencore të tyre të bëhen shqetësime shkencore të saj. Prandaj format kryesore të ndërveprimit do të jenë si prani tek organizmat dhe veprimtaritë e njëri-tjetrit: anëtarë përfaqësues të AR të marrin pjesë në komisionet e përhershme, të aktivizohen në njësitë dhe qendrat e kërkimit, të përfshihen në aktivitetet që përmban programi i miratuar nga Asambleja. Ne do të kujdesemi, siç e kemi detyrë, për t'i ruajtur lidhjet dhe vëmendjen ndaj tyre edhe pas kalimit të kufijve moshorë, duke i ndjekur në karrierë e duke ruajtur bashkëpunimin individualisht.

Bashkëkryetari i AR Andi Rëmbeci përsëriti në emër të anëtarësisë themeluese (2017) dhe shprehu mirënjohjen për kujdesin e treguar nga ASHSH për formimin dhe fuqizimin e saj.

---

Pas shpërndarjes së diplomave u bë mbledhja e parë e AR të rikonstituar. Znj. Belfjore Qose u zgjodh kryetare e re e AR.



Akademia e të Rinjve është anëtare e Young Global Academies dhe ka revistën e vet vjetore.

## Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave të Turqisë



Marrëveshja u nënshkrua në përmbyllje të takimit të dytë të akademive të vendeve të rajonit, organizuar sot në Stamboll, në mjediset e bibliotekës historike "Suleymaniye".

Një tryezë bashkëbisedimi parapriu ceremoninë e nënshkrimit nga akad. Skënder Gjinushi, kryetar i ASHSH; dhe akad. Muzaffer Seker, kryetar i Akademisë së Shkencave të Turqisë.

Dy kryetarët theksuan traditat e bashkëpunimit shkencor-akademik, tradita të cilat kanë prirje të zgjerohen përtej fushave të historisë, gjuhës, trashëgimisë; duke përfshirë së fundmi sizmologjinë, nanoshkencën, bioteknologjinë etj.

Marrëveshja përmban drejtimit kryesore të bashkëpunimit të ndërsjellë, prioritetet, mënyrat e mbështetjes buxhetore, kalendarin e realizimit etj. Përveç shkëmbimit të informacionit, botimeve dhe specialistëve, parashihet organizimi i

---


veprimtarive të përbashkëta.



## Akademikët Arben Merkoçi e Aurela Anastasi, anëtarja e jashtme e ASHSH Mira Mezini dhe prof. dr. Aljula Jubani zgjidhen nga AADF në bordin e ekspertizës shkencore akademike.

Ndërsa përparojmë përmes programit READ (Research Expertise from the Academic Diaspora), jemi të bindur se një proces përzgjedhjeje i besueshëm është vendimtar për sukses, thuhet në njoftimin zyrtar të AADF.

Kjo është arsyeja pse ne kemi ngritur një bord këshillues profesionistësh, duke përfshirë drejtues nga komuniteti shkencor dhe studiues nga universitetet më të mira në Shqipëri, BE dhe USA.



Advisory Council

**READ**  
Research Expertise from  
the Academic Diaspora

PROF. DR.  
**ARBEN MERKOÇI**  
CATALAN INSTITUTE  
OF NANOSCIENCE  
AND NANOTECHNOLOGY

Albanian-American  
Development Foundation

in cooperation with **iie**



Advisory Council

**READ**  
Research Expertise from  
the Academic Diaspora

PROF. DR.  
**AURELA ANASTAS**  
UNIVERSITY OF TIRANA

Albanian-American  
Development Foundation

in cooperation with **iie**



Coordinator Advisory Council

**READ**  
Research Expertise from  
the Academic Diaspora

PROF. DR.  
**ALJULA JUBANI**  
UNIVERSITY OF TIRANA

Albanian-American  
Development Foundation

in cooperation with **iie**



Advisory Council

**READ**  
Research Expertise from  
the Academic Diaspora

PROF. DR.-ING.  
**MIRA MEZINI**  
DARMSTADT UNIVERSITY  
OF TECHNOLOGY

Albanian-American  
Development Foundation

in cooperation with **iie**

---

Në këtë bord bëjnë pjesë tashmë me cilësinë e ekspertit akademik-shkencor kolegët Arben Merkoçi, Aurela Anastasi, Mira Mezini e Aljula Jubani, të cilët i urojmë për vlerësimin dhe rolin që u është dhënë të kryejnë.

Angazhimi i tyre për të garantuar cilësinë e kërkimit dhe zhvillimit në universitetet shqiptare është një gur themeli i programit tonë dhe ne jemi krenarë që jemi partnerë me ta për të arritur rezultate të jashtëzakonshme, vijon njoftimi i AADF.

Akad. Arben Merkoçi shkruan se ndihet krenar që, bashkë me kolegë të tjerë akademikë e profesorë, do të jetë pjesë e këtij bordi.

---

## Dijetari që ndërlihd tre kryeqytete: Prishtinën, Tiranën dhe Shkupin - sot është jubilar i ynë



- Jetë të gjatë akademik Ali Aliu, shëndet të mbarë e gjithnjë në pararojë të mendimit shkencor në studimet letrare -

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë uron anëtarin e saj të jashtëm Ali Aliu. Nesër në Prishtinë tryezë shkencore kushtuar jubileut të lindjes së tij, organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave e Arteve e Kosovës -

- Marrin pjesë e referojnë nga Tirana shkrimtari Zija Çela, dr. Arian Leka (përgjegjës i sektorit të enciklopedisë në QBEA), akad. Shaban Sinani. Pjesëmarrës në linjë akad. Matteo Mandalà, anëtar i jashtëm i ASHSH -

Disa të dhëna për veprimtarinë shkencore të Ali Aliut:

- 65 vjet i pranishëm me studime të botuara;
- Autor i 65 studimeve monografike dhe përmbledhjeve me studime (bashkë me ribotimet jo në të njëjtin vend;
- Vepra më e botuar dhe më e përkthyer (në shumicën e gjuhëve të Ballkanit "Don Kishoti ndër shqiptarët";
- Mbi 130 artikuj shkencorë të botuar dhe mbi 100 recensione;
- Përkthyes nga shqipja në gjuhë të fqinjve i 25 veprave dhe redaktor shkencor e



përgatitës botimesh për rreth 50 tituj;

- Me mbi 500 njësi bibliografike në Cobiss.al;

Hartëzimi i interesave shkencorë të tij kapërcen përtej kufirit të nënsistemeve dhe përtej kufijve të llojeve e nënlojeve.

1.	Artikull shkencor-profesional	30
2.	Artikull kritik në shtypin letrar	100
3.	Kumtime, referate, ligjërata në konferenca	4
4.	Recensione	108
5.	Polemikë, kritika, komente, diskuime, intervista	8 +2
6.	Monografi shkencore-profesionale	68
7.	Tekste mësimore	3
8.	Redaktor	47
9.	Përkthyes	25
10.	Përshtatës	13
11.	Vepra më e ribotuar dhe më e përkthyer: <i>Don Kishoti te shqiptarët</i>	11
12.	Tekst shtesë në veprën e një autori tjetër (parathënie, shenjim)	85
13.	Mbledhës, përgatitës për botim	22
14.	Recenzent (para botimit)	17

## Në Prishtinë konferencë për 90-vjetorin e akad. Ali Aliut, anëtar i jashtëm i ASHSH

- Studiuesi që shpërfill kufijtë e nënsistemeve të letërsisë shqipe dhe të kakoneve që ndajnë llojet e nënlojet e kërkimit në letërsi



Konferenca u hap me një fjalë përshëndetëse nga akad. Sabri Hamiti, kryetar i komitetit shkencor të organizimit të saj. Veprimtaria është përgatitur e zhvillohet në kuadër të protokollit të bashkëpunimit ASHSH-ASHAK. Referuesi i parë, akad. Mehmet Kraja, paraqiti një profil sintetik të Ali Aliut në të gjitha përmasat e veprimtarisë së tij. Në seancën e parë referuan edhe akademikët Matteo Mandalà e Shaban Sinani, i cili uroi jubilarin e ditës në emër të Kryesisë së ASHSH dhe i dhuroi atij një tufë me lule dhe bibliografinë (thujse) të plotë të botimeve të tij përgjatë mbi 60 vjetëve, përgatitur nga sektori i bibliotekës shkencore.

Në kumtesën e tij "Përtej kufijve të nënsistemeve të letërsisë shqipe" Sinani ndër të tjera theksoi si tiparin më të rëndësishëm të veprimtarisë shkencore të Ali Aliut shpërfilljen e kufijve të nënsistemeve të letërsisë shqipe, ndarë nga historia për shkak të gjeopolitikës.

Konceptin e nënsistemeve në letërsi e kuptojmë sipas Itamar Even-Zohar, stabilizuar në dy veprat e njohura të tij "Polysistem theory" dhe "Polysistem studies", të rivizituara prej autorit vitet e fundit, tha ai. Ky koncept, që fillimisht shërbeu për të krijuar një hierarki midis letërsisë në gjuhë amtare dhe letërsisë së përkthyer; më pas edhe midis letërsive metropolitane dhe letërsive periferike; së fundmi u zbatua edhe për letërsitë e së njëjtës gjuhë, me histori kufijsh për shkak të faktorëve historikë, duke përfshirë letërsinë e vetë vendit të origjinës së autorit, me opozicionin e saj "yiddish literature" - "hebrew literature".

Një fat të ngjashëm ka pasur edhe letërsia shqipe, e ndarë në qarqe, për shkak të alfabeteve të përdorur dhe të grupimeve fetare (E. Çabej); e rindarë, pas homogjenizimit që

solli romantizmi kombëtar, në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, për shkak të mureve gjeopolitike dhe ideologjike që vepruan.

Letërsia shqipe gjatë kësaj periudhe funksiononte së paku në katër nënsisteme: 1. Letërsia shqipe në Shqipëri, me problemet e saj të kontrollit ideologjik; 2. Letërsia shqipe në Kosovë dhe më gjerësisht ndër shqiptarët e ish-Jugosllavisë; 3. Letërsia shqipe në diasporë; 4. Letërsia shqipe tek arbëreshët; 5. Letërsia e ndaluar, letërsia e sirtarëve, letërsia e burgjeve (burglogjia, V. Zhiti, B. Kosumi).



Përballë kësaj pamjeje tej mase të copëtuar të letërsisë shqipe, e cila vazhdon ti vuajë edhe sot dëmet e shkaktuar prej kufijve të gjithfarshëm, vepra shkencore e Ali Aliut të vjen në mendje pa ndonjë kërkim të thelluar, në mënyrë thjesht empirike, nxitur prej leximeve të paqëllimta për një kumtim apo ngjarje, si shembulli i dijetarit që gjatë gjithë jetës së tij ka vështruar përtej kufijve ndarës, duke udhëtuar me një liri sfidante në gjithë hapësirën historike shqiptare, në gjithë hartën e pranisë së letërsisë shqipe si veprimtari krijuese.

"I parrethueshëm" përmes përkufizimeve të njohur prej shkencës letrare, Ali Aliu është krijues i një lirie vetjake profesionale që nuk i njeh jo vetëm kufijtë e nënsistemeve, sepse në konceptin e tij ka vetëm një letërsi, pavarësisht dallimeve për shkak të faktorëve që ndikojnë prej së jashtmi; por edhe kufijtë e zonave të interesit shkencor në pikëpamjeve të tipologjisë së llojeve dhe nënlojeve të studimeve letrare, pavarësisht formatit, madhësisë, hierarkive dhe çfarëdo dallimi tjetër.

Kjo rezulton shumë shpejt menjëherë pas lënies prapa të përshtypjeve empirike; pas konstatimit se idiomat parashkencore si "shkencëtari që bashkoi tre kryeqytete"; "njeriu i trinisë në letërsi" etj. janë krejt të pamjafta; duke ua lënë vendin kërkimeve për një profil intelektual të tij përmes të dhënave numerike, para së gjithash përmes atyre të dhënave që rezultojnë duke ndjekur në mënyrë prapavajtëse udhën krijuese prej mbi 60 vjetësh të Ali Aliut. Për këtë, me ndihmën e punonjësve të specializuara për bibliografitë (dr. Sabina

Vaqarri, dr. Mirlona Buzo dhe znj. Arta Kqiku, të cilat i falënderoj), iu drejtuam dy motorëve që përpunojnë informacionin shkencor: "Cobiss.al" dhe "Cobib.al"; për të pasur një identifikim të numerizuar me besueshmëri.

Në tërësi, duke përfshirë edhe dyfishimet, numri i rekordeve që bashkohen në emrin e Ali Aliut, prej vitit më të hershëm që edhe vetë Cobiss.al e shenjon me pikëpyetje, deri para dy vjetësh rezultojnë 1032 njësi bibliografike, në të cilat gjendet thajse i gjithë udhëtimi shkencor i tij.



Pasi këto dhëna, që kanë në vëmendje gjithçka që lidhet me emrin e autorit, prej monografive deri tek mentorimi universitar, punët si redaktor, si recensues, si drejtues projekti etj. u përpunuan me kriteret shkencore, duke përjashtuar koincidenat dhe përsëritjet, rezultuan 518 rekorde / njësi, përshkrime bibliografike, të cilat janë renditur me kronologji dhe me tipologji, sipas një standardi ndërkombëtar, të njohur si ISO 690.

Mbi këtë bazë mund të ndërtohen objektivisht, jashtë përshtypjeve empirike, itineraret e studiuesit Ali Aliu përtej kufijve të nënsistemeve e përtej kanoneve të llojeve e nënllojeve, siç pretendojmë përmes titullit të trajtesës.

Përshkrimet bibliografike, edhe pas përpunimit, janë jopërfundimtare, jo vetëm sepse mungojnë rekordet e dy vjetëve të fundme, dhe fatmirësisht jubilarin ynë vazhdon të jetë pjesëmarrës i shenjuar në zhvillimin e mendimit shkencor për letërsinë, madje duke e ndjekur procesin e saj paraalelisht, por edhe për dekonsipirimin e pasaktësisë nga vetë të dhënat:

1. Mungojnë thajse në tërësi shkrimet e autorit në "Flakën e Vëllazërimit" që dilte në Shkup, me të cilën lidhen disa vite të veprimtarisë së tij: me sa duket ende nuk ekziston një bibliografi e numerizuar e kësaj gazete;

2. Askush nuk do ta besonte, për shembull, që Ali Aliu ka gjithsej 4 pjesëmarrje në konferenca shkencore, siç raporton baza e të dhënave e "Cobiss.al"!

Studimet e Ali Aliut për shkrimtarë nga Shqipëria shtetërore përbëjnë sistem. Ska

---

asgjë rastësore apo kalimtare në zgjedhjet e tij. Përgjithësisht ai zgjedh autorin që bart një dukuri letrare, që mund të jetë raporti me pushtetet (Petro Marko, Fator Arapi, Xhevahir Spahiu); përfaqësimi i një rrjedhe letrare apo i një breznie (Poradeci, Migjeni); atipizmi në raport me zhvillimet e kohës në letërsi (Zija Çela, Koço Kosta); njohja ndërkombëtare (I. Kadare, F. Kongoli); nevoja për ndërmjetësim me lexuesin e një kohe tjetër (J. Xoxa).

Në këtë hartë të interesave parësore të Ali Aliut për autorë nga Shqipëria mungojnë dhjetëra të tjerë, veprës së të cilëve nuk u është rikthyer, ndër ta edhe Sabri Godo, Bardhyl Londo, Fatos Kongoli, Kiço Blushi, Pano Taçi, Visar Zhiti, Ilirian Zhupa etj.

Hartëzimi i kontributeve të Ali Aliut për letërsinë shqipe në Maqedoninë e Veriut është, si dhe ai i Shqipërisë, i lexuar nga majat, duke pasur si synim kryesisht vërtetimin e përpjesëtueshmërisë së autorit në leximin e letërsisë shqipe si një e tërë. Këtu janë zgjedhur kryesisht autorët me të cilët jubilarin ynë ka një marrëdhënie konstante afatgjatë. Ky hartëzim (për Maqedoninë) do të kuptohet më mirë e më plotë me një ndalesë në punën e tij si përkthyes: 12 rekorde vetëm për përkthimet nga shqipja në maqedonisht.

Sa i takon letërsisë së Kosovës, target i studiuesit është breznia e modernitetit (me Shkrelin, Podrimjen, Hamitin) dhe me të afërtit me ta.

Ka një ndryshim krahasuar me vëmendjen ndaj letërsisë në Shqipëri, për sa i takon procesit letrar në vijim. U përpoqa mos gjeja midis autorëve të studiuar prej tij Ag Apollonin, Adil Ollurin apo Gëzim Aliun, por nuk më rezultoi diçka për tu shenjuar.

Hartëzimet e paraqitura janë disenjuar thjesht për qëllime pragmatike. Vështrimit të studiuesit tonë i shfaqet me një rend të brendshëm, sipas kohës së shfaqjes së dukurisë. E njëjta sjellje e tij vërtetohet nga dr. Cobiss edhe për letërsinë shqipe tek arbëreshët, të vjetrën e të sotmen.

Nga rastet përjashtimorë, më ka tërhequr vëmendjen ndalimi vetëm kalimthi (kryesisht në antologji) tek Pashku e Din Mehmeti, po ashtu dhe tek Camaj.

1. Për Ali Aliun ka vetëm lloje prioritare (monografi, artikull shkencor), për të mëdhenjtë, por, të gjitha format e të shprehurit të mendimit shkencor-letrar janë instrumente të dobishme që i ofrohen studiuesit për të realizuar misionin e tij në trekëndëshin autor - vepër - lexues;

2. Struktura e llojeve dhe nënlojeve të zhvilluara prej tij shpreh shpërfillje ndaj kanonit të ndarjes së tyre. Prej disa dekadash është mbajtësi gjallë i nëndisiplinës së kritikës letrare;

3. Ashtu si tejkalimi i kufirit të nënsistemeve i ka dhënë mundësi studiuesit tonë të navigojë në të gjitha hapësirat ku krijohet letërsi shqipe, ashtu tejkalimi i kufijve të llojeve e nënlojeve i ka dhënë mundësi të demokratizojë marrëdhëniet me të gjitha breznitë, prej atyre tradicionale deri tek më të rejat.

Në këtë panoramë mungojnë të dhëna që ende nuk janë përpunuar në mënyrë të numerizuar, por mungojnë gjithashtu përbërëse të veprimtarisë së tij që nuk shprehet dot me numra: veprimtaria universitare, mentorimi i brezave të rinj të studiuesve, hartimi i antologjive, botimi kritik i veprave të autorëve tradicionalë apo bashkëkohorë.

---

Mungon sigurisht edhe pjesa e misionit të tij në kohëra shumë të vështira, si përfaqësues i së parës zyrë të Kosovës në Shqipëri, për çka dokumentet dhe burimet do të flasin më vonë.

Mungojnë vlerësimet e anës njerëzore të Ali Aliu, që, në mjediset ku unë jetoj, profesionale e familjare, thënë në gjuhë relative, me të drejtë konsiderohet një prej burrave më të sjellshëm të botës shqiptare.

## "Don Kishoti te shqiptarët", një histori letërsie tjetër

Ali Aliu: "Letërsia është e shenjtë: studiuesi duhet të falënderojë autorët, jo autorët studiuesit"

- Përfundon tryeza shkencore ndërakademike kushtuar 90-vjetorit të lindjes së akad. Ali Aliut. Nga ASHSH morën pjesë e referuan Matteo Mandalà, Zija Çela, Shaban Sinani e Arian Leka -

- Referuan në vijim Zejnullah Rrahmani, Nysret Krasniqi, Fatmir Sulejmani. Në fund një seancë diskutimesh -

Zija Çela: Ali Aliu - i pangjashëm mes të ngjashmëve



Kur më erdhi ftesa për këtë tryezë, megjithëse dimër, dita kishte plot dritë dhe vetiu m'u kujtua çfarë i kisha thënë njëherë Ali Aliut. I kisha thënë se gjatë vitit Prishtina vërtet ka tërheqje, por edhe Tirana ka shumë ditë me diell. Nuk e di pse, përveçse si albanolog i shquar, edhe si personalitet njerëzor, Ali Aliu më vjen në mend sidomos në ditë me diell. E kështu ndodhi që ky vegim m'u bë nxitje për t'i hedhur lirishëm ca shënime edhe në letër.

1. Akademiku 90-vjeçar, që na nderon mes nesh, ka një zakon të pashqitshëm. Kur është duke shkruar, ai sikur e këndon nën zë tekstin që po kompozon. Dhe kjo ndodh prej fjollave të frymëzimit. Nga "Katër stinët" e Vivaldit, ndoshta për harenë e saj, do ta vija gishtin te "Pranvera"

Ali Aliu i përket kritikës dhe filozofisë pozitiviste. Kur bën objekt studimi krijimtarinë e një shkrimtari, ai hedh dritë në anët më të forta të autorit, i analizon një për një, por me lupë në dorë nxjerr në pah edhe sythe që ose janë në zhvillim, ose premtojnë të zhvillohen. Në shkrimet e tij nuk ka asgjë toksike. Ai nuk helmon, as me dashje, as pa

dashje, përkundrazi, vihet në krah të shkrimtarit, të cilit i dhuron vlerësim dhe ndjesi gëzimi. Nuk ka autor që mund të ankohet se Ali Aliu ia ka ngrënë hakun, siç nuk kam dëgjuar ta ketë pohuar dikush mbipeshën, kur mund t'i jetë dhënë më tepër.

2. Ali Aliu e ka të lindur dashninë për leximin dhe pasionin e fjalës për letërsinë. Pa e patur fare qëllim, madje pa i shkuar asfare në mend, çfarë ka patur të brendshme e ka shpallur si kryemotiv qysh në fillimet e veta. Ja si mund të lexohen të bashkuar tre titujt e tre librave të tij të parë: "Kërkime e shtjellime në rrjedha të letërsisë". Tre tituj në një, kredo e plotë. Ali Aliu është studiuesi në simbiozë me "zekthat" që ka përditshmëria e kritikut. Ky është tharmi që, ashtu siç nuk e ka lënë në rini, nuk e lë rehat as në moshën e patriarkut. Kur i ka ardhur për të folur, atij nuk i ka ngrirë lapsi në dorë, madje me raste nuk është stepur për ta trajtuar një vepër edhe si kryevepër, pa manipuluar me heshtjen si element i estetikës së reagimit apo si koncept i dilemës etike. Romancierët ndoshta s'janë aq bujarë sa poetët, të cilët jo rrallë ngopen me aromën e lavdërimeve, ndërkohë që prozatori ndalet ndër paragrafë e detaje, duke kërkuar argumentin në shumësinë e tyre. Nuk po i shtyj më tej reagimet e palës së shkrimtarëve, por po them se ndodh diçka e çuditshme me palën tjetër. Në vend të presë mirënjohje nga autorët e librave që ka pëlqyer, Ali Aliu sillet vetë i pari falënderues ndaj tyre.



3. Sigurisht, me sy të lirë askujt nuk i duken shenjat e botës së brendshme. Por askush që merr guximin të shkruajë, sado të përpiqet, për një sy të stërvitur nuk mund ta fshehë transplantin e zemrës në tekstin e tij, në terma të kardiologjisë; ritmin, aritminë, suficencën, insuficencën etj. Ashtu si për çdo krijimtari, në rreshta e midis rreshtave shpirti i kritikut pulson në tekst, duke dëshmuar si ndihet fjala aty, vjen si harmoni, vjen si llogaritje matematike, rënkon nga mungesa apo kërcet nga teprimi. Modalitetet e shqyrtimit kritik janë nga më të ndryshmet, rekomandohet objektiviteti. Mirëpo kur e kanë patur prirje, edhe kritikë e studiues të shquar në botë ia kanë dalë ta arrijnë



objektivitetin jo vetëm përmes dijes, kulturës e kapacitetit mental, por edhe ndihmës së urtësisë shpirtërore.

Më duket se kjo urtësi e karakterizon tekstin e Aliut. Në pjesën e shkrimeve kritike ai nuk është i shkarkuar plotësisht nga barra emocionale, porse emocioni i ngarkohet vetë zbulimit të një thelbi, bie fjala, thelbit të përgjigjes se çfarë është e re në librin e këtij apo atij autori. Dhe nuk mund të mohohet, për vetë natyrën e tij zbulimi është ngritje e velit, njëfarë dasme e përjetshme, ai e ka në aksionin e vet emocionin.

4. Në veprën e Ali Aliut gjenden referenca, por zakonisht të natyrës pohuese, mbështetëse dhe informuese. Duke mënjanuar frymën e debatit dhe të polemikës, ai përqendrohet sidomos në faktorët e tij të analizës, në thellimin e argumenteve dhe depërtimin shpesh kapilar. Si fryt i punës së Ali Aliut, ndër të tjera, në librin voluminoz “Don Kishoti shqiptar”, që sapo është ribotuar i plotësuar, sot kemi një tablo plot ngjyra mbi krijimtarinë e disa prej poetëve e prozatorëve më të spikatur bashkëkohorë. Herë në rolin e historianit e herë të propozuesit për historianët e letërsisë, në këtë antologji vetjake të mendimit kritik gjejmë problematika të rëndësishme të estetikës dhe përgjithësisht të teorive letrare. Aty shtrohen pyetje e jepen përgjigje për çështje bazike të prozodisë, individualitetit dhe narracionit, raportit të reales me irrealen, gjuhës së tekstit e të nëntekstit etj.

5. Njëherë, teksa bisedonim për një shkrim të botuar në gazetë, vërejtja se Aliut i kishte mbetur peng përse redaktori kishte ndajshuar pranë emrit të tij ofiqin e akademikut. Dhe këtë nuk mund ta merrje as si shtirje, as si trill, aq më pak si rastësi. Ai gjithnjë nuk ka kërkuar ndonjëpotencim me statuset zyrtare, për ta lënë lexuesin të lirë në gjykimin e tekstit, duke ia respektuar mendimin e pavarur dhe mënyrën e leximit. Tekefundit, tërë jetën edhe vetë është treguar një lexues i hatashëm, nga ata të thekurit, të cilët lënë sytë mbi shkronjat e tjetërkujt.



6. Por si lexon Ali Aliu? Kam krijuar një përshtypje nga biblioteka e tij private. Me

---

gjasë, me t'iu ndezur ndonjë shkëndijë përgjatë lëçitjes, ai hedh shënime në margjinat e librit, në ato hapësirat e bardha sa një pentagram. Si ta përfundojë leximin, do të këqyrë pikërisht këto nota të shpejta. Nëse ka mundur të nxjerrë esenca, ndihet thujse gati për shkrimin; nëse ende jo sa duhet, i rikthehet librit pjesërisht. Përndryshe, me kalimin e kohës ato shkëndijat ftohen dhe shënimet nuk dalin nga raftet. Mes mënyrave të larmishme, pse jo, mua më pëlqen gjithashtu ky qëndrim, që afron me krijimtarinë e mirëfilltë: të punosh jo vetëm për të kënaqur të tjerët, por së pari për të ndier kënaqësi vetë gjatë procesit tëshkrimit.

Ali Aliu ka lexuar shumë libra të rëndësishëm. Por ma do mendja nuk ka profesionist që të ketë lexuar sa ai edhe libra të parëndësishëm. Nëpër vite, për t'i dhënë skenë emrin që ka, kam parë si i "vërsulen" në panairë duke i dhuruar libra prej kahmos. Siç është e pritshme, nuk mungojnë autorë të afirmuar, por nuk mungon sidomos bylyku i fillestarëve, amatorëve të vonuar e maniakëve të shkrimit. Si drejtin e ndiejnë këta se kanë gjetur "babaxhanin" e duhur?! Sepse Aliu, me torbat plot, shkon pastaj përtej mirësjelljes: i lexon thujse të gjithë ato libra, madje cili është me fat edhe recensionohet.

Kam menduar ndonjëherë se Aliu nuk është fort i rreptë si kontrollor. Por më mirë genuin, sesa ta lidhte veten duke u bërë autocensor. Natyrisht, ne do të kishim edhe ashtu një profil letrar, por jo kaq të personalizuar prej shenjave të tij, domethënë një personalitet të pangjashëm midis të ngjashmëve, ose të ngjashëm me të pangjashmit. Shkurt fjala, një kritik kaq empatik.

7. Në përvojën time, kur shkruaj një roman, synoj të kaloj në katër nivele, që nuk është rasti të përmenden. Por ekziston edhe një i pestë. Ky është niveli, kur kritika letrare zbulon në veprën e shkrimtarit çfarë s'e ka ditur më parë vetë autori i saj. Kështu ndodh edhe me kritikët e studiuesit, jo rrallë dinë për veten më pak se të tjerët dinë për ata. Dhe sa mirë kur kolegët janë të gatshëm t'ia thonë.

8. Dhashtë Zoti që, një ditë, të jemi çliruar përfundimisht nga bizantinizmi i trashëguar, ai i llojit që, siç thotë Brodskij, sa më afër qëllimit të ndritur të jetë dikush, aq më të mjegullta ia bëjmë mundësitë e arritjes. Afërmendsh, auditori më i drejtpërdrejtë për çfarë shkruhet sot janë bashkëkohësit. Por unë besoj se do të mbizotërojnë interesat e pastra, të cilat punën e çmuar të studiuesve tanë do t'ia përcjellin edhe së ardhmes.

9. Ah, edhe diçka në fund, meqë pajtohem se çka është e mjaftueshme, mbetet gjithnjë e pamjaftueshme. Po, gjatë vitit Prishtina ka vërtet tërheqje, por edhe Tirana ka shumë ditë me diell...

Vijon në 100-vjetorin e lindjes.

## Në 80-vjetorin e Konferencës së Bujanit

- Tryezë shkencore në Prishtinë, veprimtari e përbashkët e ASHSH dhe ASHAK, në kuadër të protokollit të bashkëpunimit dyvjeçar -

- Marrin pjesë me kumtime akademikët Beqir Meta e Marenglen Verli, prof. dr. Hamit Kaba dhe prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi -

Punimet e konferencës u përshëndetën nga akad. Jusuf Bajraktari, kryetar i komitetit shkencor-organizues.

Prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi paraqiti kumtesën me titull "Parimet e "Kartës së Atlantikut" dhe kuvendet shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore", pjesë të së cilës jepen në vijim.



"Karta e Atlantikut" në thelb ishte një deklaratë e përbashkët e parimeve të përgjithshme mbi të cilat nënshkruesit synonin të bazonin një marrëveshje paqeje pasi regjimi nazist të përmysej; ajo nuk ishte as detyruese dhe as nuk përmbante detyrime ligjore për Britaninë e Madhe dhe SHBA. Karta shënoi një pikë kulmore, sepse ishte deklarata e parë zyrtare e dy aleatëve të mëdhenj për politikën e pasluftës për Europën. Karta u drejtohej njësoj edhe aleatëve, edhe popullsisë së shteteve armike.

Karta përbëhej nga tetë pika, ku përfshiheshin: heqja dorë nga zgjerimi territorial, barazia në tregtinë botërore dhe lëndët e para, heqja dorë nga përdorimi i forcës, e drejta

---

e vetëvendosjes së popujve (ndonëse jo në një formulim të drejtpërdrejtë), bashkëpunimi më i ngushtë ekonomik i të gjitha kombeve për arritjen e kushteve më të mira të punës, kompensimin ekonomik dhe mbrojtjen e punëtorëve, sigurinë e popujve nga tirania, lirinë e deteve dhe çarmatimin e kombeve për të siguruar një sistem sigurie të qëndrueshme.

Në janar 1942, SHBA, Britania e Madhe, Bashkimi Sovjetik, Kina si dhe 22 vende të tjera u angazhuan për parimet e "Kartës së Atlantikut". Dokumenti i shkurtër u bë i njohur si "Deklarata e Kombeve të Bashkuara". Tre vjet më vonë, në qershor 1945, përfaqësuesit e 50 vendeve nënshkruan dokumentin themelues të asaj që sot quhet Organizata e Kombeve të Bashkuara. Parimet e "Kartës së Atlantikut" u shndërruan në yllin polar të qëndresës nazifashiste, sidomos për vendet e pushtuara, ku bënte pjesë dhe Shqipëria.

Dy ishin çështjet më emergjente që shtroheshin në këtë situatë në Shqipëri e më gjerë: lufta për çlirimin e vendit nga pushtuesit nazifashistë dhe rivendosja e pavarësisë kombëtare, si edhe trajtimi i Shqipërisë e problemeve të saj etnike në konferencat ndërkombëtare shtetformuese të pasluftës.

Parimi i vetëvendosjes risillej përsëri si një zgjidhje për popujt e pushtuar. Në këtë mënyrë u kthye shpresa dhe vetëvendosja u shndërrua në fjalëkalimin me të cilin pritej të zgjidheshin problemet e trashëguara politike, etnike, e territoriale në marrëdhëniet ndërmjet shteteve e fqinjëve.

Si u përdorën parimet e "Kartës së Atlantikut" në Konferencën e Pezës, Mbledhjen e Mukjes dhe Konferencën e Bujanit? A ka ndonjë ngjashmëri ndërmjet tyre në pikëpamje të qëndrimit dhe mbi të gjitha një logjikë vazhdimësie në kuadër të zgjidhjes së çështes kombëtare?

Në konferencën e Pezës, produkti kryesor i së cilës ishte krijimi i FNÇ dhe organizimi i luftës kundër pushtuesve, u kërkua që bashkimi kombëtar i gjithë shqiptarëve të kryhej pa dallim feje, krahine, klase dhe rryme politike në luftë për Shqipërinë e lirë, të pandashme, independente e demokratike. Të gjithë të pranishmit ishin të vetëdijshëm që një politikë e tillë u përgjigjej interesave, aspiratave e kërkesave të ngushtme të popullit që e donte vendin të lirë e të bashkuar. Po ashtu, një politikë e tillë i mundësonte PKSh-së të bënte gjithë masat popullore për vete dhe të kishte më të lehtë marrjen në dorë të drejtimit të luftës kundër pushtuesit gjatë luftës, si një kusht thelbësor për tu shndërruar në faktor pushteti pas luftës. Këtë gjë e pohon edhe një nga eksponentët e Ballit Kombëtar, Faik Quku, i cili shkruan se "me Konferencën e Pezës dhe me organizimin e Nacionalçlirimtares, Partia Komuniste e naltësoi prestigjin e saj; tashti ajo paraqitej si përfaqësuesja legale e popullit shqiptar: kishte fitue lirinë e plotë të veprimit"

Në Pezë, PKSh artikuloi për herë të parë qëndrimin e saj për çështjen e Kosovës.

---

Si konferencë pluraliste që ishte, sigurisht që aty ishte vendi, por edhe e domosdoshme të prezantoheshin edhe qëndrimet ndaj një çështje të tillë të rëndësishme. Në Konferencë u arrit në marrëveshjen që problemi i Kosovës të zgjidhej në bazë të parimit të vetëvendosjes së popujve. Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, që u krijua në Pezë, do t'i jepte ndihmë të pakursyer popullit në Kosovë të ngrinte këshillin e vet nacionalçlirimtar dhe të merrte pjesë në luftën pa kompromis kundër pushtuesit, e cila do ti krijonte atij mundësinë të fitonte të drejtën e vetëvendosjes, thuhet në procesverbalin e mbajtur në konferencë.

Fil pas Konferencës së Pezës, PKSh e paraqiti qëndrimin e saj për Kosovën edhe në një artikull të "Zërit të Popullit", me rastin e botimit të numrit të parë të "Zanit të Popullit" të Kosovës.

Një artikulum më të plotë kjo çështje gjeti në Mbledhjen e Mukjes më 1-3 gusht 1943. Pa hyrë në detaje për organizimin e saj, në këtë takim u kërkua luftë imediate kundër zaptuesit fashist, krijimi i një komiteti të përbashkët me emrin "Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë" dhe krijimi i Shqipërisë etnike mbi të drejtën universale të vetëvendosjes, të garantuar prej "Kartës së Atlantikut". Vendimet e saj nuk patën jetëgjatësi, pasi marrëveshja e arritur ndërmjet Frontit dhe BK u prish disa dita më pas.

Dy janë qëndrimet që mendojnë ende sot opinionin: E para, Enver Hoxha u detyrua të prishte marrëveshjen si pasojë e presionit jugosllav për çështjen e Kosovës - një tezë që është mbështetur nga historiografia jugosllave e paraviteve 1990 dhe nga përfaqësues të revizionimit të historisë pas viteve 1990 dhe e dyta, krijimi i Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë dhe rreziku që paraqiste ky organizim për FNC, si një strukturë e dalë rishtas, që përjashtonte si FNC ashtu edhe PKSh nga drejtimi i luftës.

Është qartësisht e kuptueshme që Partia Komuniste Jugosllave nuk mund të miratonin vendime që rrezikonin mospërfshirjen e Kosovës brenda kufirit jugosllav pas luftës, por ky nuk mund të jetë shkaku kryesor i prishjes së marrëveshjes. Edhe vetë Enver Hoxha në Konferencën e Labinotit, më 4-9 nëntor 1943, artikuloi të njëjtin mendim si ballistët në Mukje, në lidhje me të ardhmen e Kosovës, pra, që e ardhmja e Shqipërisë etnike varej nga respektimi i "Kartës së Atlantikut". Në rezolucionin e konferencës së Labinotit shkruhet: "Çështja e Kosovës dhe e Çamërisë do të zgjidhet në bazë të Kartës së Atlantikut, në bazë të parimit të vetëvendosjes së popujve; garancia më e madhe për triumfin e këtij principi është vetë lufta që bëjnë dhe do të bëjnë Kosova e Çamëria krahas për krahas me popujt jugosllav e grek, për të zhdukur fashizmin italian e gjerman dhe bashkë me të të gjitha tendencat imperialiste e shoviniste kudo në botë e veçanërisht në Ballkan". Në ndryshim nga Mukja, këto deklarata u bënë me praninë e përfaqësuesve jugosllavë në sallë. Sikurse shohim, ky qëndrim është shumë më i fortë e i drejtpërdrejtë se vendimi i marrë në Mukje. Atëherë bashkimi etnik nuk mund të ketë qenë arsyeja kryesore e prishjes së Mukjes.

---

Arsyeja e vërtetë e dështimit në Mukje duhet kërkuar te prishja e strukturave të organizimit e drejtimit të luftës dhe krijimi i strukturave të reja, ku, ndonëse pjesëmarrja e anëtarëve të FNÇ dhe BK ishte e barabartë, PK ishte në minorancë.

E thënë shkurt, të dyja palët po mendonin për pushtetin e pasluftës, çka është krejt normale. Balli Kombëtar në fakt ishte po aq i etur për pushtet sa edhe Partia Komuniste. E ndryshme ishte rruga që ata zgjodhën për të arritur pushtetin. Partia Komuniste shndërroi luftën kundër pushtuesit si moton e saj. Madje, thirrja e saj ishte Vdekje Fashizmit Liri Popullit, ndërsa ajo e Ballit Kombëtar Shqipëria e Shqiptarëve Vdekje Tradhtarëve. Logjikisht për ta tradhtarët ishin ata që po luftonin kundër pushtuesve, pra, pjesa më e madhe e popullit shqiptar. Dhe nën petkun e rrezikut komunist, Balli Kombëtar nuk ngurroi të bashkohej me pushtuesit gjermanë. Askush nuk mund të parashikonte në këtë kohë se çfarë do të ndodhte pas përfundimit të luftës, e aq më pak në Shqipëri. Ndërkohë që Balli deklaronte mbrojtjen e vlerave demokratike, vihej në shërbim të një vendi antidemokratik. Kështu që, për të ardhur në pushtet pas luftës, duhej që Balli Kombëtar më parë të mënjanonte konkurrentët komuniste, që tashmë ishin bërë shumë popullorë. Ajo që nuk u arrit në tavolinë në Mukje, do të tentohej të bëhej me armët e gjermanëve dhe në luftë përkrah tyre kundër formacioneve partizane.

Nuk duhet harruar që krijimi i "Shqipërisë së madhe" nga pushtuesit italianë dhe më pas ai i "Shqipërisë së re" nga nazistët, ndonëse për shqiptarët e Kosovës krijonte një mbrojtje qoftë edhe të përkohshme ndaj rrezikut serb, ishte një argument shtesë për jugosllavët, për të dënuar si reaksionare e bashkëpunëtore me nazizmin gjithë popullsinë së Kosovës. Parë në këtë këndvështrim, kjo është një njollë shumë e errët që u bie qeverive kolaboracioniste të Tiranës, pasi qartazi bashkëpunimi me pushtuesit e dëmtoi çështjen kombëtare.

Në ndryshim nga dy kuvendet e para shqiptare që u përmenden, padyshim që shpresat për vetëvendosje të shqiptarët e Kosovës u ngjallën vetëm kur kjo e drejtë u shpall nga Konferenca e Bujanit, pasi ky ishte vërtet i vetmi kuvend përfaqësues i Kosovës në Luftën Antifashiste Çlirimtare, përbërja e të cilit pasqyronte gjendjen reale etnike të përbërjes së Kosovës. Në kuvend morën pjesë edhe përfaqësues të PKSh, çka sot tentohet që të mos thuhet fare.

Në dosjen sekrete për Fadil Hoxhën të shërbimit sekret jugosllav, e publikuar në librin "Fadil Hoxha në vetën e parë", me shënime dhe parathënie të Veton Surroit, botuar në Prishtinë në vitin 2010, shkruhet se në mënyrë të pakontestueshme është konstatuar se Fadil Hoxha, sipas marrëveshjes me Enverin, në mënyrë të vazhdueshme nga kthimi nga Shqipëria e ka informuar atë për të gjitha ngjarjet e rëndësishme në Kosmet. "Është marrë vesh me Enverin rreth organizimit të Konferencës së Bujanit, ia ka dërguar Rezolutën e Bujanit dhe Proklamatën një muaj më herët seç i është dërguar Shtabit Kryesor të LNÇ të Jugosllavisë dhe shokut Tito, i ka shkruar për gjendjen në Lëvizje, për

---

Kryengritjen e Drenicës, represionin mbi ballistët dhe kryengritës".

Në një farë mënyrë kjo gjen përkrahje edhe në një trakt që PKSh hodhi në Kosovë në dhjetor të vitit 1943, para se të mbahej Konferenca e Bujanit. Në të i bëhej thirrje popullit kosovar të rrokte armët e të bashkohej me serbët e malazezët dhe të godiste okupatorin e tradhtarët që kërkonin t'i ndanin e ti përçanin. E vetmja rrugë e shpëtimit dhe e përmbushjes së dëshirave tuaja, thuhej në trakt, është lufta që do t'i bënin okupatorit tok me popujt e tjerë të Jugosllavisë, është lufta nacionalçlirimtare që do t'u sigurojë të drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputje.

Afërsisht një muaj më parë, më 29 nëntor 1943, në mbledhjen e dytë të KANÇJ (AVNOJ) që u mbajt në Jajcë të Bosnjes, Tito kishte shpallur krijimin e federatës jugosllave. Në rezolutën përmyllëse përmendeshin të gjithë popujt e Jugosllavisë, me përjashtim të shqiptarëve e Kosovës. Një ditë më vonë, më 30 nëntor, pikërisht kur "Tre të Mëdhenjtë" ishin mbledhur për konferencën e tyre në Teheran, Titoja ia transmetoi udhëheqjes sovjetike vendimet e marra. Stalini u paraqit i zemëruar dhe e përshkroi formimin e qeverisë së përkohshme si një "thikë pas shpine për Bashkimin Sovjetik". Ai kishte frikë nga reagimet e ashpra të aleatëve perëndimorë, të cilët - ashtu si udhëheqja sovjetike - njihnin zyrtarisht qeverinë jugosllave në mërgim në Londër. Nëse Stalini luante rolin apo ishte në dijeni, mbetet ende e paqartë. Por është i njohur fakti se nga tetori deri më 26 nëntor Titoja i ka dërguar Stalinit të paktën katër telegrame, ku e informonte mbi planet për krijimin e qeverisë së tij.

Çuditërisht, britanikët reagues me qetësi ndaj vendimeve të Titos. Prej majit 1943 pranë shtabit të Titos vepronte një mision ushtarak britanik që dërgonte rregullisht raporte te Churchill, të cilat nga kritikët vlerësoheshin si të njëanshme. Këto raporte bënë që qeveria e Londrës të rivlerësonte pozicionin e saj ndaj Jugosllavisë. Gjithsesi, në Teheran u bë e qartë se britanikët ishin të gatshëm për njohjen e fitoreve ushtarake të Titos dhe si pasojë të hapur për një ndryshim kursi ndaj tij. Në historiografinë antikomuniste serbe ky veprim ka hyrë në terminologji si "tradhtia britanike".

Krijimi i Jugosllavisë federale, ashtu edhe ardhja në pushtet e Titos, tashmë ishte pothuajse e pranuar dhe mbi të gjitha, edhe fati i Kosovës ishte vulosur.

Në fakt, para se serbët të flasin për "tradhtinë britanike", u takonte shqiptarëve të flisnin për tradhtinë jugosllave, me saktë tradhtinë e Partisë Komuniste Jugosllave. PKJ ndoqi një politikë të padrejtë në çështjet nacionale, e cila ishte në fakt një vijë e maskuar nacionaliste. PKJ nuk u krijoi perspektivat përkatëse shqiptarëve të Kosovës për të luftuar fashizmin dhe të ishin të sigurt që pas luftës ata do të fitonin të drejtën e vetëvendosjes. Deklaratat e saj të turbullta dhe parimore nuk mund të ishin bindëse për kosovarët, të cilët nuk mund të besonin në drejtësinë e jugosllavëve, sidomos pas masakrave të kryera nga serbët ndaj tyre. PKJ nuk krijoi asnjë komitet të veçantë nacional për Kosovën dhe Metohinë, në të cilin drejtimin ta kishin në dorë vetë shqiptarët. PKJ bëri të pamundurën

---

të pengonte në Kosovë kultivimin e frymës së atdhedashurisë të shqiptarët dhe të mos lejonte që krahas flamurit jugosllav të valëvitej edhe flamuri shqiptar, çka do të kishte shërbyer si një shtysë e madhe mobilizuese në luftën kundër fashizmit.

Me të drejtë lind pyetja, po PKSh çfarë bëri?

Në një letër që Enver Hoxha i dërgon Stalinit [KQ të PKp (b)] më 2 shtator 1949 për parahistorinë e lindjes së çështjes kosovare dhe metodat e zgjidhjes së saj, ku Hoxha bën edhe një "mea culpa" të gjatë në lidhje me marrëdhëniet e tij me Titon gjatë luftës për çështjen e Kosovës, ai thekson se ne e patëm vlerësuar si të papërshtatshme shtrimin e çështjes së bashkimit të Kosovës me Shqipërinë pikërisht atëherë kur lufta ishte në kulmin e saj. "Sipas mendimit tonë, shqiptarët e Kosovës duhej të luftonin kundër fashizmit në kuadrin e shtetit jugosllav dhe vetëm pas fitores kjo çështje duhej të zgjidhej midis dy partive komuniste motra dhe regjimeve demokratike popullore të cilat do të vendoseshin në Shqipëri dhe Jugosllavi pas ngadhënjimit mbi armikun".

Pas luftës qeveria e Tiranës e kishte të vështirë, në mos të pamundur, qoftë në pikëpamje politike, diplomatike, por edhe ideologjike të kërkonte në konferencën e Paqes së Parisit bashkimin me Kosovën. Kosova në përfundim të luftës ishte bërë pjesë e Republikës së Serbisë, kufijtë e së cilës ishin të njohura ndërkombëtarisht që në momentin që Serbia u bë pjesë e Jugosllavisë. Kësisoj, çështja e Kosovës ishte shndërruar tashmë në një çështje të brendshme të Serbisë dhe me kushtetutën e vitit 1946, kjo çështje nuk mund të diskutohej më, për aq kohë sa do të ekzistonte Jugosllavia.

Po ashtu, Jugosllavia në këtë kohë ishte e vetmja mbështetje e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. Të gjitha përpjekjet e komunistëve shqiptarë për të vendosur kontakte direkte me Bashkimin Sovjetik ishin refuzuar, duke u thënë që "keni Jugosllavinë pranë". Jugosllavia ishte shtet nënshkrues i kartës themeluese të Kombeve të Bashkuara dhe palë fituese e luftës. Çështjet territoriale u diskutuan në Paris vetëm për palët humbëse. Më tej, si BS ashtu edhe Jugosllavia e shikonin çështjen e Kosovës si një problem të brendshëm, i cili do të zgjidhej me krijimin e Federatës Ballkanike. Megjithatë, në kohën e nënshkrimit të traktatit me Jugosllavinë në vitin 1946, qeveria shqiptare mendoi se kishte ardhur koha të ngrihej çështja e Kosovës dhe Metohisë dhe Enver Hoxha i kërkon Titos të shprehet për këtë gjë. Titoja përgjigjet se "Kosova i përket Shqipërisë dhe duhet të bashkohet me Shqipërinë: ne këtë e dëshirojmë me gjithë shpirt, por në momentin e tanishëm nuk mund të lejojmë një gjë të tillë, sepse reagimi i serbomëdhenjve është ende shumë i fuqishëm, kështu që ky akt i drejtë mund të na sjellë vetëm dëm".

Që Titoja ndodhej nën presionin serb e pranon edhe ai vetë në një intervistë që i dha gazetarit George W. Hoffmann, kur ai e pyeti për lëvizjen e tij më të vështirë politike. Mareshalli u përgjigj pa hezitar: "T'i bindësh serbët të pranojnë krahinat e Vojvodinës dhe të Kosovës është e pamundur". Titoja vetë ishte i mendimit se Kosova duhej të ishte "republikë me status të veçantë në Jugosllavi", por kjo nuk ishte e mundur,



---

se serbët nuk do të pranonin.

Pas prishjes Tito-Stalin Enver Hoxha i propozonte Bashkimit Sovjetik çlirimin e popujve të Jugosllavisë me luftë e gjak nga regjimi i Titos. "Çfarë hapash mund të ndërmerren tani popullsia e Kosovës? Ne mendojmë se popullsia e Kosovës, e Metohisë, e Maqedonisë dhe e Malit të Zi duhet të luftojnë për çlirimin e vet po ashtu, siç do të luftojnë edhe popujt e tjerë të Jugosllavisë".

Nuk mund të themi dot nëse edhe vetë Hoxha ka besuar se ky skenar mund të realizohej, por të krijohet përshtypja se në këtë raport të gjatë ai në thelb propozon të realizohet pikërisht ajo që nuk ndodhi gjatë luftës dhe sigurisht që ky propozim kurorëzohej me propozimin që Kosova, Metohia dhe një pjesë e Maqedonisë që kufizohet me Shqipërinë, pas çlirimit të Jugosllavisë nga thonjtë e Titos dhe të imperializmit, duhej t'i bashkoheshin Shqipërisë.

## Redaksia e inxhinierive dhe teknologjive e "Enciklopedisë shqiptare" përfundon përgatitjen e fjalësit paraprak

- Nis puna për njësimin e listave me redaksitë gjegjëse në Kosovë
- Mbledhje pune e redaksisë, nën drejtimin e akad. Jorgaq Kaçanit, përgjegjës i saj, me praninë e anëtarëve, profesorë të fushave të ekspertizës: Rozana Troja, Flamur Bidaj, Neritan Shkodrani e Spiro Drushku



Gjatë bashkëbisedimit u paraqitën shqetësimet me të cilat janë përballur anëtarët e redaksisë, para së gjithash për të pasur kritere ndihmëse që pengojnë subjektivizmat në përzgjedhjen e personaliteteve.

U theksua se enciklopeditë, siç është dhe kuptimi i termit, kanë strukturë e raporte të tjera midis katër kategorive: personaliteteve (përgjithësisht emërtimeve të përveçme); ngjarjeve; zhvillimeve dhe termave të përgjithshëm të dijes. Në fjalorët enciklopedikë është ndryshe, personalitetet kanë përqindje më të madhe. Një arsye tjetër që na urdhëron përzgjedhje të rreptë është se ESH është libër kujtese kombëtare, kërkesat shumëfishohen duke kaluar nga trashëgimia e një shteti (Shqipëri, Kosovë, siç janë ato të paraqitura në FESH dhe FEK), në trashëgimi të botës shqiptare.

Me fillimin e fazës së dytë, të përzgjedhjes, metodologjikisht do të fitohej kohë duke e ndarë procesin në tri pjesë: fillimisht konfirmohen të padiskutueshmit; më pas shqyrtohen të krahasueshmit; dhe në fund vendoset për të diskutueshmit, të cilët, sipas

---

rastit, grupohen në artikuj përmbledhës, paraqiten tek fjala-referencë e përgjithshme (ministër, deputet, profesor, mjek, mjeshtër) ose vendoset që nuk kanë shkallë përfaqësimi për të kapërcyer portën drejt ESH. Kjo si për personalitetet, ashtu dhe për ngjarjet dhe zhvillimet.



U rekomandua që gjatë bashkëpunimit me redaksitë e së njëjtës fushë në Kosovë të zgjidhen paraprakisht dy probleme: njësimi në terminologji dhe caktimi i një pragu të njëjtë për personalitetet dhe madhësinë e artikullit për çdonjërin kategori prej tyre.

U shtrua problemi i nevojës së ilustrimeve (tabela, skica, diagrama, grafikë, foto) dhe u pranua si rregull që këto duhet të jenë posaçërisht për botimin dhe vetëm në raste të rralla mund të huazohen nga burime të tjera, duke shenjuar gjithnjë burimin dhe autorësinë.

Prof. Spiro Drushku do të veprojë në emër të redaksisë me kolegët në Kosovë për njësimin e listave, shmangien e dyfishimeve dhe përgatitjen e takimeve të punës, në linjë ose me prani fizike.

## Anëtarët e Akademisë së të Rinjve sot



1. Aulon Shabani (elektroteknikë);
2. Erald Sino (financë);
3. Joniada Bajraba (sociologji);
4. Jonilda Llupa (kimi);
5. Klaudio Peqini (fizikë);
6. Ledia Vasjari (biologji)
7. Redion Luli (drejtësi);
8. Resul Telaj (gjuhësi);
9. Romina Muka (informatikë).

Rikonfirmuar nga anëtarësia e mëparshme:

1. Belfjore Qose (letërsi);
2. Shaniko Allajbeu (kimi).

Kandidatët Arbër Pecani, Besmir Premalaj dhe Manjola Zaçellari u vlerësuan për arritjet e tyre cilësore në kërkim dhe u rekomandua të përfshihen në komisionet e përhershme të fushës përkatëse, në respekt të kriterit moshor.

Përgëzime dhe suksese në rrugëtimin e përbashkët.

---

## Takime pune në Kryesinë e ASHSH me drejtorin i Institutit të Arkeologjisë akad. A. Bunguri dhe drejtorin e Institutit të Historisë prof. Hamit Kaba

- Në rend të ditës probleme të planifikimit institucional e individual të veprimtarisë shkencore; çështje të mbështetjes së punës së kërkuesve shkencorë; për disa ndryshime të mundshme në strukturimin e periodikëve dhe dhënie mendimi për legjislacionin për trashëgiminë -



Bashkëbisedimi u drejtua nga akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave, i cili theksoi në fillim se takime të tilla periodike për të qenë të informuar janë të dobishme dhe bëhen në respekt të autonomisë së instituteve të albanologjisë dhe të përgjegjësisë së përbashkët si një sistem kërkimi i njësuar.

Akad. Adem Bunguri informoi se gjatë tre muajve të parë të vitit planet e punës janë rishikuar, me qëllim që të ketë një ndarje proporcionale të projekteve dhe ngarkesa të jetë e realizueshme. Është vendosur që çdo kërkues-arkeolog të ketë jo më shumë se dy projekte, ndryshe do të mashtronim veten. Është e pamundur të ndiqen më shumë se dy projekte njëkohësisht. Në përzgjedhje kemi ndjekur kriterin e përputhshmërisë me prioritetet e kërkimit në institucion. Kjo ka dhe ndikimin e vet në përdorimin e burimeve financiare.

Problemi i përzgjedhjes kritike të projekteve u theksua edhe nga prof. dr. Neritan Ceka, kryetar i komisionit të përhershëm të arkeologjisë.

Kryetari Gjinushi tha se është e dukshme se duhet munduar për një ripërcaktim më të qartë të strategjisë së kërkimeve arkeologjike, duke vepruar menjëherë për zgjidhjet

me karakter imediat. Kjo duhet të bëhet duke ruajtur si prioritet sitet/projektet e mëdha, duke grupuar projekte të afërta dhe duke mënjanuar shpërndarjen në pika të parëndësishme, që mund të jenë me dobi vetjake për drejtuesin, por jo për institucionin.



Shqetësim institucional për legjislacionin për trashëgiminë është ndërhyrja në disa kompetenca që i takojnë ekskluzivisht Institutit të Arkeologjisë, si autoritet i vetëm për të realizuar gërmime arkeologjike për qëllime shkencore dhe për gërmimet e shpëtimit në rastin e ndërtimit të veprave të mëdha që prekin nëntokën (vepra hidrike, gazsjellës etj.). U vendos që për të propozuar amendimet në ligj të ngrihet një grup pune, i cili, ndër të tjera, të specifikojë terminologjikisht nocionin "gërmim arkeologjik" dhe ekskluzivitetin e IA për këtë, duke bërë dallimin me "hulumtimin arkeologjik"; si dhe duke mbyllur shtigjet e keqpërdorimit të trashëgimisë arkeologjike; çështje të shtruara nga akademikët Vasil S. Tole e Gëzim Hoxha.

Në takimin e dytë prof. dr. Hamit Kaba njoftoi se planet vjetore të punës individuale janë miratuar, duke bërë përputhjet e nevojshme me përparësitë. Ai kërkoi realizimin e marrëveshjeve me arkivat për të mundësuar dhënien pa pagesë të kopjeve të dokumenteve për punonjësit e autorizuar nga IH. Për këtë ai u informua se është arritur dakordësia me DPA për shtimin e një neni në marrëveshjen ekzistuese për dhënien pa pagesë të kopjeve për qëllime studimi. Për kërkesën që një marrëveshje e tillë të negociohet edhe me Arkivin e MEPJ u premtua se do të ndiqet, ndërsa për pagesën e faturave të dokumenteve të porositura në arkiva jashtë vendit kjo të bëhet pasi kërkuesi të ketë depozituar në arkivin e institucionit një kopje të tyre, duke i ruajtur të drejtën e shfrytëzimit deri në përfundim të punës kërkimore. Hë për hë instituti mund të marrë përsipër pagesa të kufizuara për kopje dokumentesh në Arkivin e MEPJ.

U vërejt se në planet vjetore të historianëve sundojnë probleme të historisë së shek.

---

XX, megjithëse IH sapo ka botuar pesë vëllime të historisë së Shqipërisë për periudhën nga Shpallja e Pavarësisë deri sot. Problem tjetër është ekuilibrimi i raporteve midis periudhave historike, sidomos lidhur me shekullin e Rilindjes dhe Mesjetën.

Më tej u shtrua çështja e ristrukturimit të revistave shkencore, për shkak të përshtatjes me kërkesat ndërkombëtare të indeksimit. Këto kërkesa nuk i kemi hartuar ne dhe nuk i ndryshojmë dot ne, tha akad. Gjinushi. Indeksimi i revistave tona nuk zgjidhet me lutje e kërkesa, indeksimi është njohje fakti, njohje gjendjeje. Kërkesa që revistat albanologjike të trajtohen si "rast specifik" (neni 15) me marrëveshje me MAS mund të adresohet; për këtë drejtuesit e instituteve dhe të periodikëve mund të propozojnë e të vendosin vetë, por duhet kuptuar paraprakisht se zgjedhja e kriterëve ndryshe prej atyre ndërkombëtare do të thotë të mbetesh jashtë platformave të mëdha Scopus, Web of Science etj. Nëse jeni të kënaqur vetëm me indeksim të brendshëm, kjo është një zgjedhje, por jo më e mira.

---

**Kryesia e Akademisë së Shkencave uron në ditën e lindjes akademik  
Shaban Sinanin**



Akad. Shaban Sinani, sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë ka sot ditëlindjen.

Kryesia e AShSh i uron:

Gëzuar ditëlindjen miku dhe kolegu ynë i nderuar! U bëfsh 100 vjeç e paç sa më shumë suksese në krijimtari !

Akad. Shaban Sinani është studiues i kulturës tradicionale shqiptare (etnos, epos, mitologji, identitet, etnotip); i folklorit dhe i letërsisë; profesor, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Kreu studimet e larta në degën e gjuhës shqipe e të letërsisë në UT (1982).

Punoi si gazetar i Zërit të popullit; ndihmës i Kryetarit të Shtetit për çështjet kulturore (1985-1992); punonjës shkencor e përgjegjës departamenti në Institutin e Kulturës Popullore (1992-1999), Drejtor i Përgjithshëm i Arkivave (1999-2005); punonjës



---

shkencor e shef departamenti në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë (2005-2016); sekretar shkencor në Seksionin e Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike të Akademisë së Shkencave (2016-).

Ka botuar mbi 30 libra monografikë e përmbledhje me studime, në shqip e në gjuhë të huaj, në fushën e etnologjisë e të folklorit të krahasuar; të historisë e shkrimeve dhe dorëshkrimeve; për raportet ndëretnike dhe ndërkulturore; studime letrare dhe historiografike.

Bashkautor në disa vepra shkencore dhe përkujdesës e përgatitës i një numri botimesh të tjera. Pjesëmarrës në ekspedita kërkimore antropologjike kombëtare brenda dhe jashtë vendit. Profesor i ftuar për lëndët etnokulturë dhe trashëgimi kulturore, supervizor e drejtues shkencor për teza doktorate në disa universitete jashtë vendit.

Bashkëdrejtues i projektit të rishtypjes fototipike të Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia (vol I-II, Tiranë-Prishtinë 2002); kryeredaktor i botimit shkencor të ilustruar Kodikët e Shqipërisë (2003); në redaksinë ndërkombëtare të ribotimit të Illyricum Sacrum (vol. I-IX, Zagreb-Prishtinë, 2005); drejtues shkencor i përgatitjes së katalogut Ottoman manuscripts in Albanian Archives (2001) dhe i projektit ndërkombëtar Të shkruash historinë me tolerancë (konferencë dhe vepër shkencore e ilustruar, në tri gjuhë, 2005); përkujdesës i botimeve Këngë popullore të Skraparit (1998); Epikë popullore shqiptare në Maqedoni (2001); përkujdesës e redaktor shkencor i botimit shqip të poemës Shah-Name (1999) dhe i përmbledhjes Tri drama të pabotuara të D. Agollit (2016); redaktor e transkribues i zërave për Shqipërinë në projektin INCOMKA (2003); ekspert shkencor për antroponimet në Census Albania 2011; përgatiti dhe realizoi regjistrimin e dy kodikëve më të vjetër të Shqipërisë Beratinus-1 dhe Beratinus-2 në programin e UNESCO-s Memoire du Monde (2005); hartoi e drejtoi programin ndërqeveritar Modernizimi i arkivave kombëtare (2000-2005); anëtar i komisionit kombëtar të UNESCO-s (2000-), anëtar i komitetit kombëtar të AIESSEE-së (1999-), themelues i komitetit kombëtar të programit Memoire du Monde (2004); merr pjesë në projektin e BE How to Exorcise the Hate (skenarist i katër filmave dokumentarë, 2011); hartues projektesh dhe përgatitës i veprimtarive shkencore (konferenca kombëtare e ndërkombëtare dhe botime akademike) për shpëtimin e hebrenjve në Shqipëri (1990-2017); bashkëdrejtues i projektit shkencor Eposi shqiptar në UNESCO (nderuar me çmimin Europa Nostra, 2016).

Nderime dhe mirënjohje të fituara: urdhri Naim Frashëri, klasi II (1986); çmimi i dytë kombëtar vjetor i revistës Hosteni për novelë (1991); qytetar nderi i Beratit (2008); çmimi dhe kupa Madonna e Argjenditë për film dokumentar-shkencor si skenarist në Festivalin V Ndërkombëtar të Filmit në Bjelorusi (2009); çmimi kombëtar Faik Konica për studim monografik (2012); Mirënjohje e shtetit të Izraelit për studim monografik (2014); çmimi kombëtar Kult për studim monografik (2015); Urdhri i Pavarësisë i Republikës së

---

Kosovës (2016); certifikatë e veteranit-luftëtar të UÇK-së (2016); çmimi vjetor i librit shkencor për studim monografik në konkursin e AIITC (2016); mirënjohjen e Qeverisë së Kosovës si kontribuues për pranimin e Arkivave të Kosovës në Këshillin Ndërkombëtar të Arkivave (2016).

---

**Akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë priti sot Këshilltarin e Ambasadës së Republikës Franceze për çështjet e kulturës dhe edukimit, Pierre Raynaud**

- Takimi: Kërkesë për bashkëpunimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në kuadrin e 100-vjetorit të bashkëpunimit shqiptaro-francez në fushën e arkeologjisë



Akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë priti sot në një takim Këshilltarin e Ambasadës së Republikës Franceze për çështjet e kulturës dhe edukimit, Pierre Raynaud.

Në këtë takim morën pjesë akad. asoc. Gëzim Hoxha, Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike dhe prof. Neritan Ceka, Kryetar i Komisionit të Historisë dhe Arkeologjisë.

Z. Raynaud pasi falënderoi për mikpritjen, shprehu dëshirën për bashkëpunimin me Ambasadën Franceze në fushën e trashëgimisë kulturore.

Z. Raunaud foli për organizimin e javës së kulturës franceze, që do të zhvillohet në maj 2024 nën kujdesin e Kryeministrit z. Edi Rama me bashkëpunimin e ngushtë të Ambasadës Franceze.

Konkretisht ai bëri një ftesë për organizimin e përbashkët të një veprimtarie të posaçme dedikuar prof. Pierre Cabanes, inaugurimin e sallës "Pierre Cabanes" në Bibliotekën Kombëtare, fondi i së cilës do të shtohet me veprat e prof. Cabanes, historianit dhe arkeologut francez, që dha një kontribut të madh në zhvillimin e shkencave

---

albanologjike.

Salla do te marrë emrin e historianit dhe arkeologut të mirënjohur francez, Pierre Cabanes, jo vetëm për kontributet që ka dhënë në arkeologjinë dhe historinë shqiptare, por edhe në shenjë mirënjohjeje të aktit të tij, që pak kohë para se të largohej nga jeta ia dhuroi bibliotekën e tij Shqipërisë.



Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi u shpreh i gatshëm për bashkëpunimin në organizimin e kësaj veprimtarie.

Ai foli dhe mbi takimin që pati me prof. Cabanes, gjatë vizitës që ky i fundit bëri në Shqipëri në kuadër të Kongresit të Studimeve Albanologjike në vitin 2021.

Gjithashtu akad. Gjinushi ritheksoi faktin që prof. Cabanes ka një kontribut të veçantë në zhvillimin e shkencave arkeologjike në Shqipëri e përgatitjen e arkeologëve shqiptarë e për këtë i është akorduar titulli “Nderi i Akademisë së Shkencave”.

Gjatë bisedës u fol edhe për traditën e bashkëpunimit mes Francës dhe Shqipërisë në fushën e arsimit dhe shkencës që nga fillimet e shekullit të kaluar e deri më sot, sidomos nëpërmjet bursave të akorduara nga shteti francez, bashkëpunimit midis institutit të arkeologjisë e shkollave franceze, diplomave të dyfishta që jepen për studentët shqiptarë nëpërmjet bashkëpunimeve midis universiteteve shqiptare e atyre franceze.



## Javë kushtuar gjuhës dhe kulturës shqiptare në qendrën "Europeum" të Regensburg Universitët

- Shqipëria në fokus, nga data 13 deri më 17 maj 2024: jo vetëm gjuha, tradita, historia, por dhe gatimet

Prej vitit 2023, me iniciativën e prof. Björn Hansen, drejtor i departamentit të sllavistikës, për herë të parë në Regensburg Universitët (Gjermani) u hap kursi i gjuhës shqipe ("Lektorat für Albanisch"), fillimisht si kurs pilot.

Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi ka mikpritur në Tiranë prof. Björn Hansen; ka përshëndetur hapjen e njësisë së shqipes dhe bashkërisht është shprehur dëshira për nënshkrimin e një marrëveshjeje dypalëshe, që është në proces përgatitjeje.



Kursi prezantues i shqipes, i zhvilluar në këtë vit, që është shpallur i "Viti i Gjuhës Shqipe"; i vijuar me një varg ligjëratash promovuese për trashëgiminë dhe identitetin shqiptar, si dhe me evente të tjera, duke përfshirë gatimet shqiptare në kampusin e studentëve, është nxitje për konkretizimin e kësaj marrëveshjeje.

Dr. Ledio Hala, lektor i shqipes në Regensburg Universitët, shkruan me entuziazëm se sivjet, "Europeum", qendër që promovon vendet dhe kulturat e Europës, ka vendosur t'ia kushtojë Shqipërisë ... copëza të Shqipërisë do të jenë të pranishme e do të shijohen në çdo

cep të universitetit dhe unë do t'i gëzohem këtij bashkëpunimi me "Europeum". Ky poster nuk është ngjitur vetëm në zyrën time, por në çdo cep të universitetit.



Urimet më të përzemërta dr. Ledio Hala, një nga bashkëpunëtorët më të rinj të ASHSH!

Faleminderit "Europeum center", faleminderit Regensburg Universitët!

## Vizitë e delegacionit të "École Française d'Archéologie d'Athènes" në Akademinë e Shkencave

- Takim në Kryesi për vlerësimin e bashkëpunimit të deritashëm dhe projektet e së ardhmes



Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi priti delegacionin e EFA-s në zyrën e tij. Në vijim bisedimet u zhvilluan me zëvendëskryetarin akad. Vasil S. Tole. Përfaqësia e Shkollës Franceze të Arkeologjisë të Athinës (EFA) kryesohej nga prof. Weronique Chankowki, drejtore. I pranishëm gjithashtu antropologu Gilles de Rapper, njohës i shqipes, studiues i trashëgimisë shqiptare, duke përfshirë veprën e I. Kadaresë.

Midis Akademisë së Shkencave dhe École Française d'Athènes ekziston një traditë bashkëpunimi, sidomos për kërkime arkeologjike të prehistorisë, në site të tilla si Kallàmas e Sovjan. Libri i akteve të kërkimeve dhe studimeve të përbashkëta në Sovjan del së shpejti nga shtypi.

Gjatë bisedimeve në Kryesi u ra dakord për nënshkrimin e një protokollit bashkëpunimi, në zbatim të marrëveshjes ekzistuese, që do të përmbajë botime të përbashkëta në fushat e arkeologjisë, antropologjisë dhe etnomuzikologjisë; kërkime të përbashkëta në site me interes shkencor dypalësh; organizim konferencash dhe veprimtari të tjera kërkimore e shkencore.

Delegacionit iu dhurua botimi dyvëllimësh i ASHSH "Kadare në kritikën botërore".



---

Një takim u zhvillua gjithashtu me drejtorin e Institutit të Arkeologjisë akad. Adem Bunguri dhe kryetarin e komisionit të përhershëm të arkeologjisë prof. Neritan Ceka.

Në takim u diskutua për vazhdimin e bashkëpunimit, në kuadër të marrëveshjes pesëvjeçare (2022-2027) të nënshkruar ndërmjet Institutit të Arkeologjisë dhe EFA-s, në kushtet e reja, pas bashkimit të instituteve të albanologjisë me Akademinë e Shkencave, dhe u konfirmua vullneti i përbashkët për zbatimin e saj.



Dy prioritete mbeten kërkimet e mëtejshme në qendrat prehistorike të Fushës së Korçës dhe krijimi i Muzeut të Prehistorisë, që do të përbëjnë projektin e parë të bashkëpunimit.

Durrësi antik e mesjetar me prapatokën e tij (hinterland), si dhe Via Egnatia, do të jenë një tjetër projekt të përbashkët. Apollonia dhe prapatoka e saj ilire do të vazhdojnë të jenë pjesë e rëndësishme e bashkëpunimit.

---

## "Ndikimi kulturor i latinitetit në Shqipëri" / "La latinità e le sue influenze culturali in Albania"

Ligjëratë e hapur e prof. asoc. dr. Evalda Pacit në Universitetin e Salentos (Lecce, Itali)

- Vlerësohet interesi për bashkëpunim me marrëveshje midis Universitetit të Salentos (Lecce), ku njësia e albanologjisë vjen duke u fuqizuar, dhe Akademisë së Shkencave -



E ftuar nga departamenti i studimeve humanistike dhe departamenti i trashëgimisë kulturore pranë Universitetit të Salentos (Lecce), në kuadër të veprimtarive ndër-institucionale kushtuar ruajtjes së pasurive kulturore dhe monumentale, prof. asoc. dr. Evalda Paci (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë) mbajti ligjëratën me titull "Ndikimi kulturor i latinitetit në Shqipëri" / "La latinità e le sue influenze culturali in Albania".

Ligjëratata u moderua nga prof. Monica Genesin, studiuese albanologe dhe përgjegjëse e njësisë së shqipes në Universitetin e Salentos.

Në këtë paraqitje u trajtuan çështje të gjurmimit të pranisë së elementeve të latinitetit në trevat ballkanike në vështrimet e studiuesve të historisë antike dhe të burimeve autoriale përkatëse, si dhe në tekstet më të hershme të letërsisë klasike, të

interpretuara në disa variante autoriale dhe filologjike, me një vëmendje të përqendruar në traditën e receptimit të autorëve të kësaj letërsie në studimet shqiptare dhe europiane.

Marrëdhëniet e hershme mes popullsive të dy brigjeve të Adriatikut, toposet e interpretuara në studimet ndërdisiplinore të dekadave të para të shekullit të kaluar, por dhe në studimet e kohëve të fundit risjellin në vëmendje autorë të letërsisë latine, veprat kryesore të të cilëve janë sjellë dhe në gjuhën shqipe në variante mjeshtërisht të përpunuara në aspekte të metrikës, të prozodisë, por dhe të leksikut të përzgjedhur e të përsosur nga mjeshtër të fjalës e të përkthimtarisë sonë.



Pasazhe të përveçme nga libri i tretë i “Eneidës” së Virgilit të sjella në gjuhën latine, italiane dhe shqipe u trajtuan dhe në këtë vështrim nga studiuesja Evalda Paci, në ligjëratën e sipërpërmendur.

## Në Stamboll mbahet Takimi II i akademive të vendeve të rajonit të Europës Juglindore ("II Meeting of the South Est Europe Regional Academies")

- I pranishëm akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë -
- Nxitja e bashkëpunimit rajonal - qëllimi i takimit: duam të krijojmë një "udhërrëfyes" për bashkëpunim të suksesshëm -



Takimi i 2-të i Akademive të Rajonit të Europës Juglindore (SEERA) po zhvillohet sot, më 20 prill 2024, në Stamboll, në "Rabi Medrese", pjesë e kompleksit të bibliotekës historike "Suleymaniye".

Takimi u hap me një fjalë mirëseardhjeje nga prof. Muzaffer Şeker, kryetar i TÜBA-s. Në vijim përfaqësues të lartë të akademive pjesëmarrëse paraqesin zhvillimet dhe arritjet në institucionet që drejtojnë dhe bëjnë propozimet për mundësitë e bashkëpunimit dy e shumëpalësh.

Sipas programit marrin fjalën akad. Skënder Gjinushi, kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; prof. Muris Čičić (kryetar, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Bosnje-Hercegovinës); prof. Živko Popov (kryetar, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë së Veriut); akad. Dragan K. Vukčević (kryetar, Akademia e Shkencave dhe

---

Arteve e Malit të Zi); akad. Marius Andruh (nënkryetar, Akademia e Shkencave e Rumanisë); prof. Eden Mamut (Sekretari i përgjithshëm, Rrjeti i Universiteteve të Detit të Zi) dhe përfaqësues të institucioneve të tjera akademike e universitare të pranishëm në takim.

Takimi i parë u organizua në vitin 2022 në Sarajevë, nën kujdesin e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Bosnjes dhe Hercegovinës. Takimi i tanishëm u përgatit nga Akademia e Shkencave e Turqisë (TÜBA), mikpritëse e ngjarjes. Qëllimi kryesor i kësaj veprimtarie është për të nxitur bashkëpunimin mes akademive të rajonit; për të shkëmbyer ndërsjelltas informacionin shkencor; për të kërkuar së bashku zgjidhje dhe programe për përballjen me vështirësitë që ekzistojnë në fushat akademike dhe shkencore.

Synohet krijimi i një “udhërrëfyesi” për bashkëpunim. Fokusi është forcimi i lidhjeve ekzistuese dhe ndërtimin e urave të reja midis akademive në Europën Juglindore dhe rajoneve të tjera pjesëmarrëse.

---

## **Përparësi në bashkëpunimin tonë - fushat që na lidhin për shkak të historisë, territorit e fqinjësisë**

- Fjala e Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi në takimin e dytë të akademive të vendeve të rajonit të Europës Juglindore (SEER II), Stamboll, 20 prill 2024 -

- Prioritetet tona janë ato që u përcaktuan në Samitin e 7-të të akademive të Ballkanit Perëndimor mbajtur vjet në Tiranë, në kuadër të Procesit të Berlinit: nxitja e krijimi i kushteve që edhe në vendet tona financimi për kërkimin shkencor të synojë arritjen e mesatares europiane prej 2 për qind të GDP-së; si dhe ngritja në vendet tona e qendrave elitare të kërkimit -

- Bashkëpunimi ndëruniversitar, duke synuar njësimin e programeve e për rrjedhojë edhe të diplomave universitare, është një nga masat më me efekt për ndaljen e fenomenit të "ikjes së trurit" -

- Prioritet yni është ngritja e një qendre të nanoteknologjisë në nivel rajonal dhe transformimin e njësisë së biogjenetikës në një nyje të rëndësishme bashkëpunimi -



Të nderuar pjesëmarrës,  
Të dashur miq e kolegë, kryetarë e përfaqësues të lartë të akademive të vendeve të rajonit,  
Së pari, shpreh falënderimet dhe përgëzimet tona për Akademinë e Shkencave të

Turqisë dhe kryetarin e saj akad. Muzaffer Şeker për organizimin e mikpritjen e këtij takimi këtu në qytetin e bukur të Stambollit.

Akademia jonë e Shkencave përkrah e mirëpret çdo iniciativë rajonale që ka për qëllim forcimin e ndërveprimit e të bashkëpunimit ndërakademik; si një mjet i rëndësishëm për të nxitur e konkretizuar bashkëpunimin midis vendeve tona jo vetëm në nivel të institucioneve universitare e shkencore, por dhe në fushën e ekonomisë, arsimit e kulturës në tërësi.

Për vetë natyrën e tyre, si institucionet më përfaqësuese të shkencës e arsimit të një vendi dhe të të gjitha disiplinave, akademitë tona i kanë mundësitë të luajnë një rol të veçantë. Sigurisht, sikush nga ne ka specifikat e prioritetet e veta, në bazë të problemeve, traditës e mundësive që ekzistojnë. Prandaj më së pari do të dëshiroja të më lejoni të paraqes shkurtimisht se cili është organizimi i ASHSH, në mbyllje të reformës së saj të kryer, për të treguar më tej prioritetet e saj në bashkëpunimet rajonale.



ASHSH sapo ka përmbyllur reformën ligjore të ndërmarrë katër vjet më parë. Si rezultat i saj, ajo ka sot 54 anëtarë-akademikë nga 43 që kishte; 16 anëtarë nderi dhe për herë të parë bën pranime me statusin e anëtarëve të jashtëm nga radhët e kërkuesve më të suksesshëm shqiptarë që punojnë jashtë vendit, numri i të cilëve rritet në vazhdimësi.

Pranë ASHSH funksionojnë sot 11 komisione të përhershme, me rreth 150 anëtarë, shumica e të cilëve janë profesorë e kërkues nga universitetet e institutet kërkimore në vend; si dhe mbi 10 njësi të kërkim-studimit, të përkohshme ose të përhershme, në nivel

instituti. Kjo ka bërë që Akademia të ketë një bashkëpunim konkret me tërë institucionet kryesore arsimore-shkencore në vend e për rrjedhojë të jetë organizatorja e eventeve shkencore më të rëndësishme dhe nxitësja e ideatorja e projekteve kryesore shkencore.

Sot ASHSH është nismëtare e organizatore e realizimit të tre projekteve madhore në fushën e historisë, gjuhësisë dhe botimeve enciklopedike, me pjesëmarrjen e mbi 300 studiuesve; si dhe e disa projekteve të tjera prioritare, kryesisht në nanoteknologji, bioshkencë, sizmologji, gjenetikë e energji të ripërtëritshme.

Së fundi pranë ASHSH janë atashuar edhe 4 institute tradicionale, të arkeologjisë, historisë, gjuhës e antropologjisë, si dhe një qendër e studimit të arteve, si njësi autonome.

Prioritetet tona, në të cilat do të dëshironim që më së pari të kishim bashkëpunim, janë dy, siç u përcaktuan edhe në samitin e 7-të të akademive të Ballkanit Perëndimor mbajtur vjet në Tiranë, me pjesëmarrje më të gjerë, në kuadër të Procesit të Berlinit: për të nxitur e krijuar kushtet që në vendet tona financimi për kërkimin shkencor të synojë arritjen e mesatares europiane prej 2 për qind të GDP-së; si dhe ngritja në vendet tona e qendrave elitare të kërkimit, në nivel rajonal e europian, në fushat kryesore të shkencës, pasi objektivi i parë nuk mund të arrihet pa rritur më së pari kapacitetet intelektuale e logjistike për kërkimin shkencor. Shpresojmë e urojmë që këto takime pune të shërbejnë si lobime për të mbështetur njëri-tjetrin për të nxitur qeveritë përkatëse për realizimin e këtyre objektivave.



Sigurisht, këto nuk kërkojnë vetëm vullnetin e gatishmërinë e politikës për rritjen



---

e buxhetit, por edhe krijimin e kushteve për thithjen e tyre e bërjen efektive, në dobi të së ardhmes.

Akademia jonë, në këtë aspekt, po punon për një reformim të sistemit të kërkimit shkencor, bazuar në ligjin e ri për shkencën, që është në pritje për t'u miratuar; në strategjinë kombëtare për shkencën për periudhën 2023-2030 dhe në kërkesat e standardet e BE-së për shkencën, në kuadër të negociatave për anëtarësim. Aktualisht ne kemi si prioritet ngritjen e një qendre të nanoteknologjisë në nivel rajonal dhe transformimin e njësisë së biogjenetikës në një institut kërkimor të përhershëm orientuar drejt biomjekësisë. Tek ne prej tre vjetësh organizohet një prej konferencave ndërkombëtare më të rëndësishme në nanoshkencë, për të krijuar e fuqizuar klimën e mbështetjen për këtë iniciativë tonë.

Vlerësojmë se përparësi në bashkëpunimin tonë mbeten fushat që na lidhin për shkak të historisë, territorit e fqinjësisë, si arkeologjia, ujërat, klima e sizmologjia. Vazhdimi i ideimit dhe realizimit të projekteve të përbashkëta në nivel rajonal dhe shkëmbimi i përvojave në këto fusha është domosdoshmëri. Këtu edhe interesi e predispozicioni i institucioneve europiane financuese duhet të jetë më prezent, më pak burokratik e selektiv - por në sensin pozitiv e jo diskriminues.

Një drejtim tjetër i rëndësishëm i bashkëpunimit tonë është nxitja e bashkëpunimit ndëruniversitar, ku politikat e iniciativat për njësimin e programeve e për rrjedhojë edhe të diplomave universitare është një nga masat më me efekt për ndaljen e fenomenit të ikjes së trurit prej vendeve tona. Në këtë drejtim vlen të ndikojmë më shumë ndaj politikbërësve e vetë institucioneve arsimore për të krijuar bindjen se mbajtja e një raporti sa më të balancuar midis nivelit shkencor e atij arsimor, investimeve në shkencë e atyre në arsim, është e vetmja rrugë për të pasur një arsim të lartë të standardeve të kohës.

Ju faleminderit për vëmendjen.

---

## Profile të shkurtra të katër akademikëve të asociuar që fituan sot titullin "akademik"

- Paraqitur sot në mbledhjen e Asamblesë nga akad. Skënder Gjinushi, kryetar i Akademisë së Shkencave; votuar e pranuar nga Asambleja për titullin "akademik"

Adrian Civici



Prej anëtarësimit si akademik i asociuar Adrian Civici ka vazhduar intensivisht veprimtarinë si kërkues shkencor, duke botuar si autor/ bashkautor pesë monografi në fushën e tij dominante, një prej të cilave fituese e çmimit shkencor "Çabej" që jepet nga ASHSH. Botimet e tij përmbajnë analiza shkencore të thelluara për problematika të mprehta të zhvillimit ekonomik; për çështje të rëndësishme financiare e buxhetore; për politikat ekonomike e ato strukturore që duhet të realizojë vendi në kontekstet bashkëkohore, në epokën e krizave spirale; dhe për aspekte të sfidave të teorisë dhe politikave ekonomike.

Gjatë periudhës 2020-2023 ai ka botuar gjashtë artikuj shkencorë, prej të cilëve tre të indeksuar ndërkombëtarisht në Scopus. Ka marrë pjesë në dhjetë konferenca shkencore ndërkombëtare e kombëtare. Është autor/ bashkautor i katër studimeve shkencore, dy

---

prej të cilëve të mundësuar nga fondacioni "Friedrich Ebert".

Veprimtarisë së tij i shtohen shtatë ligjërata të hapura, brenda vendit dhe si profesor i ftuar.

Ka botuar disa dhjetëra artikuj popullarizues e sensibilizues në shtyp e media.

Kristina Jorgaqi



Gjatë katër vjetëve prej pranimit si anëtare e asociuar Kristina Jorgaqi ka botuar katër vepra të plota, nga të cilat dy fjalorë (me botues Akademinë e Shkencave) dhe një monografi në gjuhë të huaj.

Është autore e katër referimeve në konferenca shkencore ndërkombëtare; pjesëmarrëse si drejtuese ose anëtare grupi në pesë projekte shkencore, tre prej të cilëve projekte europiane, me partnerë universitarë në Itali e Gjermani; profesore e ftuar në disa universitete jashtë vendit; anëtare bordi/redaksie shkencore në pesë këshilla/redaksi; me kontribute në programin e doktoratës si drejtuese shkencore (një prej tyre jashtë vendit).

---

## Mimoza Hafizi



Pasi u pranua në Asamble si akademike e asociuar, Mimoza Hafizi ka vazhduar veprimtarinë e saj kërkimore-shkencore brenda vendit dhe në kuadër të programeve ndërkombëtare në fushën e fizikës dhe astrofizikës. Anëtare e grupit ndërkombëtar "Theseus" dhe të "Cost Action"; e propozuar nga Akademia e Shkencave si anëtare e bordit drejtues të ALLEA-s për periudhën 2024-2027. Është autore/ bashkautore e gjashtë artikujve shkencorë të botuar jashtë vendit në revista të indeksuara; pjesëmarrëse me referime në 15 ngjarje shkencore ndërkombëtare dhe brenda vendit; e angazhuar në veprimtarinë institucionale si anëtare e drejtuese jurie dhe në borde shkencore; drejtuese e Institutit Kombëtar të Fizikës, drejtuese e shkollës verore të matematikës, bashkëdrejtuese e programeve dypalëshe shqiptaro-franceze.

## Rajmonda Buhaljoti

Gjatë periudhës prej pranimit si akademike e asociuar, Rajmonda Buhaljoti ka botuar shtatë artikuj shkencorë, pesë prej të cilëve me indeksim ndërkombëtar në platformën "Scopus".

Ka referuar si autore/ bashkautore në 15 konferenca shkencore ndërkombëtare; pjesa më e madhe e të cilave me konkurrim (peer review). Ka marrë pjesë me kumtesa në 10 konferenca kombëtare (me kontribues nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut).

Ka drejtuar pesë projekte të nivelit ndërshtetëror, kombëtar, qeveritar dhe

institucional.



Ka ushtruar një veprimtari cilësore universitare si titullare lënde dhe referuese ligjëratash të veçanta e drejtuese e programeve të doktoratës.

---

## Angjelin Preljocaj, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave

Asambleja e ASHSH voton e miraton pranimin e tij

- Profil i shkurtër paraqitur Asamblesë nga kryetari i ASHSH akad. Skënder Gjinushi



I propozuar për pranimin si anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave nga radhët e personaliteteve të shquara si Gjergj Prevazi dhe nga akad. Ismail Kadare, me një libër kushtuar atij.

Një nga personalitetet më të njohur në Botë në fushën e koreografisë bashkëkohore. Që prej mesit të viteve 1980 dominon skenën franceze, europiane e botërore me mjeshtërinë dhe originalitetin e artit të tij, si balerin e koreograf. Karriera e tij artistike është cilësuar brilante. Është autor i dhjetëra pjesëve koreografike origjinale, që nga ato të miniaturës e deri tek veprat e mëdha koreografike, duke krijuar një shkollë më vete mjeshtërie, e njohur si "Preljocaj Ballet"

Ismail Kadare ka shkruar për Preljocajn: "Alfabeti i tij i gjallë njerëzor ka gjithë mrekullinë, po edhe përkohshmërinë që ka qenia njerëzore; ky alfabet bart gjithë thesarin e tij".

---

## Mira Murati anëtare e jashtme e Akademisë së Shkencave

- Profil i shkurtër, paraqitur në Asamble nga Kryetari i ASHSH akad. SkënderGjinushi



Ermira (Mira) Murati është studiuese e drejtuese ekzekutive në degëzimet më të reja të shkencave të informatikës; përgjegjëse në të mirënjohurën "Open Artificial Intelligence" që nga viti 2018.

Pas një bashkëpunimi të suksesshëm si studiuese prej më shumë se shtatë vjetësh dhe u bë zyrtari kryesor i teknologjisë, duke udhëhequr punën në ChatGPT.

Është supervizore e përparimeve teknike dhe e drejtimit të projekteve shkencore parësore të "Open AI", duke përfshirë zhvillimin e modeleve dhe mjeteve të avancuara të inteligjencës artificiale.

Me emrin e saj lidhen arritje nga më të rëndësishmet në zhvillimin e disa prej produkteve më të shquara të "Open AI", duke përfshirë serinë e modeleve gjuhësore të "Transformerit të Paratrajnuar Gjenerues" (GPT).

Veprimtaria e saj përfshin shtyrjen e kufijve të mësimin të makinerive, ndërkohë që mbron përdorimin e përgjegjshëm e etik të teknologjive të AI. Është vlerësuar nga autoritetet teknologjike për një aftësi të shkëlqyer të demonstruar për të mbledhur me sukses ekipe me ekspertizë teknike, mendjemprehtësi tregtare dhe gëzon një vlerësim të

---

thellë për rëndësinë e misionit, duke ndihmuar në ndërtimin e disa prej teknologjive më emocionuese të AI, të papara ndonjëherë më parë.

Rekomandues janë akad. Anastas Angjeli dhe prof. Dhimitër Tona, që e cilësojnë kandidaten si një nga personalitetet më të njohur sot në fushën e zhvillimeve teknologjike dhe të inteligjencës artificiale.



---

## Gëzim Alpion anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave

- Profil i shkurtër paraqitur në Asamble nga akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i ASHSH



Propozuar për pranimin si anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave nga Kryesia.

Dy anëtarë të Asamblesë, akademikët Arben Merkoçi e Adem Bunguri, njohës të veprimtarisë së tij shkencore e universitare, janë rekomandues për kandidimin; përveç letrës së referencës nga imzot George Frendo, arkiveshkv i mëparshëm i Durrësit dhe Tiranës; si dhe vlerësimit zyrtar me shkrim nga profesor Nicola Gale, drejtor i Shkollës së Politikës dhe Sociologjisë në Universitetin e Birminghamit dhe Stephen Nash, ambasador, kryetar i shoqatës Angli-Shqipëri.

Gëzim Alpion ka mbrojtur doktoratën në filozofi, është profesor në Universitetin e Birminghamit; profesor i ftuar në disa universitete të Botës; autor i shtatë veprave monografike si autor i vetëm dhe i disa të tjerave si bashkautor; i njohur si biografi më i besueshëm për Nënë Terezën, vepër e përkthyer dhe botuar mbi 15 herë; autor i 17 artikujve shkencorë dhe kritikë të pranuar me konkurrim (peer review); shkruar libra artistikë dhe disa dhjetëra artikuj në shtyp e media. Veprat e tij janë të recensionuara në më shumë se 100 raste.

Mban tituj nderi e merite, mirënjohje dhe dekorata nga shteti shqiptar dhe nga vende të tjera.

---

## Lea Ypi anëtare e jashtme e Akademisë së Shkencave

- Profil i shkurtër paraqitur sot në Asamble nga akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i ASHSH -



E njohur dhe e vlerësuar ndërkombëtarisht si studiuese e shkrimtare shqiptare; autore e tetë veprave studimore e letrare të mirënjohura, të botuara anglisht, gjermanisht, frëngjisht, hollandisht, spanjisht, italisht e kinezisht; dy prej tyre të botuara dhe në shqip.

Rekomandues të kandidaturës së saj janë akademikët Floresha Dado e Stefan Çapaliku, të cilët vlerësojnë se kandidatja është një personalitet me sukses të jashtëzakonshëm në shkallë ndërkombëtare, me prestigj të lartë.

Lea Ypi është doktore e shkencave në filozofi, profesore e filozofisë politike dhe titullare lënde në Shkollën e Shkencave Politike dhe Ekonomike të Londrës; profesore në Universitetin Kombëtar të Australisë; profesore e ftuar në dhjetëra universitete në të gjitha kontinentet me mbi 100 ligjërata të hapura; me një veprimtari të vijueshme publicistike në tribuna nga më të rëndësishmet në arealin e anglosferës; mendimtare që këshillohet nga institucione ndërkombëtare, mjedise shkencore dhe media si pikë reference për të shkuarën e afërme dhe të sotmen e çështjeve shqiptare.

---

## Lulzim Tafa anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave

- Profil i shkurtër paraqitur sot Asamblesë nga akad. Gjinushi, kryetar i ASHSH



Tri përbërëse të profilit intelektual të kandidatit Lulzim Tafa veçohen nga dy rekomanduesit, akademikët Xhevahir Spahiu e Shaban Sinani.

Përbërësja akademike: Lulzim Tafa është doktor i shkencave në drejtësi, i specializuar për të drejtën penale, me veprimtari universitare dhe pjesëmarrje qytetare si veprimtar për të drejtat e njeriut. Është profesor universiteti, ligjërues e profesor i ftuar; anëtar i Akademisë Europiane të Shkencës dhe Arteve dhe i Akademisë së Shkencave të Bosnjës.

Kandidati ka një veprimtari botuese të pandërprerë prej më shumë se tri dekadash si poet që cilësohet me të drejtë përfaqësues i brezit letrar shqiptar të pas 1990-ës në Kosovë. Është autor i 10 vëllimeve poetike, të cilët kanë merituar çmime ndërkombëtare të mirënjohura si Neruda e Eminescu, duke përfshirë urdhrin presidencial francez "Ordre des Arts et de literature". Këtij certifikimi i shtohet numri i madh i gjuhëve në të cilat është përkthyer vepra e tij. Numri i gjuhëve në të cilat lexohet poezia e tij është rreth 30.

Përbërësja e tretë shprehet në nismat e tij vetjake për të promovuar vlerat e trashëgimisë së kolegëve të vet, brezave të rinj krijues, jashtë çdo interesi pragmatist. Është themelues e mundësues i pesë çmimeve e mirënjohjeve në letërsi, duke përfshirë çmimin "Ali

---

Podrimja"; është aktivist për vokacion në lëvizje emancipuese, që nga lëvizjet letrare, nismat në favor të studentëve. Është themelues i "The British School of Kosova", i Universitetit AAB (prej 8 vjetësh dhe rektor i tij), i televizionit jopublik ATV dhe gjithashtu i një teatri jopublik shqiptar në Prishtinë.

## Kalendari i konkurseve për çmimet shkencore që jepen nga Akademia e Shkencave për vitet 2024-2025

- Akad. Shaban Sinani, sekretar shkencor i ASHSH, bën të njohur vendimin e Kryesisë, rendin dhe kalendarin e çmimeve



- Fituesit e çmimit "Pilika" do të shpallen në konferencën kombëtare të matematikës në fillim të muajit qershor të këtij viti
- Fituesit e çmimeve "Çabej" dhe "Buda" do të shpallen në vjeshtë të këtij viti -
- Konkursi për çmimin "Radovicka" dhe çmimin e madh të albanologjisë do të zhvillohet në vitin 2025
- Thirrje studiuesve të marrin pjesë në konkurs dhe universiteteve e qendrave kërkimore të nxisin e promovojnë më të zotët

## Nënshkruhet protokollin e bashkëpunimit midis Akademisë së Shkencave dhe dy universiteteve: Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë dhe Universitetit "Luarasi"

- Qëllimi i protokollit: në bibliotekat universitare do të zbatohet sistemi evropian "Cobiss.al", njëherësh edhe program, platformë e bazë të dhënash; zgjidhje nga më cilësoret për katalogimin dhe bibliografitë shkencore, për koordinimin dhe përhapjen e informacionit shkencor; krijimi i bankës së informacionit për rrjetin kombëtar të universiteteve e të kërkuesve (E-cris.al); qarkullimi i lirë i informacionit bibliografik dhe i burimeve të tjera shkencore në rrjete rajonale e europiane

- Qendra për koordinimin dhe përhapjen e informacionit shkencor, njësi shërbimi e formimi profesional pranë ASHSH, e akredituar për garantimin e përditësimit dhe mirëmbajtjen e sistemit

- Për ASHSH marrëveshja u nënshkrua nga akad. Skënder Gjinushi; për universitetet nga rektorët gjegjësisht prof. dr. Adrian Civici dhe prof. dr. Et'hem Ruka. I pranishëm në ceremoni drejtori i Institutit të Shkencave të Informacionit në Maribor (Slloveni) dr. Aleš Bošnjak



## Redaksia e inxhinierive dhe teknologjive në procesin e njësimit të fjalësit të këtyre dy fushave me redaksinë gjegjëse të Kosovës



Takim koordinues në ASHSH

Redaksia e ngritur për fushat inxhinieri-teknologji, e kryesuar nga akad. Jorgo Kaçani, pas këmbimit të listave paraprake të njësive enciklopedike me redaksinë gjegjëse në Kosovë, zhvilloi një mbledhje koordinuese, me pjesëmarrjen e anëtarëve të saj prof. dr. Spiro Drushku, prof. dr. Rozana Troja dhe prof. dr. Flamur Bidaj. Nga redaksia vendore mori pjesë akad. Shaban Sinani. I pranishëm gjithashtu drejtori i QBEA prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi.

Për problemet që janë vërejtur pas këmbimit të listave informoi prof. dr. Spiro Drushku. Numri i fjalëve-referencë për t'u trajtuar si njësi enciklopedike rezulton i zmadhuar kryesisht për shkak të emërtimeve të përveçme (shoqata profesionale, agjenci publike e shërbimi, fabrika, miniera, hotele, ente shtetërore e private). Fjalësi do të fitonte cilësisht duke i adresuar njësitë jashtë disiplinës tek redaksitë përkatëse. Si rregull qendrimi ndaj emërtimeve të përveçme duhet të jetë i njëjtë me atë ndaj personaliteteve, përzgjedhës e përfaqësues. Sidomos kërkohet vëmendje për t'iu ruajtur përveçimeve me karakter reklamativ, qoftë dhe të tërthortë. Për emërtimet e përveçme rekomandimi është të përfshihen tek termi bazë (p.sh., fabrikat e përpunimit të qumështit tek industria

---

ushqimore; hotelet tek termi "turizëm" etj.). Po ashtu u diskutuar për krijimin e një hapësire të domosdoshme për temat e përgjithshëm (afërsisht 15-20 për qind ndaj së tërës).



Përzgjedhja do të jetë çështje për diskutim edhe në mbledhjen informuese dhe instruktive të të gjitha redaksive të fushës ditën e martë, 30 prill 2024, ora 10.00, në sallën "Aleks Buda", me pjesëmarrjen e kryeredaktorit të "Enciklopedisë shqiptare" akad. Skënder Gjinushit.



---

# Botime të reja

## Botohen dy vëllimet e para të veprës së plotë të poetit, dramaturgut, prozatorit dhe fratit françeskan arbëresh Francesco Antonio Santori (Frangjisk Santori)



Njësia kërkimore-studimore për arbëreshët, arvanitët dhe arbëreshët (Nj.K-S.A.A.A), që funksionon pranë Akademisë së Shkencave, e drejtuar nga akademikët Francesco Altimari e Matteo Mandalà është hartuese e projektit për botimin e veprës së plotë të Santorit ("Veprat" / "Opere"), në 10 vëllime.

Redaksia e botimit përbëhet nga Francesco Altimari, Matteo Mandalà e Gëzim Gurga.

Fondazione Universitaria "Francesco Solano", si dhe herë të tjera - krijues i mjedisit kolegial për nisma shkencore e kulturore dhe për projekte ndëruniversitare, që përfshijnë intelektualë me veprimtari kërkimore e krijuese cilësore.

Në dy vëllimet e para, të përgatitura për botim nga bashkëpunëtori i Njesisë Vincezo Belmonte, gjenden veprat fetare dhe veprat teatrale të Santorit. Gjatë vitit 2024 Akademia e Shkencave do të botojë vëllimin e tretë të "Opere", që përmban satirat.

Kolana 10-vëllimëshe hapet me një parathënie nga akad. Skënder Gjinushi,

---

Kryetar i Akademisë së Shkencave.

Projekti për botimin e veprës së plotë të Santorit është vazhdim i punës së nisur tri dekada më parë nga akademikët Altimari e Mandalà dhe bashkëpunëtorët e tyre për botimin filologjik-kritik të gjithë trashëgimisë letrare-kulturore arbëreshe, duke krijuar hap pas hapi fondin gjuhësor të arbërishtes së shkruar e të folur.

---

## **“Kabatë me gërnëtë dhe violinë”, promovohet libri i 36-të i akad. Vasil Toles**

- Promovimi u organizua nga Teatri i Operës dhe Baletit në bashkëpunim me shtëpinë botuese "MEDIAPRINT"



“Kabatë me gërnëtë dhe violinë” është promovuar sot më 5 prill 2024 nga Teatri i Operës dhe Baletit në bashkëpunim me shtëpinë botuese MEDIAPRINT.

Në promovim morën pjesë drejtoresha e Teatrit të Operës dhe Baletit znj. Abigela Voshtina, drejtori i Ansambllit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Sokol Marsi, drejtori i Qendrës Kombëtare Tradicionale Niko Kotherja, anëtarë të kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, personalitete të artit e kulturës, si dhe artistë të njohur e studentë.

Promovimi u organizua, gjithashtu, me pjesëmarrjen e veçantë të mjeshtërve të sazeve Aleks Xhelili, Josif Shukallari, Telando Feto, Aurel Qirjo dhe të Orkestrës së Ansambllit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore.

Veprimtaria u çel nga drejtuesja e shtëpisë botuese “MEDIAPRINT”, znj. Anila Bisha, e cila ia dha fjalën drejtoreshës së Përgjithshme të Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit, znj. Abigela Voshtinës.

Znj. Voshtina falënderoi akad. Vasil Tolen për kontributin që ka dhënë ndër vite në studimin e muzikës tradicionale shqiptare dhe përfshirjen e kësaj muzike në krijimtarinë e tij muzikore dhe theksoi se ky libër do jetë një ndihmesë e madhe për artistët. Libri ka një rëndësi të madhe në promovimin e trashëgimisë sonë muzikore. Më

---

tejt, drejtoresha e TKOB-it premtoi që në kalendarin e koncerteve të këtij institucioni do të përfshijë edhe një koncert, ku do të interpretojnë mjeshtrit e muzikës me saze.



Më pas foli drejtuesja e shtëpisë botuese “MEDIAPRINT”, znj. Anila Bisha.

Ajo tha se ky është libri i 36-të i akademik Vasil S.Toles.

Znj. Bisha kujtoi se kjo gjini muzikore e konsideruar si “koncerti instrumental” i muzikës me saze është bërë e njohur për publikun e gjerë në Shqipëri dhe jashtë saj, që para 100 vjetësh, fillimisht përmes regjistrimeve diskografike e më pas përmes regjistrimeve në shirit, në CD, e sot edhe përmes teknologjive digjitale.



Ajo theksoi se autori i librit “Kabatë me gërnëtë dhe violinë”, akad. Vasil Tole ka

vëzhguar, ka kërkuar përmes shumë e shumë arkivave, burimeve njerëzore, informacioneve nga familjarë apo studiues të këtij zhanri prej 30 vitesh, dhe tashmë ai na ka lënë një pasuri të trashëgimisë shpirtërore të dokumentuar në këtë botim të plotë.

Znj. Bisha, duke e vlerësuar librin për vlerat tradicionale dhe bashkëkohore njëkohësisht, tha se brenda kësaj trashëgimie është e koncentruar e gjithë dija muzikore, sesi mjeshtrit e muzikës me saze shndërrojnë në muzikë urbane trashëgiminë e madhe muzikore shumëzërëshe “a capella” të fshatit shqiptar, një trashëgimi qindrvjeçare, duke përdorur në mënyrë tërësisht krijuese e novative veglat muzikore të temperuara europiane, si klarineta, violina etj.

Ndërsa kujtoi me nderim dhe respekt mjeshtrit e kabaresë, znj. Bisha tha se ky botim mbetet një pasuri edhe për studiuesit apo për të gjithë adhuruesit e kësaj gjinie për të njohur në mënyrë pothuajse shteruese për nga informacioni i plotë dhe evidentimi i të gjithë atyre që kanë kontribuar në këtë gjini.

Niko Kotherja, drejtor i Qendrës Kombëtare Tradicionale vlerësoi punën e akad. Vasil Toles për librin. Ai e quajti kabanë si një ishull të veçantë në traditën muzikore shqiptare dhe e vlerësoi librin edhe për faktin se deri më sot nuk ka pasur një botim të natyrës antologjike, ku të jenë së bashku mjeshtrit më të shquar të kabave me audiot e kabave prej vitit 1920 e deri më sot, me analizat mbi kabanë dhe kabatë, shoqëruar me të dhëna konkrete për ustallarët e kabave, e më gjerë.



Librin e vlerësoi për ndihmën e madhe që iu jepet instrumentistëve dhe shkollave të muzikës edhe drejtori i Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Sokol Marsi.

---

Një i ftuar i veçantë që vinte nga Italia ishte Emanuel Tufa, nipi i mjeshtrit të kabasë Bilbil Vlora.

Ai falënderoi prof. Vasil Tolen për ftesën në këtë veprimtari ku nderohen dhe hidhet akoma më shumë dritë mbi figurën e mjeshtrëve të viteve '20, të cilët shënuan historinë e muzikës folklorike te jugut.

Fale botimeve të prof. Toles, -tha Tufa-, ne kemi mësuar dhe jemi njohur me instrumentistët që kanë kontribute të rëndësishme.

Para se te vija këtu mendova ç'të tregoj në lidhje me stërgjyshin dhe kabanë. Më erdhi në mendje një rrëfim nga një moshatar pothuajse 90-vjeçar para disa vitesh, dhe mendoj se kjo ngjarje tregon më së miri se çfarë është kabaja. -tha Tufa, duke kujtuar një histori mbresëlënëse:

Bilbil Vlora kthehej nga një dasmë në lagjen Karabash. Tek zbriste për në shtëpi gjendet përballë një tragjedie.

Sapo kishin vrrarë një djalë 20- vjeçar. Prindërit dhe të afërmit po e qanin, ulërimat alarmuan lagjen dhe njerëzit mblidheshin.

Bilbil Vlora vendosi t'ia jap ngushëllimet kësaj familjeje në mënyrën e tij. Merr klarinetën dhe fillon të luaj një kaba.

Kabaja e Bilbilit u bë një me dhimbjen e prindërve. Kabaja u kthye në një përqaftim, në një kurajo, një ngushëllim nga mjeshtri Bilbil Vlora.

Në fund të fjalës së tij Emanuel Tufa tha se këngët, vallet apo kabatë e tyre duhet të konsiderohen si operat, nuk duhen prekur, nuk duhet t'i shtojmë apo t'i heqim për t'i zbukuruar, pasi sindroma e kësaj epoke është zbukurimi.

Ato perla janë aq të thjeshta dhe aq të bukura sa që neve na mbetet vetëm t'i interpretojmë duke respektuar krijimtarinë e kolosëve të folklorit tonë.

Në fjalën e tij, akad. Tole vlerësoi mjeshtrit e mëdhenj të kësaj muzike, duke spikatur faktin se ata kanë krijuar identitetin shqiptar në muzikë.

"Kabatë, me gërnetë dhe Violinë" është konceptuar nga autori si një përmbledhje dhe dokumentim i mjeshtrëve më të mëdhenj që kanë lënë gjurmë në këtë gjini muzikore.

Sipas tij libri është multifunksional, pasi shërben edhe si guidë edhe si libër studimor, e në mënyrë të veçantë si dokumentim.

Akad. Tole tha se në libër janë të dokumentuara 30 kabatë më të mira në klarinetë e violinë.

"M'u deshën 35 vite pune për të mbledhur ato që unë i quaj "100 vjet kaba me saze", -thotë akad. Tole, -pasi e vërteta kërkon të thuhet, që deri më sot nuk ka pasur një botim të natyrës antologjike, ku të jenë së bashku mjeshtrit më të shquar të Kabave, me audiot e kabave prej vitit 1920 e deri më sot (QR CODE), me analizat mbi kabanë dhe kabatë, shoqëruar me të dhëna konkrete për ustallarët e kabave, etj.

Kabatë me gërnetë dhe violinë janë kryeveprat e muzikës me saze të Shqipërisë së

Jugut, një trashëgimi muzikore që do të bënte krenar çdo vend që do ta kishte atë.

Prej sot ato janë së bashku në një botim të vetëm, si një dëshmi e artit të madh të popullit, pjesë e muzikës popullore qytetare të Shqipërisë së Jugut dhe e listës së "Dukurive jo materiale" të mbrojtur nga UNESCO!

Kjo vepër, që ka parë së fundmi dritën e botimit, vjen edhe me një risi. Tashmë të gjithë lexuesit përmes një kodi skanimi do të kenë mundësi të njihen me të gjitha krijimtaritë e autorëve në libër, përmes platformës youtube.

Me teknologjinë e krijuar përmes QR code ku me Cd-në e munguar mund të skanosh përmes celularit e lidhesh direkt me kabanë e mjeshtrit, e në këtë mënyrë vë në punë edhe të lexuarin, edhe të dëgjuarin", -tha Tole.

Në fund akad. Tole falënderoi për mbështetjen e botimit fondacionin "Niko Gjika", Klodian Qafokun për masterizimet dhe shtëpinë botuese "MEDIAPRINT" për botimin e librit.

Veprimtaria u harmonizua me interpretime të kabave nga mjeshtrit e sazeve Aleks Xhelili, Josif Shukallari, Telando Feto, Aurel Qirjo dhe Orkestra e Ansambilit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore, të cilat u duartrokitën nga pjesëmarrësit.



Promovimin e mbylli kori i Ansambilit që përshëndeti me këngën "A kanë ujë ato burime".

Libri "Kabatë me gërnetë dhe violinë", përmban shpjegimin e fenomenit të sazeve, formacionit muzikor me vegla të temperuara (klarinetë, violinë, llahutë dhe dajre), që në thelb ka krijuar muzikën popullore qytetare të Shqipërisë së Jugut, nga fundi i shekullit XIX deri në fillimin e shek.XX, në qytete si Leskoviku, Përmeti, Korça, Vlora, Berati, Tepelena, etj.



Akad. Tole vë në dukje se kabaja e luajtur me gërnetë apo me violinë e njohur prej më shumë se 150 vitesh, është llojformimi më i plotë në muzikën popullore me vegla të Shqipërisë së Jugut.



Në libër janë përzgjedhur interpretimet në gërnetë e violinë të mjeshtërve të së shkuarës e të së sotmes, të cilët kanë krijuar me interpretimet e tyre një shkollë kombëtare të kabasë, me plot kuptimin e fjalës.

Pjesë e këtij libri janë mjeshtërit Selim Leskoviku, Biblil Vlora, Riza Berati, Vangjel Leskoviku, Medi Përmeti, Jonuzi i Lamçes, Llaqi me shokët, Gaqo Lena, usta Laveri, Sabri Fehimi, Vangjel Poda, Sabri Çaçi, Tuli i Delvinës, Vasil Mastora, Nexhipi i Fierit, Çerçiz Mehmeti, Lulushi i Korçës, Kristo Jorgo, Sazan Hoxha, Josif Shukallari, Aurel Qirjo, Aleks Xhelili, Telando Feto.

Një vend te posaçëm zënë mjeshtërit e kabave, nga viti 1920 e deri me 2020, te dhëna për ta, për kabatë e tyre, të cilat përmes QR CODE mund të dëgjohen nga youtube për lexuesit e librit.


Janë 16 kaba te mjeshtërive me gërnetë shih:

<https://odeacademy.org/mjeshterit-gernetare> dhe 14 kaba të mjeshtërve me violinë shih <https://odeacademy.org/mjeshterit-violiniste>

---

## **Përrurohet në panairin e tretë të librit akademik dhe shkencor "Shteti i së drejtës në proceset integruese të Shqipërisë"**

- Studime të 25 autorëve, juristë shqiptarë që kontribuojnë në institucione europiane të së drejtës: si e vlerësojnë ata, me një "vështrim së jashtmi", udhëtimin e vështirë të Shqipërisë drejt mirëqeverisjes dhe shtetit të së drejtës -



Të ftuar nga akad. Aurela Anastasi, ata iu përgjigjën thirrjes së saj për t'u kushtuar vëmendje shkencore arritjeve dhe shqetësimeve të vendit të tyre përgjatë dekadave të kalimit në shoqërinë kushtetuese, në shoqërinë e institucioneve, që ideal kryesor ka shtetin e së drejtës. Akad. Aurela Anastasi u përkujdes që artikujt e këtyre autorëve të organizoheshin rreth një ideje bosht dhe krijoi sinergjinë e nevojshme mes tyre.

Libri hapet me një parathënie të përgatitësve të botimit, akad. Aurela Anastasi e akad. Shaban Sinani. Ai është një kontribut i studiuesve shqiptarë të diasporës në fushën juridike për proceset demokratizuese dhe integruese të vendit. Punimet janë përqendruar në çështje parësore të shtetit të së drejtës, si në kuptimin e tij përmbajtësor, ashtu dhe në atë formal. Vëllimi paraqitet si një bashkëbisedim me studiuesit që jetojnë e punojnë brenda vendit, si një shkëmbim idesh për mbarëvajtjen e shtetit të së drejtës me qasje nga integrimi europian i Shqipërisë. Punimet kanë një larmi konceptesh, të cilat u drejtohen

---

studiuesve të së drejtës, lexuesve juristë, studentëve, si dhe të gjithë profesionistëve që shërbejnë në sektorë të ndryshëm, qofshin publikë a privatë. Në të katër krerët e librit problematika e shtetit të së drejtës është zhvilluar në mënyrë prizmatike, i shoqëruar me thirrjen e brendshme të juristit për nevojën e forcimit të tij, në përputhje me arritjet e konstitucionalizmit europian.



Kreu i parë ofron një përballje ndaj sfidave me të cilat ndeshet iniciativa europiane e shtetit të së drejtës në Shqipëri dhe në Ballkanin Perëndimor. Shkrimet e këtij kreu ofrojnë analiza të zbatimit të reformës në drejtësi, që po kryhet në Shqipëri që nga viti 2016. Reforma është marrë në shqyrtim herë si një rast studimor dhe herë si një përvojë nga e cila nxirren mësim për mirëqeverisjen e gjyqësorit. Punimet theksojnë qartë se mbrojtja e shtetit të së drejtës në Shqipëri është një detyrë e rëndësishme veçanërisht e gjykatave dhe gjyqtarëve. Ka autorë që nënvizojnë idenë se gjyqtarët shqiptarë nuk janë vetëm gjyqtarë të vendit të tyre, por edhe gjyqtarë garantues të rendit juridik të Bashkimit Europian. Në tërësinë e saj, e gjithë analiza që parashtrahet në këtë kapitull ka karakter përmasës me kuptimin e shtetit të së drejtës sipas standardeve ndërkombëtare, në veçanti të atyre europiane. Ajo u shërben organeve që zbatojnë reformën në drejtësi për të përmirësuar veprimtarinë e tyre. Gjithashtu, ka mjaft argumente që mund t'i shërbejnë legjislatorit, në kuadrin e nismave të reja legjislative për përmirësimin e zbatimit të

---

reformës. Krahas mësimëve për organet e vetting-ut, dalin në pah konkluzione e mësimë të dobishme edhe për aspekte të tjera që forcojnë sistemin e drejtësisë dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

Kreu i dytë është kryesisht një analizë krahasimtare me të drejtën ndërkombëtare universale e rajonale, si dhe me jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare. Ka një sërë trajtimesh mbi normën demokratike në periudhën e integritit, mbi rolin e së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (në mënyrë të veçantë për mbrojtjen e shtresave në nevojë dhe të personave me aftësi të kufizuara), për mbrojtjen e viktimave të veprës penale, si dhe për mënjanimin e simboleve antikushtetuese. Një analizë e hollësishme përfaqëse është kryer mbi rolin e së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në sistemin dhe praktikën ligjore shqiptare. Fusha e veprimit të normës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është zgjeruar vazhdimisht dhe po ashtu janë zgjeruar edhe burimet e së drejtës ndërkombëtare. Punimet kanë një qasje kritike ndaj realiteteve dhe gjejnë se praktika gjyqësore në këto aspekte në Shqipëri është ende e kufizuar. Falë reformës në drejtësi, Shqipëria ka zgjeruar për herë të parë të drejtat e pjesëmarrjes së viktimave në procesin penal. Për zbatimin e legjislacionit të ri paraqiten disa sfida. Megjithatë, të drejtat e pjesëmarrjes kanë ardhur duke u forcuar, në sajë të praktikës gjyqësore në gjykatat penale ndërkombëtare. Mbetet i rëndësishëm rekomandimi për gjyqësorin, për të kryer analizë ligjore mbi bazën e akteve ndërkombëtare të organizmave ku Shqipëria është palë, akteve zakonore ndërkombëtare, si dhe jurisprudencës së gjykatave ndërkombëtare. Gjithashtu rekomandohet përmirësimi i legjislacionit shqiptar në lidhje me simbolet antikushtetuese, duke u bazuar në parimet e vendosura nga GJEDNJ-ja. Për ta bërë këtë, në vijim të iniciativave ligjore të kësaj natyre, do të duhet të konsiderohen, po aq me seriozitet, politika edukative të shoqërisë, qoftë në programet mësimore, por dhe ato kërkimore shkencore.

Analiza për rrugëtimin kushtetues që zhvillohet në kreun e tretë të punimit na bën të reflektojmë për kontributet e rëndësishme të kontrollit kushtetues. Zhvillimi i së drejtës kushtetuese dhe konstitucionalizmit në Shqipëri është parë i lidhur ngushtë me zhvillimin e shtetit të së drejtës. Prandaj trajtimi kronologjik i zhvillimeve të Gjykatës Kushtetuese në Shqipëri në këtë punim kryhet në qasje me respektimin e shtetit të së drejtës. Autorët dëshmojnë këtu se konstitucionalizmi modern shqiptar ndeshet me vështirësi të karakterit politik, si dhe me kriza kushtetuese. Kjo si rezultat i disa faktorëve veprues në kahjen negative, nga të cilët përmenden ndryshimet e shpeshta kushtetuese si pasojë e konflikteve politike, nevoja për konstitucionalizimin e politikës etj. Theksohet qartë se këta faktorë kanë ndikuar edhe për zgjatjen e periudhës së tranzicionit. Përshtatja e konstitucionalizmit shqiptar me trendet moderne të konstitucionalizmit evropian duhet t'i japë fund tranzicionit demokratik në Shqipëri, të sigurojë një shtet me demokraci kushtetuese të qëndrueshme dhe një shtet të krahasueshëm me cilindo shtet tjetër brenda


---

Bashkimit European. Analizat e këtij kreu nxjerrin në pah edhe zhvillimin e konstitucionalizmit në Shqipëri përpara Luftës së Dytë Botërore, periudha që më parë ose nuk ishin studiuar, ose ishte ndaluar të studioheshin.

Në kreun e katërt, autorët, duke analizuar sfidat që u shfaqën për shtetin e së drejtës gjatë pandemisë që shpërtheu në vitin 2019, kanë çuar në mësim për mbrojtjen e tij në periudhat e emergjencave. Punimet e këtij kreu bëjnë të qartë se pandemia gjeti një dobësi të dukshme në respektimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri, i cili u rrezikua edhe më shumë për shkak të vështirësive shëndetësore dhe ekonomike që u krijuan. Kështu, sipas autorëve, rezultoi rreziku që në Shqipëri gjendjet e fatkeqësive natyrore të shndërrohen në fatkeqësi të mirëfilltë të shtetit të së drejtës e kësisoj edhe të vetë demokracisë: një pandemi e vërtetë kushtetuese, çka nga ana tjetër mund të ndikojë negativisht edhe në procesin e anëtarësimit në BE, duke ngadalësuar konsolidimin demokratik në Shqipëri. Punimet evidentojnë rolin e rëndësishëm që luan kontrolli kushtetues, sidomos pas konstatimit se ai parlamentar mbetet i dobët në një formë qeverisjeje si ajo e Shqipërisë. Krahas forcimit të kontrollit kushtetues, punimet e këtij kreu i mëshojnë edhe forcimit të institucioneve kërkimore e shkencore përgjatë emergjencave.

---

Pas "Doktrinës së krishtenë" Akademia e Shkencave boton librin e dytë të  
Pjetër Budit, "Pasqyra e t'Rrëfyemit"



Riprodhim anastatik i botimit kritik të realizuar në vitin 1986 nga Gunnar Svane, albanolog danez, anëtar nderi i Akademisë së Shkencave;

Përgatiti botimin, me shenjim hyrës dhe shpjegime gjuhësore-filologjike, si dhe me fac-simile nga origjinali nga prof. Bardhyl Demiraj, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave;

Këshillimi shkencor nga akad. Shaban Demiraj.

Recensuese e botimit prof. asoc. dr. Evalda Paci. Pjesë nga recensionin në vijim.

Vitin e ardhshëm Akademia e Shkencave, me "Ritualin roman", përmbyll botimin

---

e veprës së plotë të Pjetër Budit, një prej klasikëve të letërsisë shqipe.

Evalda Paci, "Pasëqyra e t' Rrëfyemit (1621)

Me punimin e përgatitur së fundmi, që vjen sërish si kontribut i vyer kujdesues e saktësues i kolegut Bardhyl Demiraj, studimeve albanologjike u shtohet një tjetër vëllim i çmuar, i domosdoshëm për të plotësuar serinë e veprave të përpiluara shekuj më parë nga Pjetër Budi (1566-1622), një prej autorëve më të rëndësishëm të letërsisë së vjetër shqipe.

Në kohët tona, kur njohja e kësaj letërsie mbështetet gjerësisht në pikëpamje metodologjike nga botime kritike e filologjike që përfaqësojnë dhe shkolla të arrira për nga pikëpamja e realizimit dhe e përafrimit me tekstin, çdo botim i kësaj natyre jo vetëm është i mirëpritur, por rizgjon kureshtjen për një thellim të dijes mbi kësomblla të realizuara përgjatë shekullit XVII, që shënuan e profilizuan ndjeshëm dhe traditën e shkrimit të shqipes të përfaqësuar me autorë të arealit verior. Veprat e letërsisë kishtare në gjuhën shqipe e që janë përpiluar në vitet 1618-1621 falë ndërmarrjeve të Pjetër Budit janë dhe reflektim modelesh të përveçme librare që kanë të bëjnë me pjesë të veçanta të praktikës së liturgjisë e të edukimit doktrinar, fort të ndërmendura dhe në proces të reformimit kishtar që pason mbajtjen e Koncilit të Trentit (1545-1563).

Në vitet e fundit, vëmendja ndaj këtij autori dhe veprimtarisë së tij është konkretizuar me studime që reflektojnë gjurmime të kryera në terren mbi rrethana të paqartësuar të vdekjes së tij, por dhe mbi bazë dokumentimesh shkrimore rreth rrugëtimit jetësor të tij në vitet e fundit të jetës, por dhe me gjetje fashikujsh që dëshmojnë përpjekjet e tij për të plotësuar në kufijtë e mundësive përpilimet e tij në gjuhën tonë.

Përballja e këtij autori me hierarkinë e kohës ka qenë në vijimësi objekt i vëmendjes së studiuesve të vetë kontekstit historik të shekujve XVI-XVII, ashtu si dhe përpjekjet e tij për të qenë koherent me veprat e tij me kanonet editoriale dhe kishtare në fuqi. Përpilimet e Pjetër Budit kanë qenë që në krye të herës pjesë e një historiku botimesh që më së pari pasurojnë panoramën e ekzemplarëve të realizuar përgjatë shek. XVII, një shekull i shënuar nga zhvillime të rëndësishme në disa pikëpamje. Referimi i tij ndaj emrash të njohur në historinë e reformimit të vazhdueshëm kishtar përforcohet pikërisht me sprovat për të shqipëruar Doktrinën e krishterë dhe më pas, "Pasqyrën e të Rrëfyemit", të dyja vepra të orientuara në brendi dhe në elemente të përmbajtjes nga prelatë të kishës së Romës, me përkatësi ndaj urdhrit jezuit.

"Speculum Confessionis", botuar në vitin 1621, pason botimin e vitit 1618 të "Doktrinës së kërshenë" të Pjetër Budit, një botim i dalë nga një tipografi me emër në Romë (Tipografia Zanetti), e përfshirë në veprimtari editoriale të rëndësishme dhe me njohje të gjerë në qerthuj kulturorë të kohës. Emri i kësaj tipografie dhe i tipografëve që pasuan mbajtjen e veprimtarisë përkatëse mbetet i lidhur dhe me botimet e librave kishtarë ndër të cilët do të gjinden të cilësuar në veçanti dhe vetë përpilimet e Pjetër Budit.

---

Në studimet e kryera në lidhje me botuesit e kohës, proceset editoriale në të cilat ishin të përfshirë, regjistrat që reflektojnë hapat e kryer në përfundimin e veprave për t'u botuar, do të mund të vilen të dhëna mbi praninë e Budit në këtë kontekst kulturor, bashkë me hollësi të natyrës financiare, siç dhe operohej në atë kohë nga çdo autor a përpilues.

Siç u tha dhe më sipër, "Speculum confessionis" mbetet një model libror që gjen shprehje konkrete në dekadat që pasojnë Koncilin e Trentit dhe që për nga natyra u afrohet modeleve më të hershme, dhe pse mund të paraqiten me tituj të përafërt në kësombllat përkatëse. Përafrimi i Budit me një model të tillë mund të gjurmohet hap pas hapi, si në pikëpamje të ndjekjes së një ecurie përmbajtësore që gjindet e evidentuar dhe në këtë botim, ashtu dhe në atë të diferencimeve që studiuesit e veprës mund të vënë në dukje në proces të përqasjeve mes teksteve të dy përpiluesve. Gunnar Svane është orientuar shumë vite më parë në këtë drejtim, duke lënë gjurmë konkrete me botime tematike në revistat shkencore në fushë të albanologjisë, ndër të cilat përmendim në veçanti revistat "Studime filologjike" dhe "Studia albanica".

Një fakt i tillë, përveç shpjegimeve të domosdoshme që gjinden që në krye të Hyrjes që introdukton veprën, shtjellohet në gjithë përmbajtjen e kësaj të fundit. E gjejmë me vend të nënvizojmë dhe në rasë të konsultimit të këtij varianti botimi që vjen falë përgatitjes së kujdesshme të studiuesit Bardhyl Demiraj, që të tilla krahasime risjellin në vëmendje çështjen e njohjes së modeleve që njihnin dhe përdornin autorët e letërsisë së vjetër shqipe, të cilët me veprat dhe përpilimet e tyre reflektojnë aspekte të një shkrimtarie individuale, por të mbrujtur me tipare të një formimi kompleks për kohën, pjesë e të cilit ishin dhe tekstet që ata vetë përpiqen të sjellin të shqipëruara, të përshtatura apo të ripërpiluara. Aspektet e individualitetit në shkrimtari është e mundur që në lidhje me vetë Budin të gjurmohen dhe në rasë të veprës "Pasëqyra e të rrëfyemit", dhe një qasje e tillë ndaj artit të të shkruarit të këtij autori do të gjindet e pasqyruar dhe në këtë botim që sërish do të shohë dritën e shtypit nën stemën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

"Speculum confessionis", që vjen përmes këtij botimi introduktohet me anë shënimesh të domosdoshme, që përbëjnë shpjegime mbi formatin e veprës, por dhe referimet e duhura që vënë përballë përpilimin e Budit me tekstin e Emerio de Bonis. Janë të tilla vërejtje një përafrim i nevojshëm dhe për të kuptuar variantin e përpiluar prej Pjetër Budit, i cili në periudhën 1618-1621 do të realizojë disa shqipërime apo përshtatje në fushën e liturgjisë së krishterë, duke i konkretizuar në formate doracakësh, mjaft të përdorur në atë kohë. Të tilla sprova që mbeten mes përpilimit, shqipërimit dhe përshtatjes janë në të vërtetë ndër më të vështirat ndërmarrje për një autor që po thellon kesisoj një rrugë të hapur me vështirësi nga prelatë paraardhës, ndër të cilët më i përmenduri mbetet autori i Mesharit të vitit 1555. Por dhe ky botim ka ofruar mundësinë që për Budin si autor të qëmtohen hollësi qenësore: përputhje, shprehje të tijat, përpjekje për të dhënë në gjuhën shqipe përdorime të një fushe të caktuar terminologjike. Një prirje



---

e tillë në shkrimtarinë e tij dhe në përpilimet me të njëjtën prirje tematike do të mund të gjindet e evidentuar dhe në gjurmimet paraardhëse të G.Svanes, pikërisht në ato mbi Doktrinën e kërshenë të përpiluar në një variant përshtatjeje dhe shqipërimi nga vetë Budi.

Të tjera hollësi me interes mund të dalin në pah përmes shqyrtimesh të tjera që përforcojnë dhe një vështrim plotësues mbi personalitetin autorial të Pjetër Budit, që në kuadër të një veprimtarie baritore që vërtetohet përmes dokumentacionit të kohës në të cilën jetoi, u përfshi dhe në një tjetër drejtim, në atë të përpilimit të doracakëve më tipikë për praktikën liturgjike të asaj periudhe.

Dobinë e një botimi të tillë, që sjell përkrah dy variante tekstore, e përforcon pikërisht çka thuhet në përmbyllje të Hyrjes së sipërcituar: fakti që një vepër e tillë është e rrallë për nga përmbajtja, por dhe në pikëpamje kësombllash, në Bibliotekën e Vatikanit ruhen rreth katër të tilla, një prej të cilave me prejardhje nga Biblioteka Mazarine e Parisit, mjaft e përmendur për ekzemplarët e çmuar që kanë shënuar dhe historinë e gjatë të saj.

Si pjesë e një projekti që konkretizimin më të parë e pati nëpërmjet botimit të veprës së parë të Pjetër Budit (Pjetër Budi/Vepra I: "Dottrina Christiana"/ "Doktrina e krishterë" (1618)), realizuar në vitin 2022 me mbështetjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, dhe ky botim, që risjell në vëmendje çështjet themelore të studimit të gjuhës, literalitetit dhe origjinalitetit në të shkruar të këtij autori të letërsisë së vjetër shqipe, meriton përgëzimet më të mira nga ana e recensentëve shkencorë të tij. Të tilla botime le të jenë shtysë për thellimin e njohjes së aspekteve të sipërcituara, por dhe të nevojës për të ndërthurur më tej prirjet ndërdisiplinore të studimit të traditave shkrimore e letrare të përveçme në gjuhën tonë.

---

"Qendrat e banuara të Shqipërisë: gjendja dhe e ardhmja", botim i Akademisë së Shkencave, 2024



Përgatiti botimin prof. dr. Perikli Qiriazhi.

Përveç përshëndetjeve, në libër gjenden 38 artikuj/kumtime të 58 autorëve: gjeografë, urbanistë, historianë, arkitektë, arkeologë, gjuhëtarë, specialistë të inxhinierive agrare etj.

Përmban aktet e konferencës me të njëjtin titull, organizuar nga Akademia e Shkencave në dhjetor të vitit 2021, në bashkëpunim me Universitetin e Elbasanit

---

"Aleksandër Xhuvani", Universitetin e Gjirokastrës "Eqrem Çabej" dhe Universitetin e Durrësit "Aleksandër Moisiu"; me pjesëmarrjen e studiuesve nga gjithë rrjeti universitar i vendit.

Libri përmban katër kapituj, ndarë sipas problematikës së katër seksioneve të konferencës:

1. Gjendja dhe prirjet e përgjithshme të zhvillimit të vendbanimeve në Shqipëri;
2. Aspekte historike, urbanizimi dhe funksionimi i vendbanimeve;
3. Zhvillimi dhe tipologjia e vendbanimeve në disa rajone të Shqipërisë;
4. Funksionet, zhvillimet dhe tipologjia e vendbanimeve në njësi administrative të Shqipërisë.

Autorët parashtrojnë një problematikë me interes të dyfishtë: shkencor dhe zbatues.


Konferenca dhe botimi janë pjesë e projektit "Studimi i qendrave të banuara të Shqipërisë", drejtuar nga prof. dr. Perikli Qiriazhi, mundësuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Sivjet Akademia e Shkencave do të organizojë një konferencë të dytë me të njëjtën temë, në bashkëpunim me Universitetin e Korçës "Fan S. Noli" dhe me bashkëpunimin e studiuesve nga disa universitete të tjera.

Komitetin shkencor-organizues e kryeson prof. dr. Perikli Qiriazhi.

---

**"Luan Starova, akademiku, shkrimtari i shumëgjuhësisë", botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë 2024**



Akte të konferencës shkencore kushtuar 80-vjetorit të lindjes së shkrimtarit dhe studiuesit Luan Starova, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, shtator 2021

- Fjalë hyrëse nga akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave; si dhe një fjalë përshëndetëse nga akademiku dhe shkrimtari Luan Starova -
- Përgatitën botimin: Brunilda Prifti, Shaban Sinani -
- Përmban 10 referime nga njohës të veprës së Luan Starovës, dukuri bashkëkohore e traditës së letërsisë së autopërkthyer që prej fillimeve deri në shek. XX; romancierit që shkroi e botoi paralelisht në tri gjuhë (shqip, frëngjisht dhe maqedonisht);

---

autorit që sot ka pushtuar letërsinë e popujve të Ballkanit. Ndër referuesit: Ali Aliu, Matteo Mandalà, Shaban Sinani, Fatmir Sulejmani, Arian Leka, Vasil S. Tole; Virion Graçe, Eldon Gjika dhe Eris Rusi.

- Libri përmban edhe tri shtojca për receptimin kritik të veprës së Starovës në gjuhën frënge dhe në disa gjuhë të Ballkanit -

- Nga fjala e hapjes e akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë -

Këtë konferencë ia kemi kushtuar jubileut të 80-vjetorit të lindjes së studiuesit, akademikut, shkrimtarit, përkthyesit e autopërkthyesit, diplomatit Luan Starova, në shenjë nderimi për gjithë sa ai i ka dhënë gjuhës amtare, letërsisë kombëtare, mendimit shqiptar, emrit të vendit të tij të lindjes e të gjithë rajonit ballkanas.

Luan Starova që në krye të herës zgjodhi të bëjë emër si krijues ndoshta në kryeqytetin më të ndërlikuar për këtë, në Paris, ku ai nisi karrierën shkencore me mbrojtjen e doctorates, sfidë të cilën ai e fitoi dhe 50 vjet më pas kjo kryeqendër e kulturës botërore e vlerësoi me çmimin më të lartë të Francës në letërsi, Margaret Yourcenar.

Gjatë gjithë kësaj periudhe shumë akademi të shkencave dhe universitete të ndryshme kërkojnë ta bëjnë të vetin: Akademia Franceze, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Maqedonisë së Veriut, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës dhe Akademia jonë, e cila ndihet e nderuar që e ka prej vitesh në trupën e saj si anëtar të jashtëm.

Studuesit frëng Jean-Arnault Dérens nuk i shpëtoi nga vëmendja fakti që Luan Starova që i pari shqiptar që u bë anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve në Maqedoninë e Veriut, dhe e përshëndeti këtë ngjarje me një artikull në "Le Monde diplomatique", duke e çmuar edhe si shenjë emancipimi të mendësive bashkëkohore në rajonin e Ballkanit.

Në historinë e letrave kombëtare shqiptare, por edhe në ato botërore, shumë rrallë ka ndodhur që studiuesi dhe krijuesi të bashkëjetojnë tek i njëjti, siç mund të përmendim Mjedën, Camajn dhe Besim Bokshin. Luan Starova është një prej atyre rasteve fatlume që suksesi i shkrimtarit dhe ai i studiuesit ia kanë shtuar ndriçimin njëri-tjetrit.

Një tjetër traditë letrare jona, edhe kjo shumë e rrallë, rishfaqet në trashëgiminë krijuese të Luan Starovës. Ai është shkrimtari më i vetëpërkthyer në historinë e letërsisë shqipe, shkrimtari i një letërsie trigjuhëshe, shqip, frëngjisht e maqedonisht, çka e rendit emrin e Starovës ndër të paktët shkrimtarë shqiptarë të vetëpërkthyer, si De Rada e Fan Noli. Çka është më e rëndësishmja, Luan Starova shkruan me të njëjtën shije e cilësi në të tria këto gjuhë, aq sa i ka vënë në vështirësi studiuesit, të cilët u përpoqën të përcaktojnë se cila ndër këto gjuhë është e para.

Akademizmi shqiptar i detyrohet shumë dhuntisë krijuese të Luan Starovës po aq sa edhe cilësive të shkëlqyera njerëzore të karakterit të tij. Ne të gjithë e dimë se si i ka

---

modifikuar sjelljet njerëzore të shumë krijuesve jo vetëm shumëgjuhësia e veprës së tyre, por edhe shfaqja e një interesi sado modest ndaj tyre përtej kufirit të gjuhës amtare. Kurse Luan Starova se ka hapur gojën në të përditshme e nëpër ekrane për të treguar sukseset e tij.

Ne që u takojmë dijeve të quajtura shkencë të sakta dëshirojmë të flitet edhe me gjuhën e numrave. Po ti referohemi njëres prej agjencive më të mëdha kataloguese botërore, "Worldcat Identities", ndërmjet viteve 1970-2020 Luan Starova ka 151 tituj veprash letrare dhe studimore të botuara në 299 publikime si autor, përkthyes, përshtatës dhe introduktues.

Librat e tij janë në shërbim të lexuesit në 3452 biblioteka publike dhe universitare në botë. Gjuhët në të cilat lexohet shenjohe 10, duke përfshirë serbokroatishten, sllovenishten, bullgarishten, rumanishten, turqishten, italishten. Dihet mirë se dëshmia më e rëndësishme e suksesit letrar është ribotimi. Faktet na vijnë në ndihmë të pohojmë se Luan Starova e ka provuar shijen e këtij sukcesi. Vepra e tij "Koha e dhive" ka njohur 25 botime, "Librat e babait" 15 botime, "Vëzhgime dhe studime mbi letërsinë ballkanike" 9 botime dhe një prej romaneve më të fundme të tij, "Polifonistët", ka tashmë 4 botime.

Po aq i rëndësishëm e domethënës është fakti se diagrama e pranisë së veprës së Luan Starovës në duart e lexuesit shenjon shkallën më të lartë në periudhën 2015-2021, çka do të thotë se këtë 80-vjetor ai e priti në kulmin e suksesit dhe të popullaritetit.

Luan Starova është autor i një romani me titullin domethënës "Ballkan Babel", një roman për Ballkanin që vuan mallkimin e mosmarrëveshjes si në mitin e kullës së Babelit. Por ai vetë është bërë prova më sfidante se, kur shkrintari shkruan në gjuhën e tjetrit njësoj si në gjuhën e vet, dhe jo vetëm në një gjuhë të madhe promovimi botëror si frëngjishtja, ky mit shembet vetvetiu. Jo rastësisht vepra e parë e tij mban titullin po aq domethënës "Njerëz dhe ura".

Akademia e Shkencave ka hedhur sivjet një hap simbolik, duke botuar jashtë praktikës së deritanishme romanin "Bregu i mërgimit", që do të paraqitet për herë të parë sot. E morëm këtë vendim jo vetëm për të njohur borxhet tona ndaj një figure si Luan Starova, por edhe si një adresim ndaj publikut e më së pari ndaj profesoratit të universiteteve, për të zbutur vonesat në studimin e kontributeve të shumta të tij. Letërsia dhe studimet e Luan Starovës duhet të përfshihen sa më parë në programet universitare.


Çdo letërsi e popujve të Ballkanit dhe të Europës do ta kishte quajtur veten me fat ta trajtonte këtë trashëgimi të tij si të vetën. Pasuritë shpirtërore nuk janë si ato materiale, që ndarja i zvogëlon. Pasuritë shpirtërore sa më shumë të ndahen me të tjerë aq më tepër shumëfishohen. Letërsia e Luan Starovës duhet të bëhet pjesë qenësore e shkollave doktorale, si një prej rrugëve më efikase për të realizuar studime të thelluara jo vetëm për vendin e saj në historinë e re të letërsisë shqipe, por edhe për pozicionin që i takon në letërsinë ballkanike dhe europiane.

---

I dashur Luan, i nderuar akademik Starova, ju jeni një model i rrallë i harmonizimit të fuqisë krijuese me dinjitetin njerëzor. Jeni një model që nxit dhe tremb njëherësh: nxit me besimin në mundësinë e suksesit dhe tremb me peshën cilësore të veprës Suaj. Brezit të ri të studiuesve kjo u bën mirë me të dyja anët. Prandaj në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave unë ju uroj edhe njëqind vjet, shëndet e krijimtari të mbarë dhe me të njëjtën diagramë sukseasi e ekspansioni në letërsinë e popujve si në këto dekada.

---

**“Mbi zhvillimin dhe mirëqenien”, përgatitur për botim dhe redaktimi shkencor nga akad. Kosta Barjaba; bot. i Akademisë së Shkencave (Tiranë 2024); opus i studiuesve më të njohur për shoqërinë e mirëqenies; një pentalogji për dy çështje thelbësore për shoqërinë e zhvilluar; shkruar përgjatë një dekade**



- Pesë libra në një, botuar radhazi gjatë viteve 2014-2021, dhe tani së bashku -

Libri i parë:

“Rithemelimi i mirëqenies; zhvillimi - sfidant i varfërisë”.

Botim i përbashkët i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Universitetit



---

European të Tiranës; përshkohet nga teza themelore se ulja e varfërisë dhe rritja e mirëqenies mund të vijnë vetëm nga politika inteligjente për përshpejtimin e ritmeve të zhvillimit; politikat zhvillimore duhet të mbizotërojnë ndaj politikave e programeve rishpërndarëse. Nisur nga hipoteza se rritja ekonomike gjatë tranzicionit nuk kishte prodhuar punësim dhe po anonte drejt një prirjeje relative varfëruese, propozimet e autorëve për luftën kundër varfërisë konvergojnë në sinergjinë midis zhvillimit, punësimit dhe varfërisë.

Libri i dytë:

“Asimetritë e zhvillimit si shkak i varfërisë”.

Edhe ky botim i përbashkët i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Universitetit European të Tiranës. Libri vendos në fokus asimetritë e zhvillimit të Shqipërisë gjatë tranzicionit. Adresimi i kësaj çështjeje lindi nga një premisë reale: asimetritë e zhvillimit të Shqipërisë vlerësoheshin kaq të thella, sa sektorë të caktuar të zhvillimit pengonin, frenonin ose ngadalësonin reciprokisht njëri-tjetrin. Asimetria më e dukshme, por edhe me pasojat më të dëmshme për qytetarët, u identifikua ajo midis modelit të zhvillimit ekonomik dhe sistemit të mirëqenies sociale, “produkt” i së cilës rezultonte cilësia e ulët e mirëqenies dhe niveli problematik i varfërisë. Prandaj kontributet e përfshira në këtë libër u kushtohen propozimeve për “riparimin” e këtij defekti të sistemit shqiptar të mirëqenies.

Libri i tretë:

“Rimodelimi i zhvillimit në kontekstet lokale”.

Botim i Akademisë së Shkencave. Libri niset nga premisa se suksesi i modelit ekonomik të një vendi nuk varet vetëm nga formulat dhe standardet universale, por edhe nga burimet. Jo vetëm nga burimet natyrore, por edhe nga ato njerëzore. Sado i arrirë të jetë një model, sado vizionare të jetë një strategji, sado mobilizues të jetë një program apo një matricë veprimesh, ato nuk mund të kenë sukses, nëse njerëzit që i zbatojnë nuk janë të përgatitur. Këtu me njerëz nuk nënkuptohen aktorë të mëdhenj politikë, politikëbërës apo qeverisës, por individët e thjeshtë: edhe ata që ndërtojnë një sipërmarrje të vogël; edhe ata që sot janë të punësuar dhe nesër jo; edhe ata që janë administratorë publikë; edhe ata që merren me punët e tyre. Çfarë bëjnë qytetarët e thjeshtë me pagat, pronën, tokën, kursimet, borxhet, konsumin, ushqimet, paratë e fëmijëve emigrantë apo burimet dhe mjetet e tjera që kanë në dorë? Përfundimi është se sjellja individuale ekonomike e shqiptarëve nuk u është përgjigjur gjithmonë standardeve, kërkesave e nevojave të ekonomisë së tregut. Dhe për këtë autorët sugjerojnë disa zgjidhje, të mbështetura në analizat e tre mendimtarëve të mëdhenj: M. Weber, S. Huntington dhe F. Fukuyama, mbi rolin e vlerave shoqërore në zhvillimin ekonomik.

---

Libri i katërt:

“Përkthimi” i rritjes ekonomike në mirëqenie”.


Botuar nga Akademia e Shkencave. Libri analizon korrelacionin midis rritjes ekonomike dhe mirëqenies, në dy aspekte: ndikimin e rritjes ekonomike në mirëqenie, por edhe ndikimin e sistemit të mirëqenies në rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Autorët analizojnë disa aspekte të ndikimit të mirëqenies dhe zhvillimit social në rritjen ekonomike, duke argumentuar se mirëqenia e forcës së punës rrit produktivitetin e saj, e cila “përkthehet” në rritje të produkteve e shërbimeve dhe në të ardhura më të larta për sipërmarrjen dhe ekonominë. Lidhja midis modelit të zhvillimit, rritjes ekonomike dhe mirëqenies është një dukuri kontekstuale e realitetit të sotëm shqiptar. Mjaft probleme të ekonomisë dhe mirëqenies janë ende prezent edhe kërkojnë zgjidhje. Dhe një pjesë e rekomandimeve jepen edhe në këtë libër.

Libri i pestë:

“Pandemia dhe rimëkëmbja: strategjitë e përballjes dhe pritshmëritë e zhvillimit”.

Botuar nga Akademia e Shkencave; analizon kushtëzimin mes pandemisë dhe post-pandemisë. Përballimi i pandemisë kërkoi një lidhshmëri të fortë, adaptiv; bashkëpunimin e qeverisë, të institucioneve, komuniteteve dhe qytetarëve. Një pjesë e madhe e barrës së përballimit të pasojave të pandemisë u ra qytetarëve. Prej tyre nuk u kërkuan vetëm durim e sakrificë, por bashkëpunim e pjesëmarrje, vetëkontrolli i sjelljes individuale, përshtatjet në organizimin e punës, zbatimin e rregullave të reja e të ashpra, riorganizimi dhe modifikimet në jetën e përditshme në marrëdhëniet familjare e shoqërore etj. Autorët bëjnë analiza dhe propozime të rëndësishme se si duhet ta administrojë qeverisja, institucionet dhe shoqëria shqiptare situatën post-pandemi, si do t’i përgjigjet legjislacioni reduktimit të burimeve, si do të jetë e ardhmja e afërt dhe perspektive e vendit në vitet që vijnë; si do të administrohet kriza për të mbrojtur një nivel të caktuar jetese, me procesin ligjvënës sot e në të ardhmen e afërt, me drejtësinë shoqërore dhe ndarjen e rrezikut në mënyrë proporcionale, me identifikimin e forcave politike si faktorë veprues në shoqëri. Studiues të fushave të shëndetësisë, ekspertë të ekonomisë e financave, sociologë, specialistë të së drejtës, përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë, analizojnë dhe rekomandojnë masa ligjore e politikash, duke pajtuar argumentin shkencor me mundësitë e shoqërisë për zgjidhje të arsyeshme, për të mbrojtur mirëqenien dhe cilësinë e jetës së qytetarëve.

"Baladë dritash për Zorbën", me nëntitull "Në poetikën e Zef Zorbës", autor  
Viola Isufaj, botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë 2024



Në këtë studim ndiqet me vëmendje sesi në vetmi ndodh udhëtimi në qendër të qenies, përmes së cilit zbulohen disa aspekte të karakterit, personalitetit dhe ekzistencës.

Çështja tjetër do të ishte në kuptimin më të gjerë, një çështje etike, morale: çfarë lloj njeriu banon poemën? Cili është nocioni i tij i jetës së mirë apo i vendit të mirë? Nocioni i tij i së keqes? Çfarë mban ai të fshehtë nga lexuesi? Çfarë fsheh madje dhe nga vetja e tij? Zorba shikohet në këtë studim monografik edhe si një personalitet etik.

Këtu ndërtohen njëkohësisht me analizat e tekstit edhe jetëshkrimi Zef Zorbës, pasi jeta e tij, e pa rënë në sy, meriton vëmendje.

Në disa shenja të tekstit të Zorbës, pikërisht aty ku duket se elementi i shprehësisë personale del mjaft i zbehtë, është zhytur thellë dhe ndërlikueshëm përvoja e tij jetësore.

---

Instalimi i realizmit socialist në letërsinë shqipe shënon një nga shkëputjet më me pasoja të zhvillimit të letërsisë shqipe. Eklipsimi i diellit mu në zenitin e tij të viteve 1930 vazhdoi gjatë. Këto fije rithureshin pa u ndier në fshehtësi dhe rilidhnin poetikat. Prandaj, Zef Zorba në këtë punë vjen si:

- Artisti që rimori fillin e këputur të vazhdimësisë së letërsisë shqipe dhe lidhjes me autorë si Lasgush Poradeci, Mitrush Kuteli, Ernest Koliqi;

- Poeti i dashurimit me fjalën e zorshme, si shijuesi i vezullimeve, i ndërkëmbimeve të hapta a të mërtisura të dritë-errësirës, i mahnitjeve muzikale dhe i ngjyrave pikturale;

- Artisti që krijoi për gjysmë shekulli, i panjohur dhe i fshehur;

“Vijat e forcës” së kësaj poetike përcaktohen në këtë punim nga hulumtimi i kujdesshëm, i ngulët, i dalëngadaltë i teksteve, nga karakteristikat e tyre shumë të përveçme.

Poezia e Zorbës gjithnjë do të ngrëjë një çështje të parë thelbësore: këtu kemi të bëjmë me një mekanizëm të hollë të thurimës poetike. Si funksionon ai mekanizëm? Për këtë, shqyrtohet nga afër, në mënyrë thellësore shkrimi i tij.

Përmes zbulimit të lidhjes me Idromenot dhe në veçanti me Kolë Idromenon, i cili bëhet udhëheqës shpirtëror i Zef Zorbës, shpjegohet njohja dhe afeksioni i tij për artet figurative dhe krijimin e imazheve kryesisht ekspresioniste në poezi.

Zef Zorba punoi për t'i shtuar poezisë, pikturës dhe muzikës saktësinë, hijeshinë, lakimin, ngjyrimin e përkryer të frazave. Moderniteti i tij lidhet me përtsherjet e dritës, ngjyrat, po aq me tingullin dhe modulimin, prandaj vepra gjykohet se mund ta kuptohet më mirë përmes një prerjeje muzikore dhe përmes një takimi me artet pamore.

Në këtë studim autorja është ndalur në mënyrë specifike te relacionet e veprës së tij me muzikën.

Në këtë hulumtim nuk do jetë fjala për një përkthim të tillë, as për muzikalitetin a harmoninë në vetvete, e cila mund të studiohet në çdo krijim artistik. Bëhet fjalë për një poezi tek e cila muzika është cilësi fundamentale. Analogjitë këtu nuk janë të sipërfaqshme, po substanciale. Qysh në krye të herës mund të hetohen qartë ide muzikore-që janë aty për të formatuar një art-i cili aspiron kushtet e muzikës.

Është punuar në këtë terren të rrëshqitshëm për të bërë një analizë të hollë dhe konkrete të relacioneve muzikore në veprën e Zef Zorbës pa rënë në rreziqet që ngerthejnë analogjitë midis arteve.

Zorba konstituon një formë të veçantë të dijes në botën njerëzore. Kështu lind një poezi që kullon traditën e truallit të vet dhe duke thirrur me pasion elemente nga tradita hermetike, sjell në dritë formulime thelbësore të papritura, fjalë të dala nga heshtja, nga thellësia e meditimeve. Këto

fjalë, të zbuluara e të risuara në dimensionin e tyre semantik, dëshirojnë të japin esencën e një pështjellimi sentimental.

Zorba është i dashuruar me gramatikën esenciale të hermetistëve. Zhvendosjet analogjike dhe esencialiteti i fjalës janë aty për të shprehur të pashprehshmen. Përdorimi i shpeshtë i analogjisë, eliminon termin e përafërt (similitudën) për t'i dhënë imazhit efektin- rrufe. Në këtë punim studiohen ato që mund të quhen: tkurrja e sintaksës, eliminimi total ose i pjesshëm i shenjave të pikësisht, zbrëthimi shumë i fortë i pauzave,

---

strukturat tipike të hermetistëve me pleonazmat tipike dhe metaforat e befta si dhe të tjera aspekte.

Kujtesa në korpusin e Zorbës duket se del kryesisht në dy modele të dallueshme, të cilat shpesh ekzistojnë edhe njëkohësisht në të njëjtin tekst: si një mjet për të ngulitur një ndjenjë nostalgjie; dhe, nga ana tjetër, dhe më universalisht, si një mënyrë për ndërtimin e identitetit individual, historik dhe kulturor. Për këtë arsye, kur flasim për këtë personalitet, kujtesa shërben si një temë letrare me rëndësi jo të vogël, së cilës i është kushtuar një çështje më vete.

Hulumtohen ato shenja të tekstit letrar që kondensojnë përvojën e tij jetësore dhe personalitetin e tij. Deri në fund të monografisë vëzhgohet sesi ngjashmëritë opake dhe pasqyrat shformuese ristrukturojnë, transformojnë dhe integrojnë realitete të jetuara, dhe sesi në këtë integrim humbasin kuptimet ngushtësisht personale për të përftuar një material gjithënjëzësor. Vëzhgoohet gjithashtu sesi, i zënë në pasionin eternal për dije dhe arte, artisti Zorba, ristrukturon dhe integron mendimet e tij, ndjesitë dhe sensualitetin në një formë poetike të veçantë e të mbresëlënëse, të brishtë dhe të ndjeshme, multivalente dhe të bukur në vetvete, në një vepër që rilind nga hiri i vet.

---

# Shtojcë



---

## **Libri shkencor është më i vështiri për t'u lexuar por, më i miri për t'u informuar e i vetmi për t'u formuar**

- Fjala e akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i ASHSH, në ceremoninë e çeljes së panairit të tretë mbarëkombëtar i librit akademik dhe shkencor

- Foto nga panairi i tretë mbarëkombëtar i librit akademik e shkencor: janë mbi 35 institucione pjesëmarrëse nga e gjithë hapësira shqiptare dhe rreth 74 tituj të rinj që promovohen në të tria ditët e panairit, ndërsa do të mbahen mbi 40 veprimtari promovuese



Panairi i tretë mbarëkombëtar i librit akademik dhe shkencor hapet sot në një ditë të shenjuar, në Ditën Botërore të Librit, shpallur nga UNESCO në vitin 1995.

E themeluam tre vjet më parë këtë iniciativë, tashmë të kthyer në traditë, në kuadër të politikës së hapjes që ndiqet nga të dy akademitë tona, që përfshin jo vetëm rrjetet tona të kërkimit shkencor e universitar, por edhe vetë lexuesit.

Falenderojmë të gjithë pjesëmarrësit e bashkorganizatorët, ASHAK-un, universitetet, si dhe mbështetjen e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Qëllimi ynë është që botimet shkencore, përmes panairit, të marrin atë vëmendje të kursyer, plotësisht të merituar, që, për shkak të natyrës së tyre, nuk e marrin dot gjatë gjithë vitit. Botimet akademike e shkencore nuk kanë lexues masiv, lexues popullor. Libri



---

shkencor e tremb lexuesin me ngushtësinë disiplinare të problematikës e të formave të të shprehurit, e për zgjedh që në titull, përmes të cilit fton lexues selektiv.

Libri shkencor është më i vështiri për t'u lexuar por, më i miri për t'u informuar e i vetmi për t'u formuar.



Ne kemi vendosur që të mos presim ardhjen e lexuesit tek libri shkencor, por libri shkencor të shkojë tek lexuesi. Në ligjin tonë botimet shkencore-akademike nuk kanë qëllim parësor përfitimin ekonomik. Akademia e Shkencave, në kuadër të kësaj hapësire ligjore, dhuron rregullisht botimet e saj për bibliotekat albanologjike, universitare dhe publike.

Në kohën e sotme libri shkencor nuk mund të qendrojë brenda ishullit të gjuhës së vet. Kjo është një kërkesë që u drejtohet këtyre botimeve kudo. Indeksi ndërkombëtar përmes platformave të njohura si "Scopus" e "Web of Science" është kthyer edhe në vendin tonë në kusht e standard ligjor e nënligjor. Me indeksimin ndërkombëtar, me numrin e leximeve, citimeve, recensionimeve, matet vlera e monografisë apo artikullit; mbi këtë bazë bëhet karriera akademike. Këto kërkesa janë të domosdoshme, megjithëse kanë edhe rrezikun e ndërhyrjes së pragmatizmit në shkencë, madje edhe të inkurajimit të njëfarë shtypi me karakter biznesi. Por problemi më shqetësues është se në këtë proces distanca midis botimeve shkencore dhe lexuesit po zgjatet. Ka vend për të reflektuar, sidomos për botimet albanologjike, që, për vetë natyrën e tyre, janë

tradicionaliste dhe nuk mund të zbatojnë kërkesa thjesht për hir të formës standarde që i dëmtojnë në përmbajtje.



Është e nevojshme që akademitë e shkencave, qendrat e kërkimit elitare dhe rrjeti kombëtar i universiteteve të bashkëpunojnë me një frymë të shëndetshme kolegjiale sidomos për botimet periodike, të cilat kanë mbetur brenda sporteve të fakulteteve e në raftet e departamenteve. Duhet bashkëpunim jo vetëm për të shkëmbyer botimet, por dhe për përfshirjen e tyre në mësimdhënie, sidomos në programet master e doktoratë.

Pranë Akademisë së Shkencave prej fillimit të këtij viti funksionon qendra e komunikimit dhe përhapjes së informacionit shkencor, e specializuar për katalogimin dhe bibliografitë e botimeve akademike dhe universitare. Kjo qendër është e akredituar për zbatimin e sistemit ndërkombëtar "Cobiss" në të gjitha bibliotekat e vendit, që është edhe platformë digjitale dhe bazë të dhënash, portë dhe urë drejt rrjeteve më të gjera ndërkombëtare. Qendra jonë do të mbështesë bashkëpunimin e bibliotekave shkencore për të përfituar nga epërsitë e këtij programi, më i madhi në rajon; për të ushqyer e përdorur efektshmërisht bazën tjetër të specializuar për informacionin shkencor, e njohur me emrin "E-criss.al".

Tri ditët e panairit janë tri ditë të promovimit të botimeve shkencore. Kjo jo vetëm për të vlerësuar e nderuar autorë e vepra, por edhe për të inkurajuar kritikën shkencore, e cila është në pikë kritike: në një pjesë të rasteve vetëm në nivelin e recensioneve, shpesh

---

edhe këto formale; një pjesë tjetër polemike e inatçore; në pjesën më të madhe krejtësisht e munguar. Kritika shkencore është disiplinë, nuk është çështje vullnetarizmi. Ndërkohë që opinionet sundohen nga debatet pseudoshkencore, vepra shumë të rëndësishme mbeten pa asnjë vëmendje publike, madje edhe jashtë rubrikave javore televizive.

Qëllimi është tërheqja e vëmendjes së medias ndaj botimeve shkencore. Shkenca nuk është si sporti, ku çdo tifoz e sheh veten si trajneri më i mirë e mendon se po të ishte ai do të dilnim kampion bote.



Gëzuar Ditën Botërore të Librit!

Mbarësi e suksese panairit të tretë mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor! Suksese autorëve dhe botuesve!

---

## Kemi akoma punë për ta hapur veprimtarinë botuese për autorët dhe lexuesit

Fjalë përshëndetjeje e akad. Mehmet Krajës në ceremoninë e hapjes së panairit të tretë mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor



Të nderuar miq, akademikë, botues dhe të tjerë të pranishëm,  
Dola këtu që t'ju përshëndes në emër të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, të përshëndes çeljen e këtij panairi, që është i treti me radhë në organizim të përbashkët të dy akademive tona.

E kemi thënë dhe tashmë e dinë të gjithë se libri shkencor kërkon një përkujdesje të veçantë shtetërore dhe institucionale dhe ne po përpiqemi ta bëjmë këtë.

Libri shkencor rri fshehur nga kureshtja e lexuesit të zakonshëm dhe kërkon me ngulm lexuesin e kualifikuar, atë që ia di vlerën dhe që i peshon me kompetencë arritjet e tij në botën e dijes.

Libri shkencor nuk është libër i reklamës dhe i tirazheve të mëdha. Bestselerët shkencor janë të rrallë dhe, zakonisht, për t'u bërë të tillë u duhet të heqin dorë, nëse jo në tërësi, së paku nga një pjesë e mirë e natyrës së tyre: nga heshtja e mençur që i rrethon.

Librat shkencorë janë më të paktë në numër, krahasuar me librat letrarë dhe publicistikë, nuk shtypën me letër luksoze, nuk iu bëhen kopertina me zgjidhje të veçantë grafike dhe në përgjithësi lënë përshtypjen e indiferencës. Por magjia e tyre qëndron sa

---

në idetë e reja, në dijet e gjithanshme dhe mendimet e thella, po aq në qëndrueshmërinë e argumenteve dhe vërtetësinë e fakteve.

Deduksionet hipotetike dhe as emocionet nuk janë ana e fortë e shkrimit shkencor.

Në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, që nga themelimi i saj, këtu e 50 vjet të shkuara, botimet janë konsideruar parësore në punën e saj dhe përbëjnë njërin nga shtyllat kryesore të programit vjetor të punës. Ne konsiderojmë se kemi arritur një nivel të mirë të këtyre botimeve, porse kemi akoma punë për të bërë, për ta hapur veprimtarinë botuese ndaj autorëve jashtë Akademisë, jo sipas rastit, por sipas një koordinimi dhe të një vlerësimi publik.



Tani, panairi që kësaj radhe u hap në Tiranë, vjet në Prishtinë dhe vitin e ardhshëm po ashtu në Prishtinë, bëhet i rëndësishëm nëse arrin të tërheq vëmendjen e opinionit, nëse jo të opinionit të gjerë, së paku të botës akademike, duke nxjerrë në pah vlera të qëndrueshme shkencore dhe duke promovuar autorë dhe arritje gjithnjë e më të mëdha dhe më domethënëse.

I uroj zhvillim të suksesshëm panairit III të librit shqip, shkencor dhe akademik dhe e falënderoj Akademinë e Shqipërisë për këtë organizim të shkëlqyer të këtij evenimenti!

Ju faleminderit!

## Shpallet vendimi i Kryesisë për çmimet shkencore qe jepen nga Akademia e Shkencave

- Fjala e akad. Skënder Gjinushi në ceremoninë e shpalljes



Të nderuar të pranishëm,

Akademia jonë e Shkencave e mori vendimin për themelimin e çmimeve shkencore që jepen prej saj në një kohë të vështirë për të; në shenjë të një vullneti të mirë për hapje ndaj botës akademike e universitare të vendit; nisur prej bindjes se në kërkim ekzistojnë rezultate cilësore për t'u vlerësuar, që mund të rekomandoheshin përmes çmimeve si modele të arritjeve shkencore në kohën e sotme.

Në fillim të vitit 2020, me miratimin e Ligjit nr. 53/2019, që krijoi hapësira të reja juridike për zhvillimin e konkurseve për librin shkencor, duke i njohur pikërisht Akademisë së Shkencave të drejtën për dhënien e çmimeve të mëdha, u hartuan e miratuan standarde të qarta përmbajtësore, procedurale e teknike për të nxitur besimin në transparencën e gjykitimit dhe drejtësinë në vendimmarrje.

Jo rastësisht çmimet tona shkencore u pagëzuan me emrat e figurave-emblema të historisë së Akademisë së Shkencave dhe para saj të historisë së Universitetit, të fakulteteve e katedrave, të klinikave e shërbimeve; me të cilët janë identifikuar e identifikohen arritjet më të rëndësishme në disiplinat tona shkencore. Qëllimi kryesor ka

qenë dhe është që të demonstrojmë vazhdimësinë e punës kërkimore të tyre nga brezat e mëvonshëm, të krijojmë lidhje midis brezave, të nderojmë më të mirët me çmime që mbajnë emrat e më të mirëve; njëherësh të evokojmë e lartësojmë kontributet e themeluesve.



Çmimet tona shkencore mbajnë emrin e Eqrem Çabejt e të Aleks Budës; mbajnë emra të albanologëve më të shquar të kohërave; ato bëjnë krenarë fituesit dhe na bëjnë krenarë ne, që i kemi pasur në krye si modele suksesi në kërkim e drejtim shkencor.

Që nga viti 2016 çmimi "Çabej" është akorduar tri herë dhe është fituar nga personalitete të dijes, si Pëllumb Xhufi, Kolec Topalli, Anastas Angjeli e Adrian Civici. Çmimi "Radovicka", i themeluar për më të suksesshmit në shkencat teknike dhe natyrore, është akorduar për personalitete të tillë si Niko Pano, Nazim Gruda, Andrea Shundi e Gjovalin Gruda; çmimi "Aleks Buda", i themeluar për nxitjen e brezave të rinj në kërkim, fillimisht me emrin "për studiuesin e ri më të suksesshëm", është fituar nga anëtarë të Akademisë së të Rinjve si Andrea Rëmbeci, Sokol Çunga e Teuta Toska. Për merita jetësore Asambleja jonë vendosi të krijojë çmimin e Karrierës, të cilin me plot meritë e kanë fituar Idriz Ajeti, Luan Omari, Ismail Kadare e Bardhyl Golemi.

Herë pas here, për të nderuar ngjarje të mëdha jubilarë dhe për të inkurajuar kërkimin në fusha problematike të dijes për shkak të vështirësisë së tyre,

Akademia e Shkencave ka themeluar çmime të veçanta: për veprën shkencore më cilësore kushtuar figurës së Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, në 550-vjetorin e ndarjes së tij nga jeta; për 75-vjetorin e çlirimit nga pushtimi nazifashist; për 810-vjetorin e Shtetit të Arbërit dhe për ngjarje e disiplina të tjera. Me këto çmime dhe me çmimin e madh të

albanologjisë "Majer-Jokli-Pedersen" janë nderuar personalitete vendëse si Aurel Plasari, dhe figura të shquara të albanologjisë, me përmasa europiane e botërore, si Sir Noel Malcolm, Lucia Nadin e Roderick Bailey. Vitin e kaluar kishim çmimin e veçantë "Shuteriqi", i cili ka lënë gjurmë të thella në historinë e fillimeve të vetëdijes dhe organizimit shtetëror ndër arbër. Sivjet kemi shpallur çmimin "Pilika", që mban emrin e themeluesit dhe drejtuesit historik të katedrës së matematikës, të bashkëthemeluesit të Universitetit të Tiranës e të personifikimit të karrierës së suksesshme edhe në shkencë të tilla si matematika.



Ne do të vazhdojmë edhe më tej të promovojmë përmes çmimeve kërkuesit më të zotë të kohës së sotme paralelisht dhe përmes emrave më të shquar të shkencës shqiptare, siç janë ata që përmenda dhe të tjerë të së njëjtës lartësi me ta. Përmes çmimeve dhe konkurseve synojmë dhe do t'ia arrijmë që të nxjerrim nga heshtja traditën dhe të vlerësojmë të sotmen.

Ju faleminderit për vëmendjen.



## Përurohet qendra për koordinimin dhe përhapjen e informacionit shkencor

- Përrurimin e çeli me një fjalë të shkurtër Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi -

- Një moment i rëndësishëm në këtë përrurim ishte nënshkrimi i protokolleve të bashkëpunimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë përfaqësuar nga Kryetari Skënder Gjinushi me rektorët e universiteteve, përkatësisht me rektorin e universitetit "Luarasi" prof. Ethem Ruka dhe rektorin e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë prof. Adrian Civici



Drejtuese e qendrës për koordinimin dhe përhapjen e informacionit shkencor pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë është Mirlona Buzo.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë si një institucion i rëndësishëm për organizimin dhe drejtimin e veprimtarisë shkencore në vend, në bashkëpunim me Institutin e Shkencave të Informacionit në Slloveni, duke vlerësuar rritjen e interesit për informacionin kërkimor në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare në ndihmë të kërkimit shkencor mundësuan krijimin e kësaj qendre, do të nënshkruajë edhe me universitete të tjera publike e jopublike këtë protokoll.

---

Kontributi i Akademisë së Shkencave është krijimi i këtij mjedisi të hapur për të gjithë përdoruesit, kërkues shkencorë, staf akademik, studentë dhe çdo përdorues tjetër të interesuar për informacionin shkencor.

Instituti i Shkencave të Informacionit, Slloveni në vazhdimësi kontribuon në infrastrukturën dhe zhvillimin e njohurive dhe përvojat për organizimin dhe administrimin e sistemeve "Ecris" dhe "COBISS.AL", të domosdoshëm për veprimtarinë e kësaj qendre.



Për realizimin e aksesit digjital kjo qendër do të punojë me sisteme të integruara të informacionit të ndërtuara mbi standarde ndërkombëtare të lidhura në rrjete të ndërsjellta.

Objekti për krijimin e qendrës është:

1. Krijimi i rrjetit të kërkuesve shkencorë shqiptarë brenda dhe jashtë vendit; zgjerimi i bazës së veprimtarisë kërkimore E-CRIS.AL në Shqipëri, si bazë të dhënash për kërkuesit shkencorë, organizatat dhe projektet kërkimore;

2. Promovimi, transparenca, përcjellja dhe vlerësimi i rezultateve të kërkimit shkencor, si dhe përpilimi i bibliografive personale shkencore;

3. Zgjerimi i qendrave të informacionit në institute shkencore, institucionet e arsimit të lartë (IAL), biblioteka publike të përfshira në rrjetin e përbashkët të informacionit shkencor online COBISS.AL dhe në rrjetin COBISS.Net;

4. Zbatimi i standardeve ndërkombëtare në përgatitjen e informacionit shkencor në procesin e digjitalizimit në këto institucione;

5. Përfshirja e burimeve online me tekst të plotë (pa pagesë) të informacionit në ndihmë të kërkimit shkencor dhe veprimtarisë akademike;

6. Ndërgjegjësimi i vendimmarrësve të institucioneve kërkimore-shkencore për përfshirjen e tyre në rrjetet e informacionit shkencor.



Qendra do të kryejë funksione:

1. Koordinimin, organizimin dhe administrimin e sistemit COBISS.AL;

2. QKPISH kujdeset për përfshirjen, planifikimin dhe harmonizimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me lidhjen e qendrave të informacionit (bibliotekave të I.A.L-së, institucioneve shkencore dhe bibliotekave publike) në sistemin COBISS.AL, duke krijuar një rrjet të përbashkët të informacionit shkencor; Në qendër do të zhvillohen edhe seminare dhe takime për prezantime të përditësimeve të vazhdueshme të platformave, për t'u konsultuar dhe zgjidhur probleme dhe dinamika të punës në program.

3. Vendos bashkëpunim dhe ndërveprim midis këtyre institucioneve përmes marrëveshjeve;

4. Zhvillon kualifikime profesionale e teston aftësinë e specialistëve për përdorimin e programit COBISS, duke i pajisur me licencat për përdorimin e programit, drejtpërdrejt ose online;

5. Ofron ndihmë profesionale për qendrat e informacionit, për bibliotekat e përdoruesit e tjerë të programit e të shërbimeve të programit COBISS; përcjell punën e qendrave të informacionit e ndihmon në zgjidhjen e problemeve të tyre, sipas procedurave përkatëse.

6. QKPISH siguron dhe organizon informacionin shkencor në përshtatje me kërkesat e kërkuesve shkencorë për zhvillimin e hulumtimit shkencor në Shqipëri.

7. QKPISH ndikon në transformimin e nevojave të studiuesve shkencorë në përshtatje me mjetet dhe aplikacionet për të përmbushur misionin e saj dhe nxit integrimin e përmbajtjeve digjitale në website dhe pajisje mobile dhe përshtatjen e tyre me nevojat ndaj përdoruesve.



#### Përvoja e bashkëpunimit

Qendra ka në fokus konsolidimin e platformave që zotërojmë dhe që shumica e bibliotekave i kanë tashme në përdorim prej më shumë se 10 viteve si Baza për kërkuesit shkencor (Ecris.AL) dhe katalogu i përbashkët COBISS.AL si edhe platformat për burimet online EIFL dhe Unpaywall.

Në sistemin e kërkuesve shkencorë deri tani bëjnë pjesë rreth 800 kërkues shkencorë (përfshirë anëtarët e asamblesë së ASH, kërkues shkencorë të universiteteve dhe qendrave kërkimore si edhe anëtarët e akademisë së të rinjve në ASH).

---

Përmes kësaj platforme janë hartuar bibliografite online të kërkuesve shkencorë të cilat mund të aksesohen në internet për përdoruesit.

Në sistemin COBISS.AL janë përfshirë 40 biblioteka universitare shtetërore dhe private, biblioteka publike si edhe biblioteka të tjera të vendit. 87 punonjës të këtyre bibliotekave janë kualifikuar dhe janë pajisur me licencat përkatëse për të punuar në këtë sistem. Këta punonjës prezantohen vazhdimisht me përditësimet e sistemit dhe platformave të reja për digjitalizimin e informacionit.

Përmes sistemit COBISS.AL janë arritur këto rezultate:

- Është krijuar katalogu i përbashkët online i bibliotekave në Shqipëri dhe i çdo biblioteke në veçanti. Bibliotekat janë në rrjet dhe shkëmbejnë informacione së bashku.

- Tashmë prej 10 vitesh shumicat e bibliotekave universitare po përdorin sistemin COBISS duke pasuruar rrjetin me informacion shkencor (rreth 150.000 milion regjistrime bibliografike).

- Është implementuar aplikacioni për ruajtjen e përmbajtjeve të digjitalizuara (Repository Digital dcoBISS.AL). Ka filluar procesi i digjitalizimit në biblioteka me revistat shkencore të botuara nga institucionet. Revistat janë tekste të plota të integruara në platformën dCOBISS.

Përmbajtja e revistave është e indeksuar.

- Përdoruesit mund të gjejnë me të gjithë elementët e kërkimit në botim dhe mund të shkarkojnë tekstin e plotë.

- Janë përgatitur kartat digjitale të anëtarësimit në bibliotekë.

- Është vënë në përdorim "biblioteka mobile" (aplikacioni "mcoBISS"), aplikacion në smartphone, nga ku përdoruesit mund të shkarkojnë materiale dhe mund të shfrytëzojnë bibliotekën online.

Akademia e Shkencave në bashkëpunim me IZUM-in për vite me radhë ka mbështetur dhe përhapur burime pa pagesë për universitetet dhe qendrat kërkimore, përmes projektit ERA (projekt i ofruar nga Qeveria Slovene), Konsorciumit të Bibliotekave Shqiptare duke siguruar akses free në bazat e ofruara nga EIFL (përmes pagesës vjetore që paguan Akademia çdo vit për konsorciumin).

Të gjithë bibliotekat e përfshira në sistemin COBISS.AL përfitojnë nga shërbimi "Unpaywall".

- Shërbimi Unpaywall është i integruar në programin COBISS.

- Shërbimi Unpaywall përmban artikuj me tekst të plotë nga burime me akses të hapur nga e gjithë bota.

- Unpaywall është një motor kërkimi global për botime shkencore dhe rezultate të tjera kërkimore që ofron më shumë se 30 milionë artikuj shkencorë me akses të hapur.

- Shërbimi Unpaywall nuk është i kufizuar në zonën IP të një universiteti ose qendrave kërkimore.

## Strategjia për të ardhmen

Synojmë përpunimin e një strategjie për të përhapur kërkimin shkencor në mënyrë sa më eficiente duke ju krijuar mundësinë kërkuesve shkencorë të kenë metodat më moderne për aksesin e informacionit dhe të stimulojmë bashkëpunimin midis kërkuesve shkencorë shqiptarë.



Gjetjen e informacionit përmes një motori të vetëm kërkimi duke sjellë një informacion të plotë sasiorë dhe kualitativ.

E ardhmja e informacionit është integrimi i Inteligjencës artificiale (AI) e cila po transformon me shpejtësi mënyrën e aksesimit dhe përdorimit të informacionit.

Zhvillimi i platformave është gjithmonë në rritje. Kohët e fundit është pasuruar me elemente të Inteligjencës Artificiale, si p.sh. kërkimi inteligjent është bërë tashmë i përdorshëm dhe ka përpjekje për të avancuar me tej pasi kjo është pjesë e transformimit digjital.

Kjo formë do të bashkojë ekspertët kryesorë, studiuesit, bibliotekarët dhe entuziastët e teknologjisë për të ndarë njohuritë, shkëmbyer ide dhe për të parashikuar të ardhmen e bibliotekave në epokën e re.

Qendra mirëpret kolegë dhe studiues për ide të reja inovative dhe bashkëpunime të mëtijshme në përhapjen e informacionit shkencorë në të gjithë vendin.

Me krijimin e qendrës marrëdhëniet midis institucioneve bashkëpunuese dhe qendrës së informacionit shkencor pranë Akademisë do të formatizohen përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit.

## Paraqitet ecuria e tri projekteve madhore të albanologjisë

Drejtori i QBEA prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi drejton seancën; referojnë për projektet prof. dr. Neritan Ceka, akad. Valter Memisha dhe akad. Shaban Sinani

Një nga veprimtaritë gjatë ditës së parë të panairit të tretë mbarëkombëtar të botimeve akademike e shkencore ishte prezantimi i tri projekteve madhore të Qendrës së Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike: "Fjalor i madh i gjuhës shqipe", "Enciklopedia shqiptare" dhe "Historia e shqiptarëve". Seanca u drejtua nga prof. Marenglen Kasmi, drejtor i QBEA-së.



Akad. Shaban Sinani, që paraqiti projektin e "Enciklopedisë shqiptare" e cilësoi atë si një nga projektet më të mëdha të ndërmarra ndonjëherë në shkencat shoqërore dhe albanologjike për sa i takon volumit dhe numrit të kërkuesve të përfshirë. Rreth 1500 do të jetë numri i përgjithshëm i autorëve, praktikisht e gjithë bota intelektuale e Shqipërisë. ESH është llogaritur si një amzë e trashëgimisë dhe e identitetit shqiptar dhe si një propozim për vlerat më të mira të popullit shqiptar në të ardhmen e përfshirjes së këtij vendi në Europën e Bashkuar. Sinani foli për fazat e kaluara dhe të ardhshme të projektit. Ai theksoi se tashmë kemi standardet që lejojnë të punohet me një disiplinë të njëzuar kudo që funksionojnë redaksitë dhe pavarësisht dallimeve për shkak të fushave, gjë që na bën optimistë mbi suksesin e realizimit të këtij projekti brenda kohës së parashikuar. Enciklopedia, që do të ketë rreth 10 mijë artikuj, do të jetë paraqitje objektive e trashëgimisë, vlerave shpirtërore, materiale e natyrore të vendit, duke respektuar kriteret e njësuara të miratuara në të gjitha nivelet e redaksive. Kriteri i përfaqësimit, mospërfshirja emocionale dhe kompetenca shkencore do të përforcojnë njëri-tjetrin.

Kalimi prej fjalorëve enciklopedikë në një enciklopedi të vërtetë do të zgjidhë dhe një problem tjetër, kodifikimin e stilit enciklopedik të shkruarit, që nuk ka ndonjë traditë të vlerësuar.



Prof. Neritan Ceka që paraqiti projektin e “Historisë së shqiptarëve”, tha se projekti do të realizohet në katër vëllime sipas periudhave historike, ka dy redaktorë kryesorë, por është një punë kolektive, ku secili vëllim ka një redaktor përgjegjës. Për këtë botim do të shfrytëzohet një pasuri e madhe kërkimore e hartuar nga autorë kompetentë dhe do të jetë në shërbim të gjithë atyre që duan të kenë në dorë një vepër përmbledhëse për gjithë historinë e territoreve ku është zhvilluar populli shqiptar, pra territorin e Shqipërisë, Dardaninë antike (Kosova e sotme), Maqedoninë e Veriut, Epirin dhe Dalmacinë, pa u druajtur nga paragjykimet.





Akad. Valter Memisha, që paraqiti projektin e “Fjalorit të madh të gjuhës shqipe”, tha se ai është një fjalor normativ i domosdoshëm që fillesat i ka shumë herët, por që u konkretizua vetëm nëpërmjet këtij projekti të ASH-së që e solli punën në fazën më të hovshme. Fjalori do të përfundojë vitin e ardhshëm dhe vjen si nevojë e përdoruesve të shqipes bashkëkohore për njësi që ende nuk janë pasqyruar në vepra leksikografike. Ai do të jetë një vepër kombëtare në kuptimin më të mirëfilltë të fjalës, jo vetëm se hartuesit janë nga të gjitha trojet, por edhe sepse sjell leksik nga të gjitha trojet me vazhdimësi gjeografike dhe nga ngulimet shqiptare.



Fjalori do të ketë rrezatim të gjerë përdorimi për të gjithë ata që merren veçanërisht me gjuhën e shkruar, por edhe të folur, me krijime letrare, përkthime etj. Akad. Memishaj e përfundoi fjalën e tij duke thënë se kjo vepër është e mirëpritur dhe ka një rëndësi të jashtëzakonshme.

Fjalën e mbylljes e mbajti kryetari i ASHSH akad. Skënder Gjinushi, i cili përgëzoi punën që po bëhet për këto ndërmarrje të mëdha të Akademisë, të cilat i cilësoi si të domosdoshme për kohën, rrjedhim të një nevoje të akumuluar në kohë dhe tregues i zotërimit të kapaciteteve të duhura intelektuale. Ai theksoi se kjo është edhe një përvojë që tregon se ku duhet të drejtohet albanologjia në të ardhmen, puna e instituteve, duke u nisur nga problemet dhe detyrat madhore që shtrohen para albanologjisë e duke vënë në funksion të tyre studimet e tjera në vazhdim. Këto tri botime janë udhërrëfyese të detyrave themelore të albanologjisë dhe fakti që këtë e përballuam edhe në kushtet para bashkimit të instituteve me ASHSH, do të thotë se do ta kemi më të lehtë për ta vazhduar në të ardhmen. Këto projekte janë edhe shembulli më i mirë i bashkëpunimit se si

institutet duhet ti realizojnë projektet duke afruar sa më shumë studiues të institucioneve të tjera brenda dhe jashtë vendit, duke shumëfishuar kështu kapacitetet intelektuale dhe investimet në logjistikë.



**Në kuadër të panairit të tretë mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor përurohet në sallën "Aleks Buda" libri "Arbëreshët - shqiptarët e Italisë" i Fatmir Toçit, bot. "Toena"**



- Nga fjala e akademikut Matteo Mandalà (përmes lidhjes në linjë gjatë përrurimit)

Një libër si ai që Fatmir Toçi u ka kushtuar arbëreshëve ngjall reagime të ndryshme në varësi të atyre, që marrin ta lexojnë. Për shqiptarët e Shqipërisë dhe, më gjerë, të Ballkanit, është si të shohin një film të vjetër, ku tregohen peripecitë e një populli, të popullit të tyre, i cili ka prodhuar histori më tepër se ç'ka qenë në gjendje të konsumojë: nga epepeja e Skënderbeut deri te krijimi i një trajte të re identiteti, te pjesëmarrja aktive në jetën shoqërore dhe politike të vendit, që i ka mikpritur, deri te të dëshmuarit konkret të zotërimit të një force të pamposhtur, që lë një përshtypje të veçantë dhe që është aq e spikatur, sa rrallë ndeshet në mjedise të tjera antropologjike. Me një fjalë, shqiptari i sotëm do të ishte në thelb i një mendjeje me Pier Paolo Pazolinin, i cili e përkufizoi dukurinë e arbëreshëve si "një mrekulli antropologjike" dhe Toçi na jep një pamje të plotë, do të guxoja të thoja madje enciklopedike, të kësaj mrekullie.


Por ndryshe do të ishte reagimi i një arbëreshi pas leximit të këtij libri. Ai do të gjente atje rindërtimin e hollësishëm, të përpiktë, madje pedant, të të gjitha elementeve,

që bien në sy gjatë një shikimi të sipërfaqshëm, por që shpesh nuk i bëjnë përshtypje dikujt, që ka lindur dhe që vazhdon të jetojë në gjirin e një kulture të tillë. Është njëlloj si të qëndrosh përpara pasqyrës dhe të shikosh pasqyrimin tënd atje me një ndjenjë dyzimi, pasqyrim i cili e ndryshon, nganjëherë e shtrembëron, rrokjen e realitetit, por në fund të fundit ia rikthen këtë realitet lexuesit në një trajtë të plotë, sikundër nuk e kishte perceptuar kurrë më parë.



Pikërisht kjo ka qenë ndjesia, që më lindi që nga botimi i parë i këtij libri të vëllimshëm, të cilin e vlerësoj si një dhuratë të vërtetë që i bëhet komunitetit, pjesëtar i së cilës kam nderi të jem dhe në emër të së cilës, ndonëse askush nuk ma ka dhënë lejen për një gjë të tillë, dëshiroj ta falënderoj Fatmir Toçin për këtë portret të pazakontë shumëdimensional të botës arbëreshe.

**Paraqitet "Bibliografia e veprimtarisë shkencore të Ali Aliut", anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë**



- Përmban mbi 600 njësi bibliografike, të ndara sipas standardit ndërkombëtar ISO 690 -

- Nderohet prej miqve e kolegëve 90-vjetori i studiuesit të mirënjohur -

Në ditën e dytë të panairit mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor - nismë e përbashkët e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës - u paraqit "Bibliografia e veprimtarisë shkencore të Ali Aliut", anëtar i jashtëm i ASHSH (në 90-vjetorin e lindjes).

Veprimtaria u drejtua nga dr. Arian Leka, ndërkohë që tiparet më të rëndësishme të veprimtarisë shkencore të Ali Aliut, të shprehura përmes zërave bibliografikë, u shtjelluan hollësisht nga akad. Shaban Sinani.

Ndër argumentet më të spikatur të kësaj veprimtarie Sinani cilësoi rolin e Ali Aliut

si “kapërcyes i kufijve”, studiuesin gjithmonë të gatshëm në gjurmim dhe vlerësim kritik të letërsisë shqipe, pavarësisht se ku ajo krijohet. Ky studiues, theksoi Sinani, i ka shpërfillur kufijtë ndarës, krijuar prej gjeopolitikës, duke hulumtuar nënsistemet e letërsisë shqipe, për të gjetur aty vlerat përfaqësuese dhe për të propozuar një rend të qëndrueshëm hierarkik.



Shpërndarë në mëse gjashtë dekada, kontributi i Ali Aliut në shkencën e kritikës letrare ka pasur autoritetin e një historie të letërsisë shqiptare edhe pa qenë e formuluar si e tillë, duke prekur gjithë hapësirën historike ku është shkruar dhe shkruhet shqip. Kërkimi, mbledhja, klasifikimi dhe përfundimet përmbajtësore, të prejardhura nga zërat bibliografikë, kanë sjellë rezultate befasuese mbi punën e këtij studiuesi në fushë studimit të letërsisë si përfshirje dhe përfaqësim. Falë punës së “shkencëtarit që bashkoi tre kryeqytete letrare” dhe njeriut që ka vështruar gjithmonë përtej kufijve, sot kemi një hartë që vazhdon të plotësohet, duke krijuar përfytyrimin se letërsia shqipe funksionon si tërësi, ndarë në zona të ndryshme sipas tipologjive stilistikore zhanrore, theksoi Sinani.

Shprehur në dhëna numerike të dy motorëve të përpunimit të informacionin shkencor - “Cobiss.al” dhe “Cobib.al” - rrugëtimi krijues i Ali Aliut shenjon rreth 1032 njësi bibliografike (deri në vitin 2022). Në këto të dhëna, që sjellin në vëmendje gjithë sa

lidhet me emrin e Ali Aliut si autor monografish, udhëhaqës universitar, ushtrues i kompetencave editoriale (redaktor, recensues, përgatitës etj), përpunara sipas kriterëve shkencorë (duke përjashtuar përkimet dhe përsëritjet), rezultojnë rreth 600 rekorde/njësi, përshkrime bibliografike, të njohura kronologjikisht e tipologjikisht sipas standardit ndërkombëtar ISO 690.



Ndonëse jopërfundimtare, pasi në indeksim mungojnë të dhënat mbi shkrimet e Ali Aliut në gazetën “Flaka e vëllazërimit”, si dhe të dhëna të tjera, që motorët e kërkimit nuk i mundësojnë, “Bibliografia” bën të dukshëm faktin se në sistemin e propozuar nga ky studiuës rastësorja dhe kalimtarja, ndonëse pikaset, nuk merr vëmendje. Kjo ia lë vendin përfaqësueses, fenomenit dhe dukurisë letrare.

Përveç kësaj, zërat e “Bibliografisë” vënë në dukje edhe raportin e studiuësit me pushtetet, kur vjen rasti i marrjes së mbrojtje të letërsisë së ndaluar apo të penguar në Shqipëri, të tillë si Dritëro Agolli, Petro Marko, Faton Arapi, Xhevahir Spahiu, në përfaqësimin e rrjedhave letrare apo përfaqësimin i një breznie, shprehur në emrat e Lasgush Poradecit, Migjenit dhe të tjera prirje e dukuri të shenjzuara që herët si zhvillime të kohës, vëzhguar si atipizëm të Koço Kosta apo Zija Çela apo ndërkombëtarizimi i letërsisë shqiptare përmes rasteve të Ismail Kadaresë dhe Fatos Kongolit.

Studiuësi Shaban Sinani theksoi gjithashtu se në sistemin letrar të propozuar nga Aliu Aliu zënë vend vetëm lloje prioritare (monografi, artikull shkencor), më të mëdhenjtë, paraqitja e të cilëve përjetohet si mision ndaj lexuesit dhe studimeve letrare. U vërejt edhe se në panoramën e gjerë të ofruar nga “Bibliografia” kushtuar akademik

Ali Aliut të dhënat janë në përpunim dhe në pasurim të vazhdueshëm, pasi në të mungojë kontribute që nuk janë pjesë e sistemit të kërkimit të numerizuar, si veprimtaria universitare, botimi kritik i veprave të autorëve tradicionalë apo bashkëkohorë, shprehur në peritekste dhe epitekste shoqëruese.



Pa anashkaluar kontributin si autor i 65 studimeve monografike dhe përmbledhjeve me studime, pjesë e së cilës është edhe “Don Kishoti ndër shqiptarët” (vepra më e ribotuar dhe më e përkthyer e Ali Aliut) dhe përkthimeve të spikatura nga shqipja në gjuhë të fqinjve i 25 veprave letrare, dr. Arian Leka u ndal edhe te përkushtimi i kryehershëm i Ali Aliut, si studiues dhe kritik i letërsisë, në gjurmimin e antologjikes në letërsinë shqiptare, me veprën përfaqësuese “Gjysmëshekulli i artë - antologji e poezisë shqipe” (Tetovë, 2000; Tiranë, 2002).

Përmes kësaj antologjie Ali Aliu ka ndjekur trajektoret e një bashkësie që, përtej dallimeve, ka të përbashkët gjuhën dhe traditën letrare. Si model, kjo përzgjedhje tekstesh përfaqëson theksime letrare dhe qasje antropologjike, që vendosin homogjenitetin e një kulture përmbi ndarjet.

Pa i fshehur vështirësinë e akordimit të "Antologjisë" rreth një estetike të vetme, autori nuk mbulon as dallimet, që kanë mes tyre poetët me etni të njëjtë, por me shqetësime të ndryshme, duke u ndalur kryesisht mbi atë çka është estetikisht e lartë, mbi atë që si përfaqësim është antologjike, për ta shndërruar leximin e përzgjedhur në dialog



---

epistiemik të njohjes dhe dëshmisë.

Gjatë gjithë jetës së tij të begatë krijuese, Ali Aliu e ka përmbushur misionin e përgatitjes së një antologjie jetësore, shpërndarë në libra të veçantë, të cilët, me kalimin e kohës, krijojnë një antologji të antologjive, ku kontributet Ali Aliut bashkohen rrethntitujve të tillë si “Kërkime” (1971), “Shqyrtime” (1974), “Rrjedhave të letërsisë” (1977), “Kritika” (1980), “Teoria e letërsisë” (1986), “Don Kishoti te Shqiptarët” (1996, 2005), “Reflekse letrare” (1999), “Magjia e fjalës” (2003) etj.

Gjatë përrurimit morën pjesë me diskutime Naim Zoto, Erarba Çiraku etj.

**Panairi Mbarëkombëtar i Librit Akademik dhe Shkencor, si nismë e përbashkët e Shqipërisë dhe Kosovës, nisi në Ditën e Librit edicionin e tretë në Akademinë e Shkencave në Tiranë**

Dita e parë, 23 prill 2024



Panairi Mbarëkombëtar i Librit Akademik dhe Shkencor, si nismë e përbashkët e Shqipërisë dhe Kosovës, nisi në Ditën e Librit edicionin e tretë më 23 prill 2024 në Akademinë e Shkencave në Tiranë. Pas vitit të kaluar në Prishtinë, edicioni i tretë u rikthye në Tiranë.

Morën pjesë mbi 35 institucione pjesëmarrëse nga e gjithë hapësira shqiptare dhe rreth 74 tituj të rinj që u promovuan përmes 40 veprimtarive.

Panairin e çeli Kryetari i Komitetit të organizimit të këtij panairi, zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Vasil Tole. Ai ja dha fjalën Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushit.

Akad. Gjinushi tha se e themeluan tre vjet më parë këtë iniciativë, tashmë të kthyer në traditë, në kuadër të politikës së hapjes që ndiqet nga të dy akademitë tona, që përfshin jo vetëm rrytet tona të kërkimit shkencor e universitar, por edhe vetë lexuesit.

Falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit e bashkorganizatorët, ASHAK-un, universitetet, si dhe mbështetjen e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Qëllimi ynë është që botimet shkencore, përmes panairit, të marrin atë vëmendje

---

të kursyer, plotësisht të merituar, që, për shkak të natyrës së tyre, nuk e marrin dot gjatë gjithë vitit. Botimet akademike e shkencore nuk kanë lexues masiv, lexues popullor. Libri shkencor e tremb lexuesin me ngushtësinë disiplinare të problematikës e të formave të të shprehurit, e përzgjedh që në titull, përmes të cilit fton lexues selektiv.

Libri shkencor është më i vështiri për t'u lexuar por, më i miri për t'u informuar e i vetmi për t'u formuar.-theksoi ndër të tjera akad. Gjinushi.

Ai tha se "Ne kemi vendosur që të mos presim ardhjen e lexuesit tek libri shkencor, por libri shkencor të shkojë tek lexuesi. Në ligjin tonë botimet shkencore-akademike nuk kanë qëllim parësor përfitimin ekonomik. Akademia e Shkencave, në kuadër të kësaj hapësire ligjore, dhuron rregullisht botimet e saj për bibliotekat albanologjike, universitare dhe publike.

Në kohën e sotme libri shkencor nuk mund të qëndrojë brenda ishullit të gjuhës së vet. Kjo është një kërkesë që u drejtohet këtyre botimeve kudo. Indeksimi ndërkombëtar përmes platformave të njohura si "Scopus" e "Eeb of Science" është kthyer edhe në vendin tonë në kusht e standard ligjor e nënligjor. Me indeksimin ndërkombëtar, me numrin e leximeve, citimeve, recensionimeve, matet vlera e monografisë apo artikullit; mbi këtë bazë bëhet karriera akademike. Këto kërkesa janë të domosdoshme, megjithëse kanë edhe rrezikun e ndërhyrjes së pragmatizmit në shkencë, madje edhe të inkurajimit të njëfarë shtypi me karakter biznesi. Por problemi më shqetësues është se në këtë proces distanca midis botimeve shkencore dhe lexuesit po zgjatet. Ka vend për të reflektuar, sidomos për botimet albanologjike, që, për vetë natyrën e tyre, janë tradicionaliste dhe nuk mund të zbatojnë kërkesa thjesht për hir të formës standarde që i dëmtojnë në përmbajtje.

Është e nevojshme që akademitë e shkencave, qendrat e kërkimit elitare dhe rrjeti kombëtar i universiteteve të bashkëpunojnë me një frymë të shëndetshme kolegjiale sidomos për botimet periodike, të cilat kanë mbetur brenda sporteve të fakulteteve e në raftet e departamenteve. Duhet bashkëpunim jo vetëm për të shkëmbyer botimet, por dhe për përfshirjen e tyre në mësimdhënie, sidomos në programet master e doktoratë."

Akad. Gjinushi tha se tri ditët e panairit janë tri ditë të promovimit të botimeve shkencore. Kjo jo vetëm për të vlerësuar e nderuar autorë e vepra, por edhe për të inkurajuar kritikën shkencore, e cila është në pikë kritike: në një pjesë të rasteve vetëm në nivelin e recensioneve, shpesh edhe këto formale; një pjesë tjetër polemike e inatçore; në pjesën më të madhe krejtësisht e munguar. Kritika shkencore është disiplinë, nuk është çështje vullnetarizmi. Ndërkohë që opinionet sundohen nga debatet pseudoshkencore, vepra shumë të rëndësishme mbeten pa asnjë vëmendje publike, madje edhe jashtë rubrikave javore televizive.

Me pas përshëndeti Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, akad. Mehmet Kraja.

---

“E kemi thënë dhe tashmë e dinë të gjithë se libri shkencor kërkon një përkujdesje të veçantë shtetërore dhe institucionale dhe ne po përpiqemi ta bëjmë këtë. Libri shkencor nuk është libër i reklamës dhe i tirazheve të mëdha. Bestsellerët shkencorë janë të rrallë dhe, zakonisht, për t'u bërë të tillë u duhet të heqin dorë, nëse jo në tërësi, së paku nga një pjesë e mirë e natyrës së tyre: nga heshtja e mençur që i rrethon. Librat shkencorë janë më të paktë në numër, krahasuar me librat letrarë dhe publicistikë, nuk shtypën me letër luksoze, nuk iu bëhen kopertina me zgjidhje të veçantë grafike dhe në përgjithësi lënë përshtypjen e indiferencës. Por magjia e tyre qëndron sa në idetë e reja, në dijet e gjithanshme dhe mendimet e thella, po aq në qëndrueshmërinë e argumenteve dhe vërtetësinë e fakteve. Deduksionet hipotetike dhe as emocionet nuk janë ana e fortë e shkrimit shkencor. -tha akad. Kraja -dhe theksoi se në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, që nga themelimi i saj, këtu e 50 vjet të shkuara, botimet janë konsideruar parësore në punën e saj dhe përbëjnë njërin nga shtyllat kryesore të programit vjetor të punës.

Më tej akad. Kraja tha se: “Tani, panairi që kësaj radhe u hap në Tiranë, vjet në Prishtinë dhe vitin e ardhshëm po ashtu në Prishtinë, bëhet i rëndësishëm nëse arrin të tërheq vëmendjen e opinionit, nëse jo të opinionit të gjerë, së paku të botës akademike, duke nxjerrë në pah vlera të qëndrueshme shkencore dhe duke promovuar autorë dhe arritje gjithnjë e më të mëdha dhe më domethënëse. I uroj zhvillim të suksesshëm panairit III të librit shqip, shkencor dhe akademik dhe e falënderoj Akademinë e Shqipërisë për këtë organizim të shkëlqyer të këtij evenimenti!”

Në ceremoninë e hapjes përshëndeti edhe drejtoresha e QKLL, znj. Alda Bardhyli. “Panairi synon një ridimensionim të rolit të shkencës në një shoqëri të hapur, një prani përfaqësuese sa më të gjerë, duke bërë bashkë autorët, botimet, institucionet e kërkimit dhe IAL-të, që në fokus të punës së tyre kanë librin akademik e shkencor”, tha znj. Bardhyli.

“Ne jemi të gëzuar që sot kemi mirëpritur, jo vetëm Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës por dhe shumë botues të tjerë të universiteteve, të qendrave kërkimore dhe botues. Krahas promovimeve reciproke të autorëve të Shqipërisë dhe Kosovës, bashkëpunimi i dy akademive tashmë përqendrohet edhe në projektet madhore të Akademisë së Shkencave. Dy prej projekteve përfundojnë këtë vit. Fjalori i madh i Shqipes, që ishte parashikuar deri në 90- 100 mijë fjalë, dhe që ka shkuar 110 mijë fjalë dhe 10 mijë njësi frazeologjike përmbillet këtë vit, po ashtu edhe Historia e Shqiptarëve”, tha akad. Shaban Sinani, sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave.

Veprimtaria e parë nisi me prezantimin e mbi organizimin e çmimeve shkencore të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, për vitin 2024 nga akad. akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i ASH; akad. Shaban Sinani, Sekretar shkencor, ASH.

Më tej ASHAK, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë promovuan Kënga e cjamin - Drama klasike shqipe, akad. Kujtim Shala; Shqipja standarde sot - Materiale të

---

konferencës shkencore. Promovimet u drejtuan nga prof. Sabri Hamiti.

Paraqitën botimet: Prof. Nysret Krasniqi, akad. Kujtim Shala, akad. Rexhep Ismajli, prof. Bardh Rugova, prof. Shkumbin Munishi.

Tek Institutet Albanologjike (sheshi Nënë Tereza, nr. 3) u bë përrurimi i Qendrës Kombëtare për Koordinimin dhe Përhapjen e Informacionit Shkencor (QKPISH)

Veprimtariën e cceli Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi. U mbajt fjala përshëndetëse: dr. Aleš Bošnjak, drejtor i Institutit të Shkencave të Informacionit, Slloveni. U bë prezantimi i qendrës nga Msc. Mirlona Buzo, drejtuese e QKPISH

Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, ASH promovoi Akte të konferencës “Shteti i së drejtës në proceset integruese të Shqipërisë (Vështrime të studiuesve të së drejtës në diasporë) me drejtimin e akad. Aurela Anastasi, akad. Shaban Sinani (përgatitës). U promovua edhe Mbi zhvillimin e mirëqenien e akad. Kosta Barjaba. Kjo veprimtari u dretua nga akad. asoc. Gëzim Hoxha. Paraqitën botimet akad. Aurela Anastasi, akad. Shaban Sinani.

Më tej, MEKI, QKLL dhe DDA mbjatën veprimtarinë “Libri akademik dhe e drejta e autorit” që u drejtua nga dr. Albana Velianj. Folën znj. Borana Ajazi, drejtore e Drejtorisë së të Drejtës së Autorit dhe znj. Alda Bardhyli, drejtore e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë promovoi “Lufta e Kosovës në labirintet demokratike (Gjenevë 1998-2002)” të prof. dr. Ksenofon Krisafit dhe “Diplomacia e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane” të prof. dr. Paskal Milos

Një veprimtari tjetër e ditës së parë ishte dhënia e çmimit të Panairit autorit në fushën albanologjike nga QKLL të cilën e drejtoi akad. asoc. Adrian Civici.

Paraqitën botimet prof. dr. Ksenofon Krisafi dhe prof. dr. Paskal Milo.

Qendra e Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike bëri prezantimin e tri projekteve madhore të QBEA-së: Historia e shqiptarëve; Fjalori i madh i gjuhës shqipe; Enciklopedia shqiptare. Veprimtaria u drejtua nga prof. Marenglen Kasmi

Paraqitën prof. Neritan Ceka, akad. Valter Memisha, akad. Shaban Sinani

Në sallën Akademikët Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike promovoi librat “Qendrat e banuara të Shqipërisë – gjendja dhe e ardhmja (akte të konferencës shkencore” të prof. Perikli Qirjazit dhe “Baladë dritash për Zorbën N( ë poetikën e Zef Zorbës)” të prof. asoc. Viola Isufaj. Veprimtarinë e drejtuan dr. Bruna Prifti, prof. Perikli Qirjazi. Paraqesin botimet akad. Shaban Sinani, akad. asoc. Gëzim Hoxha.

Gjatë ditës së parë universiteti Shtetëror i Tetovës, Maqedonia e Veriut promovuan “Arti popullor në veshjet shqiptare në Maqedoninë e Veriut” të prof. Zejna Halimit dhe “Freedom – Journal for peace building and Transcultural Communication – Center for

---

Peace and Transcultural Communication” veprimtaria u drejtua nga prof.. dr. Vullnet Ahmeti, prof. dr. Agon Mehmeti. Paraqitën botimet: prof. dr. Salajdin Salihu dhe Mrc. Donika Kamberi.

ASHAK - Seksioni i Shkencave Shoqërore promovoi librat “Gjenocidi dhe masakrat e Serbisë në Kosovë - Materiale të konferencës shkencore” dhe “Competitiveness in the Eastern Balkans Challenges and opportunities for Kosovo” dhe “Pozita e ekonomisë së Kosovës në konkurrencën globale. Rezultatet e projektit.”. Veprimtaria u drejtua nga akad. Justina Sh. Pula. Paraqitën botimet akad. Isa Mustafa , prof. Frashër Demaj , akad. Justina Pula, akad. Isa Mustafa, prof. Besnik Krasniqi.

Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante promovoi “Historia e Gjergj Kastriot Skënderbeut, Marlin Barleti, ribotim i përkthimit të Zachary Jones. Variant i ri i përditësuar nga dr. David Hosaflook. Veprimtaria u drejtua nga prof. Teuta Toska. Paraqitën botimin: z. Mal Berisha, dr. David Hosaflook.

Qendra e Studimit të Arteve, ASH promovoi librin “Janaq Paço” të Ylli Drishtit. Njëkohësisht u bë edhe promovimi i studimeve të Ermir Hoxhës për artin pamor. Veprimtaria u drejtua nga z. Durim Taçi. Paraqet botimin: Agron Mesi, Anxhela Çikopano.

Në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave, Kryesia e ASH-së organizoi një takim mikpritës me përfaqësuesit e institucioneve pjesëmarrëse në panair.

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Informacionit paraqiti rezultatet e kërkimit shkencor të arritura në projektet kombëtare të kërkim zhvillimit.

U promovuan “Fjalor i Gjuhës shqipe, i ilustruar për moshat 5-11 vjeç”; “Kriminologjia e gjelbër”; Bibliografia e fondit albanologjik të bibliotekës publike “Thimi Mitko”, Korçë.

Veprimtaria u drejtua nga prof. Irakli Koçollari. Paraqitja u bë nga znj. Mirela Muça, drejtore e AKKSHI.

Shtëpia botuese “Toena” promovoi librin “Arbëreshët - Shqiptarët e Italisë (Vendbanimet, historia, kultura, ritet e objektet e kultit) me autor Fatmir Toçin. Promovimin e drejtoi znj. Irena Toçi. Paraqitën botimin, prof. dr. Rami Memushaj, akad. Shaban Sinani, akad. Pëllumb Xhufi, prof. Neritan Ceka, z. Fatmir Toçi.

Më pas u bë promovimi i botimeve muzikore i prof. dr. Eno Koço, (18 CD, 42 vjet regjistrim me orkestrën simfonike të RTSH-së. Promovim i kolanës), si dhe promovimi librit “Fjalë pa nota” të akad. Vasil S. Toles, botim i ASHSH-së, si dhe “Koncert për violinë dhe klavil” i akad. Vasil S. Toles. Veprimtarinë e drejtoi dr. Edmond Buhar. Paraqitën botimet prof. Lorenc Radovani, dr. Edmond Buhara, akad. Vasil S. Tole.

Shtëpia botuese “Naimi” promovoi librin “Migjeni dhe shkrimet” të akad. Shaban Sinanit. Veprimtarinë e drejtoi z. Naim Zoto. Paraqitën botimin Xhafer Martini e prof. Arian Leka.









## Panairi i 3-të mbarëkombëtar i librit akademik dhe shkencor

Dita e dytë, 24 prill 2024



Më 24 prill 2024, në ditën e dytë të panairit të 3-të mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor, Instituti Albanologjik i Prishtinës promovoi librin “Fjalor toponamistik i Kosovës” të Qemal Muratit. Veprimtaria u drejtua nga drejtori i IA-së, prof. Lulëzim Lajçi. Paraqitën botimin akad. Valter Memisha, prof. Abdurrahim Maxhuni.

Më pas, Seksioni i Shkencave të Natyrës i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës promovoi librin “Proceset dhe ciklet termodinamike” të akad. Fejzullah Krasniqit dhe prof. dr. Naser Sahitit; si dhe librin “Proceset konvencionale membranore dhe të integruara (parimet dhe zbatimi)” të Salih Gashit. Veprimtaria u drejtua nga prof. Fetah Podvorica. Paraqitën botimet prof. Fetah Podvorica, akad. Fejzullah Krasniqi, prof. dr. Naser Sahiti, Salih Gashi.

Universite, i Vlorës Ismail Qemali promovoi botimet “Studime ndërdisiplinore në albanologji: të prof. dr. Roland Zisit dhe “Bibliografia e Universitetit Ismail Qemali, Vlorë. Pjesa II,(2006-2023), përgatitur nga Albert Habazaj. Veprimtarinë e drejtoi Albert Habazaj. Paraqitën botimet, prof. Teuta Toska, akad. Vasil S. Tole, akad. Shaban Sinani, Albert Habazaj dhe Ermir Xhindi.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Seksioni i Shkencave Natyrore e Teknike bëri

---

promovimin e librave “Hyrje në evolucionin modular” të prof. Zyri Bajramit dhe “Llojet aloktone në ekosistemet ujore të Shqipërisë” të prof. Rigers Bakiut, prof. Edmond Halajt, prof. Elvis Kamberit. Veprimtarinë e dretoi akad. Neki Frashëri, Kryetar i SSHNT pranë ASHSH. Paraqitën botimet prof. Ethem Ruka, prof. Tefta Rexha, prof. Perikli Qiriaz, Vasjar Shermadhi.

Universiteti i Shkupit “Nënë Tereza” promovoi librat “Si të jesh menaxher i suksesshëm” të prof. dr. Izet Zeqiri dhe prof. dr. Brikend Azirit; “Kultura muzikore në Greqinë e Lashtë” të prof. dr. Sunaj Raimit. Drejtuan veprimtarinë prof. dr. Izet Zeqiri dhe prof. dr. Sunaj Raimi. Paraqitën botimet prof. dr. Izet Zeqiri dhe prof. dr. Sunaj Raimi.

Ndërkohë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë bëri prezantimin e bibliografisë së akad. Ali Aliut, anëtar i jashtëm i ASH-së (në 90-vjetorin e lindjes) në sallën “akademikët”. Veprimtarinë e drejtoi prof. Arian Leka. Botimin e paraqitën z. Naim Zoto dhe akad. Shaban Sinani.

Shtëpia botuese Argeta LMG promovoi librat “Gjuha e Naimit” – Mehmet Gëzhilli (përgatitës), “Misioni i parë” me autor sr. Avni Spahiun dhe “Millosh Gjergj Nikolla – Migjeni – Bibliografi” me autore Eni Koçi, Brunilda Tahiri. Veprimtaria u drejtua nga prof. Arian Leka, prof. Arben Cici, prof. Persida Asllani. Paraqitën botimet akad. Gjovalin Shkurtaj, prof. Emil Lafe, prof. Xhevat Lloshi, akad. Ali Aliu, B. Baliu, Besnik Mustafaj, akad. Pëllumb Xhufi, prof. Paskal Milo, prof. Kristaq Jorgo, Behar Gjoka, Mehmet Gëzhilli.

Gjatë ditë së dytë të edicionit të tretë të librit akademik dhe shkencor u zhvilluan përrurime dhe veprimtari të tjera.

Në sallën “Akademikët”, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, promovoi librat “Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore 1941-1945”, me autor Haxhi Ademin, “Çështja e shqiptarëve në Jugosllavi në sfondin e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë 1918-1938” me autor Skënder Lutfiun. Veprimtaria u drejtua nga prof. dr. Teuta Shala-Peli. Paraqitën botimet akad. Beqir Meta dhe akad. Marenglen Verli.

Promovime pati edhe Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”. U promovuan më 24 prill 2024 librat “E Drejta e përmbarimit” e prof. dr. Iset Morinës dhe “Qëndrueshmëria mjedisore dhe edukimi për zhvillim të qëndrueshëm” e prof. dr. Zeqir Veselaj. Veprimtaria u drejtua nga prof. Faton Berisha. Paraqitën botimet prof. asoc. dr. Ardit Gashi dhe prof. dr. Mihallaq Qirjo.

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” promovoi librat “Fjalori i gjuhës së Ndre Mjedës, Kolë Ashta”, përgatitur për botim nga prof. dr. A. Haxhi, prof. dr. M. Priku, dr. E. Koperaj, prof. as. dr. Z. Shkreli, doc. B. Logur dhe “Digjitalizimi i biodiversitetit në Rajonin e Shkodrës” nga Grup autorësh, Aurora Dibra & Al. Veprimtarinë e drejtoi prof. as. dr. Zamira Shkreli. Paraqitën botimet dr. Erzen Koperaj dhe dr. Aurora Dibra.

Universiteti i Tiranës promovoi librin studimor “Menaxhimi i sigurt i mbetjeve

---

radioaktive në Shqipëri” të dr. Dritan Priftit. Veprimtarinë e drejtoi z. Mentor Kikia. Botimi u paraqit nga Univesiteti i Tiranës.

Universiteti Luarasi promovoi librat “Sëmundjet e brendshme” të prof. dr. Petrit Bares dhe “Manuali i drejtësisë për të miturit” me autorë prof. asoc. dr. Admir Belishta, dr. Lorenc Stojani, dr. Erinda Ahmetaj, prof.asoc. dr. Luan Veliqoti. Veprimtarinë e drejtuan prof. dr. Petrit Bara dhe prof. dr. Admir Belishta. Paraqitën botimet prof. dr. Petrit Bara, prof. dr. Xheladin Ceka, prof. dr.Rozarka Budina, prof. asoc. Sokol Papparisto, znj.Gilberta Dogani, dr. Lorenc Stojani, dr. Erinda Ahmetaj, z. Ergi Tafani, znj. Egzona Elezi.

Gjatë ditës së dytë paralelisht kanë vijuar përrurime dhe veprimtari të tjera në sallën “Aleks Buda”.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë bëri prezantim e Akademisë së të Rinjve.

Më pas, ITSHKSH – Maqedonia e Veriut promovoi librat “Zhvillimet kulturore dhe historike te shqiptarët në Maqedoni gjatë shekujve XIX – XX “ me autorë Skënder Asani, Sevdail Demiri, Emin Azemi, Sali Islami; “Ipushkvia Shkup – Prizren” me autor Gaspër Gjini; Dialektologjia shqiptare – Të folmet shqipe të Maqedonisë së Veriut” me grup autorësh. Veprimtaria u drejtua nga prof. dr. Sefer Tahiri. Paraqitën botimet prof. dr. Skënder Asani, prof. dr. Sevdail Demiri dhe prof. dr.Zeqirija Ibrahim.


Një tjetër veprimtari ishte ajo e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit: Dhënia e çmimeve të Panairit. Veprimtari u drejtua nga znj. Alda Bardhyli.

Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë promovoi librat “Kolana me 12 vepra” me autor akad. Jani Thomai; “Studime rreth shqipes së vjetër, shek. XV-XVIII”, me autor prof. Anila Omari; “Konsensus dhe polemikë... “ me autor prof. Arian Leka. Paraqitën botimet akad. Valter Memisha, prof. Mimoza Kore, prof. Adelina Çerpja, prof. Evalda Paci, prof. A. Kyçyku (Bukuresht)

Instituti i Historisë, ASHSH, promovoi librin “Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane gjatë shekullit XX” dhe revistë Studime historike, nr. 1/2023. Veprimtaria u drejtua nga prof. dr. Hamit Kaba e prof. asoc. dr. Sali Kadria. Paraqitën botimet prof. dr. Hamit Kaba dhe prof. asoc. dr. Sali Kadria.

Instituti i Arkeologjisë, ASHSH promovoi librat “Vegla bakri dhe sëpata bronzi në Shqipëri dhe Kosovë” me autor akad. Adem Bungurin; “Dardanët” me autor prof. dr. Luan Përzhitën dhe “Topografia e Durrësit mesjetar” me autor prof. asoc. dr. Eduard Shehin. Veprimtaria u drejtua nga akad. Adem Bunguri, drejtor i IA. Paraqitën botimet dr. Rovena Kurti, prof. asoc. Brikena Shkodra-Rugia.





## Panairi i 3-të mbarëkombëtar i librit akademik dhe shkencor

Dita e tretë, 25 prill 2024



Dita e tretë e panairit të tretë mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor vijoi si në dy ditët e para me ritme të larta të veprimtarive përruruese dhe ceremoniale. Në këto promovime një hapësirë e madhe u është lënë inistituteve dhe qendrave kërkimore si dhe universiteteve publike dhe jopublike.

Universiteti i Durrësit “Aleksandër Moisiu” promovoi librat “Astronomia detare” me autor Osman Metalla dhe “Analizë e reformave në sistemin e arsimit parauniversitar në Shqipëri” me autore Enida Kume. Veprimtaria u drejtua nga znj. Alketa Marku. Botimet u paraqitën nga z. Osman Metalla dhe znj. Enida Kume.

Instituti i Antropologjisë, pranë Akademisë së Shkencave promovoi librat “Xhubleta” me autore prof. dr. Afërdita Onuzin dhe “Etnografi në diktaturë, kolanë (9 botime). Veprimtaria u drejtua nga prof. asoc. dr. Olsi Lelaj. Paraqitën botimet prof. asoc. dr. Olsi Lelaj, dr. Ervin Kaçiu.

Universiteti i Gjirokastrës “Eqrem Çabej” promovoi studimet “Sëmundjet e

---

brendshme dhe kujdesi infermieror”, Grup autorësh dhe “Prefektura e Gjirokastrës në luftën kombëtare të Vlorës” e prof.dr. Shyqyri Hysit. Veprimtari u drejtua nga dr. Eduina Guga. Paraqitën botimet Altin Goxharaj, prof. dr. Shyqyri Hysi.

Universiteti Bujqësor i Tiranës promovoi librat “Financa ndërkombëtare” me autorë prof. Drini Salko, Orfea Dhuci, Tonin Kola; “Erëzat” me autor prof. Nikoll Bardhi; “Ngjitja e lustrimit të drurit” me prof. Dritan Ajdinaj; “Teknologjia e përpunimit të mishit” me autorë prof. Kapllan Sulaj, dr. Vilma Gurazi. Veprimtaria u drejtua nga prof. as. Romina Kote. Paraqitën botimet prof. Drini Salko, Orfea Dhuci, Tonin Kola, prof. Dritan Ajdinaj, prof. Kapllan Sulaj, dr. Vilma Gurazi.

Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë promovoi botimet “Revista arkivore 2023 – Pjesë e kolanës së votimeve të DPA-së”; “Manual teoriko-praktik për dokumentet dhe arkivat në Shqipëri” me autor Ivan Loli. Veprimtaria u drejtua nga dr. Lorenc Agalliu. Paraqitën botimet prof. asoc. dr. Ardit Bido, dr. Endrit Musaj.

Përrurime dhe veprimtari të tjera u mbajtën paralelisht në sallën “Akademikët”, Libri Akademik, ku Universiteti i Korçës “Fan Noli” promovoi “Bimët foragjere” me autor dr. Adrian Mahon dhe “Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Qarkut Korçë, vlerat dhe përdorimi turistik” me autor prof. asoc. dr. Edlira Menkshin. Veprimtaria u drejtua nga dr. Metin Venxha, prof. asoc. dr. Gjergji Mero. Paraqitën botimet dr. Adrian Maho dhe prof.as.dr. Edlira Menkshi.

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” promovoi librat “Atlas ilustrativ i Florës së Parkut Kombëtar “Shebenik” me autore Emelinda Gjeta, Peçi Naqellari, Nikoleta Kallajxhiu, Silvana Turku, Ana Zhapi dhe “Analizë morfo-sintaksore e “Fiamuri Arbërit” në kuadër të zhvillimeve gjuhësore të shek. XIX” me autor Ardian Lami. Veprimtaria u drejtua nga znj. Nikoleta Kallajxhiu dhe prof. Ardian Lami. Paraqitën botimet Nikoleta Kallajxhi dhe prof. Ardian Lami.

Universiteti Politeknik i Tiranës promovoi librin “Modernisation and globalisation. Neë paradigms in architecture city, territory” nga prof. Florian Nepravishta. Veprimtaria u drejtua nga UPT. Paraqiti botimin prof. Florian Nepravishta.







---

# Nekrologji


---

## Ndahet nga jeta piktori i njohur Ali Oseku

Komisioni i Artit pranë Akademisë së Shkencave shpreh ngushëllimet më të thella për ndarjen nga jeta të piktorit të njohur Ali Oseku.

Ngushëllimet shkojnë për familjen, miqtë dhe komunitetin artistik në vend.

I paharruar!



Ali Oseku (1944–2024). Piktor. Lindi në Tiranë. Kreu LA “Jordan Misja” për pikturë dhe ndoqi studimet e u diplomua në ILA (1969). Në vitet 1970–1973 realizoi skenografinë dhe kostumet për operën “Traviata”, baletin “Historia e një kënge”, dramat “Viti ‘61”, “Orfeu zbret në Ferr”, “Yll pa emër”. Në vitin 1973 u dënua për “shfaqje të huaja borgjezo-revizioniste” në krijimtarinë e tij si skenograf dhe u dërgua në punë riedukuese në Kombinatin Metalurgjik në Elbasan. Në vitin 1975 u arrestua, u dënua dhe vuajti dënimin deri në v. 1979 si i burgosur politik; më pas punoi si punëtor. Në vitin 1991 u rikthye në veprimtarinë artistike si piktor në Galerinë Kombëtare të Arteve, njëkohësisht pedagog i jashtëm i pikturës në Akademinë e Arteve, ku ka kaluar (1998) si përgjegjës i ateliesë së grafikës. Ali Oseku ka marrë pjesë në ekspozita të përbashkëta dhe ka hapur disa ekspozita vetjake në Tiranë etj. si dhe në botën e jashtme: Belgjikë, Gjermani, Austri, Turqi, Kroaci, Poloni, Itali, SHBA, Greqi, Francë, Tunizi etj. Gjatë periudhës 1998–2007 ndër të tjera Ali Oseku ka realizuar ciklin: “Gjurmët”, “Kërpudhat”,

---


“Shiu”, “Rrugëve”, “Hapësirë” etj. Është fitues i disa çmimeve në konkurset: “Onufri”, “Eduard Lir” etj.

---

**In memoriam**

---

**20-vjetori i largimit nga jeta, Akademia e Shkencave e Shqipërisë kujton me nderim e mirënjohje akademik Bedri Dedjan**



Ka qene pedagog e psikolog, historian i arsimit shqiptar, shkrimtar, teoricien e kritik i letërsisë për fëmijë, akademik. Lindi në Korçë. Kreu studimet e larta në Institutin “Lenin” në Moskë (1953), duke ndjekur njëkohësisht dy degë: Pedagogji-psikologji dhe letërsi për fëmijë. Ka qenë pedagog dhe dekan i Fakultetit të Historisë e të Filologjisë në Institutin e Lartë Pedagogjik (1954-1957), drejtor i Institutit të Lartë Pedagogjik 2-vjeçar të Tiranës (1957-1958), kryeredaktor i gazetës “Mësuesi”, i revistave “Arsimi popullor” e “Fatosi”; nismëtar dhe drejtor i Institutit të Studimeve dhe Botimeve Shkollore (1965-1970), zëvendësministër i Arsimit dhe i Kulturës (1970-1973), sekretar shkencor i ASHSH (1973-1975) etj. Është autor i botimeve shkencore pedagogjike e psikologjike: “Rrugët e

---

perfeksionimit të sistemit të sotëm të edukatës familjare” (1966), “Shënime për historinë e mendimit pedagogjik shqiptar” (1972), “Studime për problemin e metodave të dhënies së mësimin në shkollë” (1987), “Drejt enigmave të psikikës së njeriut” (1989), “Psikologjia sociale” (1990), “Sekreti i talentit” (1998), “Nëpër ravat e jetës” (2001) etj.; bashkautor në tekste të psikologjisë për shkollat e larta dhe për kursin pasuniversitar, në veprën “Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar” I (2004), në manualin shkencor “Didaktika” etj.

Ndër veprat kryesore si shkrimtar i letërsisë për fëmijë janë romanet “Kalamajtë e pallatit tim” (1972), “Met partizani” (1981), “Kacamisri rreth globit” (1993), “Një udhëtim i rrezikshëm” (1962), “Qyteti me tri kështjella” (2003), “Republika e një mijë e njëqind çudirave” (1997); poema “Shkolla e pyllit” (1967), vëllimet “Përralla njëmbëdhjetëkatëshe” (1996), “Kapiteni i shtrëngatës” (1970); si studiues ka botuar librat “Tradita e probleme të letërsisë shqipe për fëmijë” (1971), “Shkrime mbi letërsinë për fëmijë” (1978), “Letërsia për fëmijë” (1961) etj. Për këtë veprimtari ka marrë Urdhrin e Organizatës Ndërkombëtare të Librit për Fëmijë dhe të Rinj (Cyrih, 2000).

Bedri Dedja ka qenë kryetar i Shoqatës Mbarëshqiptare të Psikologëve, anëtar i Asamblesë së Lidhjes Botërore të Shkencave Psikologjike, kryetar nderi i Shoqatës Mbarëshqiptare të Shkrimtarëve për Fëmijë dhe të Rinj.

Është dekoruar me Urdhrin “Mjeshtër i Madh i Punës”, ka marrë Çmimin e Republikës të shkallës së parë.